

GRUP AUTORËSH

LIBËR PËR MËSUESIN

Dituri natyre 5

Për klasën e 5-të të arsimit 9-vjeçar

BOTIME



BOTIME



Drejtoi botimin: Arlinda RRUSHI
Redaktore letrare: Brunilda MENO
Paraqitja grafike: Enkeleda REXHA
Shtypi: Shtypshkronja Pegi, Lundër, Tiranë

© Botime Pegi, prill 2019

Të gjitha të drejtat për këtë botim në gjuhën shqipe janë tërësisht të zotëruara nga Botime Pegi shpk. Ndalohet çdo riprodhim, fotokopjim, përshtatje, shfrytëzim ose çdo formë tjetër qarkullimi tregtar, pjesërisht ose tërësisht, pa miratimin paraprak nga botuesi.

Botime Pegi: tel: +355/ 042 468 833; cel: +355/ 069 40 075 02;
e-mail: botimepegi@botimepegi.al; web: www.botimepegi.al
Sektori i shpërndarjes: cel: +355/ 069 20 267 73; 069 60 778 14;
e-mail: marketing@botimepegi.al
Shtypshkronja Pegi: cel: +355/ 069 40 075 01;
e-mail: shtypshkronjapegi@yahoo.com

Përmbajtje

REZULTATET E TË NXËNIT SIPAS KOMPETENCAVE KYÇE	5
PLANIFIKIMI VJETOR	12
PERIUDHA E PARË (SHTATOR-DHJETOR)	14
PERIUDHA E DYTË (JANAR-MARS)	17
PERIUDHA E TRETË (PRILL-QERSHOR)	21
MODELE DITARESH	26
TESTE PËRMBLEDHËSE	103

PLANIFIKIMI VJETOR
FUSHA: SHKENCAT NATYRORE
LËNDA: DITURI NATYRE
SHKALLA: II

TABELA PËRMBLEDHËSE E PROGRAMIT PËR KLASËN E PESTË

Tematikat	Përmbajtja sipas tematikave	Orët mësimore për tematikë
CIKLET	Bimët dhe kafshët <ul style="list-style-type: none"> – Nevojat për të jetuar – Riprodhimi te bimët – Cikli jetësor 	27 orë
	Ndryshimet e gjendjes së lëndës <ul style="list-style-type: none"> – Ndryshimet e lëndës gjatë ngrohjes dhe ftohjes – Proceset e shkrirjes, ngrirjes, avullimit dhe kondensimit 	10 orë
ENERGJIA	Drita <ul style="list-style-type: none"> – Burimet e dritës – Drita dhe errësira – Hija dhe ndryshimet e saj 	23 orë
SISTEMET	Toka dhe hapësira <ul style="list-style-type: none"> – Rrotullimi i Tokës rreth boshtit të saj – Rrotullimi i Tokës rreth Diellit – Sistemi diellor dhe yjet 	10 orë
Totali		70 orë

SHPËRNDARJA E PËRMBAJTIES SË LËNDËS

Tematika/Shkalla 2	Diversiteti	Ciklet	Ndërveprimet	Sistemet	Energjia	Gjithsej
Klasa e pestë	-	37	-	10	23	70 orë

Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe

Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit

Nxënësi/ja:

1. merr pjesë në organizimin e një shfaqjeje artistike, duke përdorur forma të ndryshme të të shprehurit;
2. shkruan një tekst afërsisht një faqe (rreth 100 fjalë) për një temë të caktuar;
3. prezanton një temë të caktuar para të tjerëve, në një kohëzgjatje deri në 10 minuta, duke përdorur mjetet e TIK-ut.

Kompetenca e të menduarit

Nxënësi/ja:

1. identifikon tiparet e përbashkëta dhe të veçanta të objekteve, qenieve të gjalla, dukurive ose ngjarjeve të dhëna në detyrë dhe i paraqet ato përmes njëres prej formave shprehëse;
2. identifikon për një temë/ngjarje, çështjet kryesore të marra nga burime të ndryshme informacioni (tekst mësimor, gazetë, internet, apo burime të tjera);
3. paraqet argumente pro dhe kundër për një mendim, qëndrim, sjellje të manifestuar nga një apo më shumë persona (në klasë/shkollë apo jashtë saj);
4. zgjidh një problem/detyrë të caktuar, duke dhënë shembuj nga jeta e përditshme për situata të ngjashme;
5. ndërton tekste, objekte dhe animacione sipas imagjinatës, duke përdorur udhëzimet dhe materialet e dhëna;
6. përshkruan nëpërmjet njëres prej formave shprehëse, dukurinë e caktuar, duke veçuar ndryshimet që ndodhin apo kanë ndodhur në mjedisin që e rrethon dhe që janë rrjedhojë e kësaj dukurie;
7. paraqet dhe argumenton mënyrën e zgjidhjes së një problemi/detyrë të caktuar në një kohëzgjatje prej 6-10 minutash;
8. dallon lëndët, trupat, objektet, dukuritë natyrore të dhëna në detyrë sipas karakteristikave përkatëse, të tilla si: përbërja, vetitë, shndërrimet, vendndodhja e tyre në kohë e hapësirë dhe bashkëveprimi ndërmjet tyre.

Kompetenca e të nxënit

Nxënësi/ja:

1. parashtron pyetje që nxitin debat për temën, problemin e dhënë dhe u jep përgjigje pyetjeve të bëra nga të tjerët, përmes njëres prej formave të shprehjes;
2. shfrytëzon burime të ndryshme informacioni për përgatitjen e një teme të dhënë;
3. identifikon dhe krahason informacionet e njohura me ato të panjohura për një temë, çështje apo ngjarje të caktuar, duke përdorur teknika të ndryshme (p.sh.: duke i shënuar me shenja të ndryshme).
4. ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në burime të tjera, për të realizuar një veprimtari apo detyrë konkrete që kërkohet prej tij;
5. krahason përparimin e tij, me përvojën paraprake gjatë kryerjes së një detyrë apo një veprimtarie të caktuar.
6. përdor portofolin personal si mjet për identifikimin e përparësive dhe mangësive të veta në fusha të caktuara, duke hartuar një plan pune me hapa konkretë për përmirësim;
7. identifikon cilësitë që zotëron dhe ato që duhen zhvilluar për të nxënë gjatë zhvillimit të një detyrë apo veprimtarie të caktuar, duke bashkëpunuar me të tjerët;
8. menaxhon sjelljet e veta, materialet/mjetet dhe kohën që ka në dispozicion, gjatë kryerjes së një detyrë/veprimtarie individuale apo të përbashkët në klasë/shkollë apo jashtë saj;

9. përdor dhe zbaton në mënyrë efektive informacionin/njohuritë për zgjidhjen e një problemi/detyrë të caktuar, përmes shfrytëzimit të TIK-ut apo të burimeve të tjera;
10. prezanton për 6-10 minuta përvojën e vet.

Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin

Nxënësi/ja:

1. përgatit një plan pune njëjavor dhe specifikon veprimtaritë parësore duke argumentuar përzgjedhjen e tyre;
2. përgatit një projekt të vogël, duke theksuar veprimtaritë kryesore për një çështje që e shqetëson në shkollë ose komunitet dhe përcakton kohën, vendin, materialet, mjetet e nevojshme për zbatimin e tij;
3. diskuton në grup për gjendjen e mjedisit që e rrethon dhe bën një listë në bashkëpunim me anëtarët e grupit për veprimtaritë e mundshme, për mbikëqyrjen dhe përmirësimin e gjendjes;
4. paraqet në tabelë, grafik, vizatim apo formë tjetër, veprimtaritë e përkujdesjes për qeniet e gjalla, të cilat mundësojnë zhvillimin, rritjen apo ruajtjen e shëndetit të tij.

Kompetenca personale

Nxënësi/ja:

1. përgatit një listë me ushqime, që i shfrytëzon familja, dhe i radhit ato sipas kalorive dhe vlerave ushqyese, duke i klasifikuar në ushqime të shëndetshme dhe më pak të shëndetshme;
2. lexon të dhënat në paketimet e ushqimit dhe i diskuton në grup ato (vlerat ushqyese, afatet e prodhimit etj.);
3. dallon dhe përshkruan rolet e personave dhe të shërbimeve të nevojshme për kërkimin e ndihmës në situata rreziku të shëndetit fizik dhe mendor;
4. bashkëpunon në mënyrë aktive me moshatarët (pavarësisht prejardhjes së tyre, aftësive dhe nevojave të veçanta) drejt arritjes së një qëllimi të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klase/shkollë apo jashtë saj);
5. përkujdeset për një mjedis të shëndetshëm gjatë realizimit të një veprimtarie të caktuar, duke i krijuar vetes dhe pjesëmarrësve kushte të përshtatshme pune (ajrosje, ndriçim, shfrytëzim maksimal të hapësirës, pastërti dhe rregull).

Kompetenca qytetare

Nxënësi/ja:

1. shpreh, dëgjon dhe respekton mendimin e secilit anëtar dhe vendos për mënyrat e përfundimit të një aktiviteti të përbashkët;
2. propozon dhe ndan mendimin me shokët/shoqet e klasës për procedurën e zgjedhjes së anëtarëve të grupeve, përbërjen dhe rolin e tyre në aktivitete të ndryshme mësimore, këshilla të klasës/shkollës etj.;
3. merr pjesë në hartimin e rregullave të lojës, rregullores së klasës dhe argumenton rëndësinë e respektimit të rregullave të propozuara, nëpërmjet formave të ndryshme shprehëse, duke parashikuar pasojat e moszbatimit;
4. paraqet me shembuj konkretë sjelljet që duhen manifestuar në rast rreziku nga fatkeqësitë natyrore apo të krijuara nga njeriu, si: zjarri, vërshimi, tërmeti, komunikimi me njerëz të panjohur etj.

Kompetenca digjitale

Nxënësi/ja:

1. përdor mediat digjitale dhe mjediset informative për të komunikuar dhe bashkëpunuar;
2. organizon dhe komunikon informacionin, duke përdorur mjetet e duhura të komunikimit teknologjik për të mbledhur informacion dhe për të komunikuar me të tjerët (p.sh.: internet, video-konferencë, poster mbi një temë të caktuar), duke u angazhuar me nxënësit e kulturave të tjera nëpërmjet komunikimit *online*;
3. organizon, mbledh dhe shfaq të dhënat e gjetura nga burimet e informacionit elektronik;
4. identifikon dhe përdor bazën e të dhënave të sigurta dhe të përshtatura për moshën e tij, nëpërmjet burimeve elektronike apo të shtypit;
5. jep shembuj të punës me teknologjitë, të zgjidhjeve që ato na ofrojnë në jetën e përditshme, në bazë të së cilave ne marrim vendimet tona;
6. demonstroi sjellje pozitive dhe etike kur përdor teknologjinë si një mjet komunikimi ose shërbimi apo krijimi të një produkti.

Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës

TEMATIKA: CIKLET

Përshkrimi i tematikës:

Në natyrë ka ndryshime që përsëriten në mënyrë ciklike. Shembuj të tyre janë ciklet jetësore të qenieve të gjalla, cikli i ujit etj. Të kuptuarit e këtyre cikleve e ndihmon njeriun të parashikojë ngjarjet dhe proceset dhe të vlerësojë Tokën si një sistem të vetëqëndrueshëm.

Kjo tematike përqëndrohet në ciklet e proceseve jetësore të bimëve, kafshëve, njeriut, motit, atmosferës, sistemi diellor dhe Tokës, përzierjet dhe ndryshimet e lëndëve, nxehja dhe ftohja.

Rezultatet e të nxënit

Njohuritë/ Konceptet

Bimët dhe kafshët

- Nevojat për të jetuar
- Riprodhimi të bimëve dhe kafshëve
- Cikli jetësor të bimëve, kafshëve përfshirë dhe njeriun

Shkathësitë dhe proceset.

Nxënësi:

- Përshkruan kushtet që ju duhen bimëve dhe kafshëve për të jetuar;
- tregon me shembuj se çdo organizëm i gjallë rritet dhe riprodhohet;
- provon se bimët kanë nevojë për energjinë e dritës së diellit për t'u rritur;
- planifikon dhe kryen një hetim se si farat kanë nevojë për ujë dhe ngrohtësi për të mbirë por jo për dritë; diskuton gjetjet dhe i përdor për të shkruar konkluzionet e tij/saj;
- zbulon se çdo organizëm i gjallë ka një cikël jetësor;
- përshkruan ndryshimet në ciklin jetësor të një gjatari, amfibi, insekti dhe shpendi;
- vëzhgon riprodhimin të bimëve dhe përshkruan thjeshtë se:
- bimët prodhojnë lule që kanë organe mashkullore dhe femërore;

- farat formohen kur pjalmi që prodhohet nga organi mashkullor (theku) pllenon vezën në organin femëror (pistil);
- vëzhgon mënyra të ndryshme të shpërndarjes së farave;
- tregon me shembuj se insektet pjalmojnë disa lule;
- tregon se bimët me lule kanë një cikël jetësor që përfshin pllenimin, formimin e farës, shpërndarjen e farës dhe mbirjen;
- komunikon me gojë, me shkrim ose me vizatim të dhënat që merr nga vëzhgimet dhe regjistrimet.

Qëndrimet dhe vlerat.

Nxënësi:

- Tregon kuriozitet kur heton:
- faktorët që ndikojnë në mbijetesën e bimëve dhe kafshëve;
- ciklin jetësor të bimëve dhe të kafshëve.

Rezultatet e të nxënit

Njohuritë/ Konceptet

Ndryshimi i gjendjes së lëndëve

- Avullimi
- Kondesimi
- Qarkullimi i ujit në natyrë

Shkathtësitë dhe proceset.

Nxënësi:

- Vëzhgon dhe përshkruan procesin e avullimit (kthimin e lëngut në gaz);
- vëzhgon dhe përshkruan procesin e kondesimit (kthimin e gazit në lëng) e kundërta të avullimit;
- tregon se ajri përmban avuj uji, i cili kur bien në kontakt me sipërfaqe të ftohtë kondensohet;
- vëzhgon dhe përshkruan se uji vlon në 100°C dhe ngrin në 0°C;
- heton faktorët që ndikojnë në procesin e avullimit;
- vëzhgon dhe përshkruan procesin e avullimit të lëngut nga tretësira dhe mbetjen e të ngurtave;
- përshkruan dhe shpjegon qarkullimin e ujit në natyrë, duke dalluar faktorët që ndikojnë në të.

Qëndrimet dhe vlerat.

Nxënësi:

- Demonstron bashkëpunim gjatë punës në grup;
- është i përgjegjshëm për rëndësinë e përdorimit të teknikave dhe njësive të sakta në matjen e temperaturës në gradë celsius, me termometër;
- vlerëson burimet e ndryshme të informacionit (enciklopedi, ilustrime, website etj) që mbështesin kërkimin e tij mbi procesin e avullimit dhe kondesimit.

TEMATIKA: ENERGJIA

Përshkrimi i tematikës:

Energjia ben te mundur ndryshimet dhe levizjen ne natyre. Njeriu perdor forma te ndryshme energjie per qellime te ndryshme. Te gjitha qeniet e gjalla, perfshire dhe njeriun, kane nevojte per energji qe te kryejne proceset jetesore. Kjo tematike i ndihmon nxenesit te vleresojne rendesine dhe perdorimet e energjise, si dhe nevojen per ta ruajtur ate. Kjo tematike studion burimet dhe perdorimet e energjise, shnderrimet e saj nga nje forme ne tjetren, driten, zerin, elektricitetin dhe magnetizmin. Ajo trajton menytrat e shfrytezimit te energjise dhe u krijon mundesi nxenesve per te identifikuar rastet e keqperdorimit dhe per pasoje, te ruajtjes dhe kursimit te saj.

Rezultatet e të nxënit

Njohuritë/ Konceptet

Drita

- Burimet e dritës
- Drita dhe errësira
- Hija dhe ndryshimet e saj

Shkathësitë dhe proceset.

Nxënësi:

Identifikon burimet e ndryshme të dritës;

- emërton burimet natyrore të dritës (Dielli, yjet, vullkanet, etj.);
- emërton burimet artificiale të dritës (llamba elektrike, qiriu, llambat e dorës, etj.);
- shpjegon se Dielli është burimi kryesor i dritës;
- bën dallimin mes burimeve natyrore dhe artificiale të dritës;
- argumenton se sipërfaqet e ndriçuara nuk janë burime drite;
- shpjegon se ne shohim trupat, pasi drita nga burimi vjen në syrin tonë;
- tregon se errësira është mungesa e dritës;
- shpjegon se drita përhapet në vijë të drejtë, por mund të ndryshojë drejtimin e saj;
- tregon se shpejtësia e dritës varet nga mjedisi ku përhapet ajo;
- tregon vlerën e shpejtësisë së dritës në zbrazësi;
- përshkruan se hija formohet kur drita bllokohet nga një trup i ngurtë;
- zbulon se madhësia e hijes varet nga pozicioni i trupit;
- vërejt se hijet ndryshojnë pozicionin dhe madhësinë e tyre gjatë ditës;
- shpjegon se :

a) trupat e patejdukshëm nuk e lejojnë dritën të depërtojë;

b) trupat gjysëm të tejdukshëm e lejojnë dritën të depërtojë pjesërisht;

c) trupat transparentë e lejojnë dritën të depërtojë plotësisht;

- tregon se drita pasi pasqyrohet bie në syrin tonë dhe ne shohim trupat;
- tregon se pasqyrat kanë sipërfaqe të ndritshme;
- shpjegon përdorimet e ndryshme të pasqyrave;
- vizaton rrezen e rënies dhe rrezen e pasqyruar;
- shpjegon se pasqyrat përdoren për të parë trupat: para/prapa/përreth/sipër nesh;

- krahason sipërfaqet që pasqyrojnë dritën;
- shpjegon se sipërfaqet e ndritshme dhe të sheshta pasqyrojnë dritën;
- shpjegon se sipërfaqet e ashpra e përthithin dritën;
- demonstron nëpërmjet eksperimentit pasqyrimin e dritës;
- tregon se këndi i rënies së rrezeve të dritës është i barabartë me këndin e pasqyrimin;
- tregon rrugën që përshkon rrezja rënëse nga burimi deri te syri ynë;
- tregon njësinë matëse të intensitetit të dritës (kandela/cd);
- tregon si mbrohet syri nga drita e fortë e Diellit;
- tregon se drita e bardhë përbëhet nga të gjitha ngjyrat e ylberit;
- shpjegon se ne shohim ngjyrën e një trupi, pasi ai i përthith të gjithë ngjyrat e tjera përveç ngjyrës së tij, e cila pasqyrohet në syrin tonë;
- shpjegon se shkencëtarët i bazojnë idete e tyre, duke u mbështetur mbi vërtetimet dhe të dhënat e eksperimenteve.

Qëndrimet dhe vlerat.

Nxënësi:

- Planifikon në grup një veprimtari, ku përdor forma të ndryshme të hijeve për të bërë një shfaqje për fëmijë apo një ekspozitë vizatimesh;
- skicon dhe ndërton një periskop, duke u bazuar në dukurinë e përhapjes dhe pasqyrimin të dritës dhe shpjegon si përdoret ai;
- realizon një projekt për të shpjeguar si formohet ylberi, ngjyrat në fluskat e sapunit, filtrat me ngjyra, etj., pa e shpjeguar hollësisht kuptimin fizik të tyre;
- realizon një projekt për të hulumtuar si ndryshon madhësia e hijes dhe forma e saj gjatë ditës;
- tregon kujdes për të mbrojtur syrin nga rrezet direkte të Diellit, duke shpjeguar se përdorimi i syzeve të errëta është i domosdoshëm në ditët me diell;
- realizon një projekt rreth rëndësisë së përdorimit të pasqyrave në jetën e përditshme (pasqyrat e makinave, pasqyrat në kthesa, pasqyrat e dentistit,
- pasqyrat në shtëpitë tona;
- diskuton me shokët dhe shoqet e klasës rreth teorive të ndryshme mbi dritën dhe përhapjen e saj.

TEMATIKA: SISTEMET

Përshkrimi i tematikës:

Një sistem përfaqëson një tërësi pjesësh të cilat punojnë së bashku për të kryer një funksion të caktuar. Ka sisteme në natyrë, si dhe sisteme të ndërtuara nga njeriu. Shembuj të sistemeve në natyrë janë sistemet e trupit të njeriut.

Shembuj të sistemeve të ndërtuara nga njeriu janë sistemet elektrike. Njohja e sistemeve e lejon njeriun të kuptojë si funksionon

secila pjesë e sistemit dhe si ndërveprojnë me njëra-tjetrën për të kryer një funksion të caktuar.

Kjo temë përqendrohet tek studimi i sistemit të bimëve dhe kafshëve, sistemit elektrik, sistemeve të matjes.

Rezultatet e të nxënit

Njohuritë/ Konceptet

Toka dhe Hapësira

- Rrotullimi i Tokës rreth boshtit të saj
- Rrotullimi i Tokës rreth Diellit
- Sistemi Diellor dhe yjet

Shkathësitë dhe procedurat

Nxënësi:

- Përshkruan lëvizjen e Tokës dhe planetëve të tjerë në lidhje me Diellin në sistemin diellor;
- tregon se Toka rrotullohet rreth Diellit sipas një orbite;
- tregon se Hëna rrotullohet rreth Tokës dhe është satelit natyror i saj;
- argumenton se Dielli nuk lëviz, por duket sikur lëviz për shkak të rrotullimit të Tokës rreth vetes dhe rreth Tij;
- tregon se Toka rrotullohet rreth boshtit të saj nga perëndimi në lindje brenda 24 orëve;
- shpjegon se ora e lindjes dhe perëndimit të Diellit ndryshon çdo ditë gjatë vitit;
- përshkruan formimin e ditës dhe natës si pasojë e rrotullimit të Tokës rreth boshtit të saj;
- shpjegon se Toka kryen një rrotullim të plotë rreth Diellit sipas një orbite për 365 e $\frac{1}{4}$ ditë;
- tregon se Dielli, Toka dhe Hëna janë trupa sferikë;
- shpjegon se Dielli është një yll në qendër të sistemit diellor.
- tregon se astronomët përdorin teleskopin për të zbuluar të rejtat e Universit.

Qëndrimet dhe vlerat

Nxënësi:

- Punon në grup për krijimin e një maketi që tregon formimin e ditës dhe natës për shkak të rrotullimit të Tokës rreth boshtit të saj;
- punon në grup për krijimin e një maketi që tregon sistemin diellor;
- realizon një projekt rreth teorive të ndryshme për sistemin diellor”;
- realizon një projekt rreth teorive të ndryshme për Tokën dhe formën e saj.

PLANIFIKIMI VJETOR

SHPËRNDARJA E PËRMBAJTJES LËNDORE			
Tematika	Periudha I 22 orë Temat mësimore	Periudha II 24 orë Temat mësimore	Periudha III 24 orë Temat mësimore
Ciklet	Si rriten bimët? <ol style="list-style-type: none"> 1. Farat 2. Si rritet fara 3. Hulumtimi i mbrirjes 4. Hulumtimi i mbrirjes 5. Për çfarë kanë nevojë bimët që të rriten? 6. Bimët dhe drita 7. Projekt “Bimët që rriten përreth nesh” 8. Projekt “Bimët që rriten përreth nesh” 9. Projekt “Bimët që rriten përreth nesh” 10. Kontrolloni përparimin tuaj Cikli jetësor i bimëve me lule <ol style="list-style-type: none"> 11. Përse bimët kanë lule? 12. Përse bimët kanë lule? 13. Si shpërndahen farat? 14. Si shpërndahen farat? 15. Farat shpërndahen në mënyra të ndryshme 16. Farat shpërndahen në mënyra të ndryshme 17. Pjesët e lules 18. Pjalnimi 19. Hulumtimi i pjalmimit 20. Cikli jetësor i bimës 21. Kontrolloni përparimin tuaj 22. Detyrë përmbledhëse /Test 	Cikli jetësor i kafshëve <ol style="list-style-type: none"> 1. Nevojat jetësore të kafshëve 2. Nevojat jetësore të kafshëve 3. Riprodhimi te kafshët 4. Ciklet jetësore të shpendëve dhe gjitarëve 5. Ciklet jetësore të insekteve dhe amfibëve 6. Kontrolloni përparimin tuaj Gjendjet e lëndës <ol style="list-style-type: none"> 7. Avullimi 8. Pse është i dobishëm avullimi? 9. Hulumtojmë procesin e avullimit 10. Avullimi i lëngut nga tretësira 11. Kondensimi 12. Qarkullimi i ujit në natyrë 13. Qarkullimi i ujit në natyrë 14. Vlimi 15. Shkritja 16. Kontrolloni përparimin tuaj 	

Energjia		<p>Si arrijmë t'i shohim objektet</p> <p>17. Drita përhapet nga burimi i saj</p> <p>18. Pasqyrat</p> <p>19. Si shikojmë pas vetes?</p> <p>20. Cilat sipërfaqe e pasqyrojnë dritën më mirë?</p> <p>21. Drita mund të ndryshojë drejtimin e përhapjes</p> <p>22. Kontrolloni përparimin tuaj</p> <p>23. Projekt "Drita dhe pasqyrimi i saj, përdorimet në jetën e njeriut"</p> <p>24. Detyrë përmbledhëse /Test</p>	<p>Hijet</p> <p>1. Drita përhapet në vijë të drejtë</p> <p>2. Cilat materiale lejojnë kalimin e dritës?</p> <p>3. Siluetat dhe teatri i hijeve</p> <p>4. Siluetat dhe teatri i hijeve</p> <p>5. Ndryshimi i madhësisë së hijes</p> <p>6. Hulumtimi i gjatësisë së hijes</p> <p>7. Hulumtimi i gjatësisë së hijes</p> <p>8. Intensiteti i dritës</p> <p>9. Idetë e shkencëtarëve mbi dritën</p> <p>10. Projekt "Idetë e shkencëtarëve mbi dritën"</p> <p>11. Projekt "Idetë e shkencëtarëve mbi dritën"</p> <p>12. Kontrolloni përparimin tuaj</p>
Sistemet			<p>Toka dhe hapësira</p> <p>13. Dielli, Toka dhe Hëna</p> <p>14. A lëviz Dielli?</p> <p>15. Toka rrotullohet rreth boshtit të saj</p> <p>16. Lindja dhe perëndimi i diellit</p> <p>17. Toka rrotullohet rreth Diellit</p> <p>18. Toka rrotullohet rreth Diellit</p> <p>19. Eksplorimi i sistemit diellor</p> <p>20. Eksplorimi i yjeve</p> <p>21. Kontrolloni përparimin tuaj</p> <p>22. Detyrë përmbledhëse/ Test</p> <p>23. Projekt "Eksplorimi i sistemit diellor"</p> <p>24. Projekt "Eksplorimi i sistemit diellor"</p>

PERIUDHA E PARË
FUSHA: SHKENCAT NATYRORE
LËNDA: DITURI NATYRE

Nr.	Tematikat	Java	Tema mësimore	Situata e parashikuar e të nxënësve	Metodologjia	Vlerësimi	Burimet e materialet didaktike	Data	Dita
1	CIKLET Si rriten bimët?	1	Farat	Çfarë ka brenda?	Përvijim i të menduarit Diskutim	Vlerësim i përgjigjeve me gojë	Programi lëndor Teksti shkollor Fletorja e punës Libri i mësuesit, Enciklopedi		
2			Si rretet fara?	Vëzhgojmë një farë	Pyetje-përgjigje Veprimtari	Vlerësim mes nxënësish			
3		2	Hulumtimi i mbrirjes	Kur mbijnë farat?	Ditari dypjesësh Veprimtari Shkrim i lirë	Vlerësim i veprimtarive të nxënësve në klasë	Material për kryerjen e veprimtarive Fotografi		
4			Hulumtimi i mbrirjes			Vlerësim mbi përfshirjen në proceset gjatë hulumtimit, si: matjet, krahasimet dhe përfundimet			
5		3	Për çfarë kanë nevojë bimët që të rriten?	Rritja e bimës	Pohim Mbështetje Veprimtari Diskutim	Vlerësim i aktivitetit dhe veprimtarive të nxënësve në klasë	Ngjyra, lapsa, aparat fotografik, organizues grafik, video-projektor		
6			Bimët dhe drita			Vlerësim i përfundimeve bazuar në treguesit e përdorur			
7		4	Projekt “Bimët që rriten përreth nesh”	Rritja e bimëve	Projekt	Vlerësim i përgjigjeve me gojë.			
8			Projekt “Bimët që rriten përreth nesh”			Vlerësim i veprimtarive të nxënësve në klasë			

9		5	Projekt “Bimët që rriten përreth nesh”			Vlerësim mes nxënësish			
10			Kontrolloni përparimin tuaj.	Unë di	Parashikim me terma paraprakë Punë e pavarur	Vlerësim me detyrë përmbledhëse dhe prezantime me gojë ose me shkrim	Materiale të ndryshme		
11	CIKLET Cikli jetësor i bimëve me lule	6	Përse bimët kanë lule?	Lulet e bimëve	Harta semantike Lexim i drejtuar Diskutim	Vlerësim diagnostikues nëpërmjet përgjigjeve me gojë.	enciklopedi, material për kryerjen e veprimtarive		
12			Përse bimët kanë lule?			Vlerësim mes nxënësish	metal, dru, plastikë		
13		7	Si shpërndahen farat?	Farat	Braingstorming Lexim rishikim në dyshe Poster	Vlerësim i veprimtarive të nxënësve në klasë	fara të ndryshme, bimë të ndryshme.		
14			Si shpërndahen farat?			Vlerësim i përgjigjeve me gojë.	lule të ndryshme		
15		8	Farat shpërndahen në mënyra të ndryshme	Si shpërndahen farat?	Bisedë Lexim i drejtuar Veprimtari Diskutim	Vlerësim mes nxënësish			

16		Farat shpërndahen në mënyra të ndryshme			Vlerësim individual i veprimtarive të nxënësve në klasë	foto vizore, lapsa, ngjyra	
17	9	Pjesët e lules	Lulja	Tabela T Diskutim	Vlerësim mbi përfshirjen në proceset gjatë hetimit si: matjet krahasime dhe përfundime.	disa bimë në vazò	
18		Pjalnimi	Përse pjalmohen lulet?	Diskutim për njohuritë paraprake Veprimtari Kornizë paragrafi me skelëzim	Vlerësim i aktivitetit dhe veprimtarive të nxënësve në klasë	pjesë të ndryshme të bimës	
19	10	Hulumtimi i pjalmimit			Vlerësim i përfundimeve bazuar në treguesit e përdorur	foto të ndryshme material për poster	
20		Cikli jetësor i bimës	Ndryshimet në jetën e një bime	Diskutim Shpjegim i përparuar	Vlerësim i përgjigjeve me gojë.	ngjyra, lapsa,	
21	11	Kontrolloni përparimin tuaj	Unë di	Dy të vërteta një gënjeshtër Punë e pavarur	Vlerësim i veprimtarive të nxënësve në klasë	video-projektor	
22		Detyrë përmbledhëse/ Test	Unë di	Test	Vlerësim me detyrë përmbledhëse dhe prezantime me gojë ose me shkrim	fleta e testit, lapsa	

PERIUDHA E DYTË
FUSHA: SHKENCAT NATYRORE
LËNDA: DITURI NATYRE

Nr.	Tematikat	Java	Tema mësimore	Situata e parashikuar e të nxënësve	Metodologjia	Vlerësimi	Burimet e materialet didaktike	Data	Dita
23	CIKLET Cikli jetësor i kafshëve	1	Nevojat jetësore të kafshëve	Nevojat e kafshëve	Harta semantike Veprimtari	Vlerësim i aktivitetit dhe veprimtarive të nxënësve në klasë	Programi lëndor. Teksti shkollor fletorja e punës,		
24			Nevojat jetësore të kafshëve	Si lind zogut?	Lexi mi drejtuar Lojë	Vetëvlerësim i nxënësve.	Magnetë të llojeve të ndryshëm		
25		2	Riprodhimi të kafshët.	Ciklet jetësore	Braingstorming Shpjegim i përparuar Diskutim rishikim në dyshe Bisedë Prezantim	Vlerësim mbi përfshirjen në proceset gjatë hulumtimit	ujë, gotë, enë që duron		
26			Ciklet jetësore të shpendëve dhe gjitarëve			Vlerësim diagnostikues	ngrohtësinë, ngrohës,		
27		3	Ciklet jetësore të insekteve dhe amfibëve	Unë di	Turi i galerisë	Vetëvlerësim i nxënësve.	akull, vizore termometër		
28			Kontrolloni përparimin tuaj			Vlerësim me detyrë përmbledhëse dhe prezantime me gojë ose me shkrim.			

29	4	Avullimi	Ku shkon uji?	Pyetje përgjigje Veprimtari	Vlerësim diagnostikues		
30		Pse është i dobishëm avullimi?	Avullimi ftoh	Përvijim i të menduarit Diskutim	Vlerësim mbi përfshirjen në proceset gjatë hulumtimit si: matjet krahasime dhe përfundime.		
31	5	Hulumtojmë procesin e avullimit	Sa është sasia e ujit?	Tabela T Veprimtari	Vlerësim mes nxënësish		
32		Avullimi i lëngut nga tretësira	Tretësirat	Braingstorming Shpjegim i përpunuar	Vlerësim mbi përfshirjen në proceset gjatë veprimtarive si: matjet krahasime dhe përfundime.	enciklopedi grafikë me shtylla	
33	6	Kondesimi	Nga vjen uji?	Veprimtari Diskutim	Vlerësim mbi përfshirjen dhe mendimet e dhëna.	tabela lapsa , vizore	
34		Qarkullimi i ujit në natyrë	Uji në natyrë	Shpjegim i përpunuar Diskutim Poster Pyetje përgjigje	Vlerësim mbi përfshirjen në proceset gjatë hulumtimit	gota, kripë, sheqer, rërë gurë të vegjël	

CIKLET
Gjendjet
e lëndës.

35	
36	
37	
38	
39	
40	
41	

42		Cilat sipërfaqe e pasqyrojnë dritën më mirë?	Pasqyrimi i dritës	Dëgjim i drejtuar Vepimtari	Vlerësim mbi përfshirjen dhe mendimet e dhëna.	Ndriques Dhomë e errët Pasqyrë	
43	11	Drita mund të ndryshojë drejtimin e përhapjes	Si pasqyrohet drita?	Lojë Diskutim	Vlerësim mbi përfshirjen në proceset gjatë hulumtimit	Ndriques Karton në formë disku	
44		Kontrolloni përparimin tuaj	Unë di	Parashikim me terma paraprakë	Vlerësim mes nxënësish Vetëvlerësim i nxënësve.	video-projektor Fleta e testit, lapsa	
45	12	Projekt “Drita dhe pasqyrimi i saj, përdorimet në jetën e njeriut”	Pasqyrimi i dritës	Projekt	Vlerësim me detyrë përmbledhëse dhe prezantime me gojë ose me shkrim		
46		Detyrë përmbledhëse /Test	Unë di	Test	Vlerësim me detyrë përmbledhëse me shkrim		

PERIUDHA E TRETË
FUSHA: SHKENCAT NATYRORE
LËNDA: DITURI NATYRE

Nr	Tematikat	Java	Tema mësimore	Situata e parashikuar e të nxënës	Metodologjia	Vlerësimi	Burimet dhe materialet didaktike	Data	Dita
47	ENERGJIA Hijet	1	Drita përhapet në vijë të drejtë	Përhapja e dritës	Vëzhgim Hulumtim	Vlerësim diagnostikues	Programi lëndor Teksti shkollor Fletorja e punës		
48			Cilat materiale lejojnë kalimin e dritës?	Hija	Diskutim për njohuritë paraprake Veprimtari	Vlerësim mbi përfshirjen në proceset gjatë hulumtimit si: matjet krahasime dhe përfundime	Burime të ndryshme drite Materiale të ndryshme: të tejdrukshme, të patejdrukshme, gjysmë të tejdrukshme		
49		2	Siluetat dhe teatri i hijeve	Marioneta	Bisedë Lojë me role	Vlerësim mes nxënësish Vetëvlerësim	Objekte të ndryshme Ekran		
50			Siluetat dhe teatri i hijeve						
51		3	Ndryshimi i madhësisë së hijes	Formojmë hije	Bisedë Lojë	Vlerësim për përfshirjen dhe për mendimet e dhëna	Aparat për matjen e intensitetit të dritës		
52			Hulumtimi i gjatësisë së hijes	Gjatësia e hijes	Bisedë Veprimtari Lojë	Vlerësim për përfshirjen në hulumtim			

53	4	Hulumtimi i gjatësisë së hijes				Vlerësim mes nxënësish Vetëvlerësim i nxënësve			
54		Intensiteti i dritës	Cili jep intensitetin më të madh?	Shpjegim i përparuar Veprimtari	Vlerësim i aktivitetit dhe veprimtarive të nxënësve në klasë				
55	5	Idetë e shkencëtarëve mbi dritën	Ylberi	<i>Brainstorming</i> Pyetje- përgjigje	Vlerësim i përfundimeve bazuar në treguesit e përdorur				
56		Projekt “Idetë e shkencëtarëve mbi dritën”	Shkencëtarët për dritën	Projekt	Vlerësim me detyrë përmbledhëse dhe prezantime me gojë ose me shkrim në projekt.	Informacione nga enciklopedia dhe interneti Materiale për punimin e projektit			
57	6	Projekt “Idetë e shkencëtarëve mbi dritën”							
58		Kontrolloni përparimin tuaj	Unë di	Diskutim Pyetje përgjigje	Vlerësim me detyrë përmbledhëse dhe prezantime me gojë ose me shkrim.	Fotografi të sistemit diellor Modeli i rrotullimit të Tokës rreth vetes			
59	7	Dielli, Toka dhe Hëna	Çfarë di?	Di, dua të di, mësova	Vlerësim diagnostikues	dhe rreth Diellit Fotografi të			
		SISTEMET Toka dhe hapësira							

8	A lëviz Dielli?	Sa është ora?	Përvijim i të menduarit Lexim i drejtuar	Vlerësim mbi përfshirjen në proceset gjatë hulumtimit si: matjet krahasime dhe përfundime.	Tokës dhe Hënës si satelit i saj Plastelinë me ngjyra
	Toka rrotullohet rreth boshtit të saj	Luajmë “dita dhe nata”	Lojë Përvijim i të menduarit	Vlerësim mes nxënësish	Lapsa me ngjyra Shkopinj Spango projektit
	Lindja dhe perëndimi i diellit	Toka dhe Dielli	Pyetje përgjigje Lexim i drejtuar	Vlerësim mbi përfshirjen në proceset gjatë veprimtarive si: matjet krahasime dhe përfundime.	Letra me ngjyra e të bardha Video që tregojnë sistemin tonë diellor
9	Toka rrotullohet rreth Diellit	Çfarë ndodh gjatë një viti?	Diskutim Lexim rishikim në dyshe Lojë	Vlerësim mbi përfshirjen dhe mendimet e dhëna.	dhe lëvizjen e planetëve në të Fleta grafike Mjete për punimin e projektit Fletë testi Informacione nga enciklopedi dhe interneti Materiale për punimin e

60	61	62	63
----	----	----	----

	Toka rrotullohet rreth Diellit	Dielli dhe planetët			Vlerësim mbi përfshirjen në proceset gjatë hulumtimit			
10	Eksplorimi i sistemit diellor	Dielli dhe planetët		Di, dua të di, mësova	Vlerësim mes nxënësish Vetëvlerësim i nxënësve.			
	Eksplorimi i yjeve	Çfarë është gjithësia?		Shpjegim i përparuar Veprimtari	Vlerësim i aktivitetit dhe veprimtarive të nxënësve në klasë			
11	Kontrolloni përparimin tuaj	Unë di		Diskutim Pyetje- përgjigje	Vlerësim i përfundimeve bazuar në treguesit e përdorur			
	Detyrë përmbledhëse Test	Unë di		Test	Vlerësim me detyrë përmbledhëse dhe prezantime me gojë			

64				
65				
66				
67				
68				

69	12	Projekt “Eksplorimi i sistemit diellor”	Sistemi diellor	Diskutim Pyetje- përgjigje Poster Maket	Vlerësim me detyrë përmbledhëse dhe prezantime me gojë ose me shkrim në projekt		
		Projekt “Eksplorimi i sistemit diellor”			Vlerësim me detyrë përmbledhëse dhe prezantime me gojë ose me shkrim		
70							

Kapitulli 1

Si rriten bimët?

Ora 1

Fusha: Shkencë	Lënda: Dituri natyre	Klasa 5	Data
Tema mësimore: Farat		Situata e të nxënit: Çfarë ka brenda farës?	
Rezultatet e të nxënit sipas temës: <ul style="list-style-type: none">Tregon pjesët përbërëse të farës dhe përse shërbejnë ato.Diskuton gjetjet dhe i përdor për të shkruar konkluzionet e tij/saj.Komunikon me gojë, me shkrim ose me vizatim të dhënat që merr nga vëzhgimet dhe nga regjistrimet.		Fjalë kyçe: farë, embrion, cipa mbrojtëse e farës	
Burimet e mjetet e punës: <i>fruta të ndryshme, foto farash e frutash, një farë e madhe, e freskët, një xham zmadhues</i>		Lidhja me fushat e tjera: Gjuhë shqipe	
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</p> <p>Përvijim i të menduarit: Tregohet para klasës një mollë. Drejtohen pyetjet: <i>Çfarë mund të thoni për mollën? Çfarë është molla? Çfarë ka brenda mollës? A ju ka ndodhur të gëlltitni ndonjë farë? Si janë farat e frutave të ndryshme?</i></p> <p>Nxënësit shohin fruta të tjera natyrale ose në foto dhe tregojnë emërtimin e frutës si dhe përshkruajnë farat e tyre. Prezantohen figurat e paraqitura në fq. 6 të librit. Emërtohen frutat dhe farat e tyre të paraqitura në figura. Nxënësit do të tregojnë nëse vërejnë ngjashmëri apo ndryshime ndërmjet farave të ndryshme.</p> <p>Lexim i përparuar: Drejtohet pyetja: A janë të gjalla farat? Pse mendoni kështu? Lexohet informacioni i dhënë në paragrafin e faqes 6 të librit. Në kushtet e përshtatshme, bima e vogël që ndodhet brenda farës fillon të rritet. Prej andej zhvillohet bima e re. Së bashku vëzhgohet pamja e farës së fasules. Shpjegohen pjesët përbërëse të saj: cipa mbrojtëse, lënda ushqyese rezervë, shenja që tregon se fara ka qenë e lidhur me frytin, si dhe embrioni. Diskutohet se përse shërbejnë këto pjesë të trupit të farës së fasules.</p> <p>Veprimtari:</p> <p>Secili nxënës ka përpara vetes farën e fasules dhe një lupë. Udhëzohen të vëzhgojnë pjesët përbërëse të farës: Gjeneri cipën mbrojtëse të farës. Udhëzohen nxënësit të kenë kujdes gjatë heqjes së cipës mbrojtëse të farës. Ku ka qenë e lidhur fara me frytin? Vizatoni farën dhe emërtoni pjesët e jashtme të saj. Më pas hiqni pjesën mbrojtëse të farës. Çfarë vini re? Si mendoni, përse shërben kjo cipë? Ndani dy gjysmat e farës (thelpinjtë) dhe dallojnë embrionin dhe lëndën ushqyese rezervë të farës. Përse shërben lënda ushqyese rezervë? Si e dalloni embrionin në farë?</p> <p>Bëni vizatimin e dy thelpinjve/ pjesëve të farës së fasules, duke bërë të dukshme dhe emërtuar embrionin në të.</p>			

Përfundimet e vëzhgimit: Më pas, në dyshe vizatimet ia tregojnë dhe shpjegojnë njëri tjetrit. Disa prej nxënësve do t'i prezantojnë vizatimet e tyre para klasës.

Diskutim: Pasi vëzhguat dhe përcaktuat pjesët e farës, jepni mendimin tuaj përse fara ka nevojë për lëndë ushqyese rezervë. Përse shërben cipa mbrojtëse? Fara duhet të zhvillohet. Si mendoni ju, për çfarë ka nevojë fara që të rritet?

Vlerësimi: Vlerësohen për mendimet dhe gjetjet gjatë veprimtarisë së vëzhgimit dhe interpretimit të gjetjeve.

Detyra: Punimi i fq. 8 në Fletoren e punës
Nxënësit mund të kërkojnë informacione mbi farën më të madhe në botë.

Refleksion: Çfarë do të ndodhte nëse fara nuk do të kishte lëndë ushqyese rezervë?

Shënim: Ndhimohen nxënësit në heqjen e cipës mbrojtëse të farës.

Në varësi të kohës, nxënësit mund të punojnë në plastelinë modelin e farës së fasules që sapo vëzhguan.

Ora 2

Fusha: Shkencë	Lënda: Dituri natyre	Klasa 5	Data
Tema mësimore: Si rritet fara?		Situata e të nxënit: Vëzhgojmë një farë	
Rezultatet e të nxënit sipas temës: <ul style="list-style-type: none"> Përshtet kushtet që u duhen bimëve për të jetuar. Planifikon dhe kryen një hetim se si farat kanë nevojë për ujë dhe ngrohtësi për të mbirë, por jo për dritë. Diskuton gjetjet dhe i përdor për të shkruar konkluzionet. Komunikon me gojë, me shkrim ose me vizatim të dhënat që merr nga vëzhgimet dhe regjistrimet. 			Fjalë kyçe: mbirje, vyshket, thith, filiz
Burimet e mjetet e punës: një farë fasuleje, një enë me ujë			Lidhja me fushat e tjera: Gjuhë shqipe
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <p>Diskutohet me gjithë klasën plotësimi i ushtrimeve të f. 8 në Fletoren e punës. Rikujtohen përfundimet e dala prej rubrikave: Kungulli pavarësisht nëse është i ëmbël apo jo ai për bimën e kungullit është fryti në të cilin rriten farat.</p> <p>Drejtohen pyetjet: Cilat janë pjesët e farës? Çfarë funksioni kanë ato? A keni parë se si ndodh mbirja e një fare? Nëse po, tregojeni atë.</p> <p>Leksion i përparuar: Ftohen nxënësit të shohin figurën në faqen 8 të librit të nxënësit. Vëzhgohen fazat e mbirjes dhe të rritjes së farës. Sqarohen nxënësit se, nëse farat janë në kushte të përshtatshme dhe embrioni i tyre është gjallë, ato fillojnë të rriten. Procesi quhet mbirje. Fara e përdor lëndën ushqimore si ushqim për të marrë energji gjatë mbirjes. Pas mbirjes, fara vyshket. Së bashku me nxënësit do të shpjegohet secila fazë e përcaktuar në figurë. Nxënësve u sqarohet se dy kushtet e përshtatshme që një farë të mbijë uji dhe ngrohtësia.</p> <p>Diskutohet mbi kuriozitetin e farës më të vjetër në botë: Çfarë lloj fare ishte? Cilat ishin kushtet që i nevojiteshin farës për të mbirë? A njihni ju raste të farave që ruhen për t'u mbjellë më vonë?</p> <p>Veprimtari: Vëzhgojmë një farë. Nxënësit, të ndarë në dyshe, kanë në bankë një farë fasuleje dhe një enë me ujë, të ngjashme si në figurë. Ftohen nxënësit të parashikojnë se çfarë do të ndodhë me farën? Pse mendojnë kështu? Këtë parashikim e diskutojnë me njëri-tjetrin dhe e shkruajnë në fletore.</p> <p>Sqarohen nxënësit se veprimtarinë do ta vazhdojnë orën e ardhshme. Në atë pikë do të krahasohen parashikimet me ndryshimet që kanë ndodhur.</p> <p>Pyetje-përgjigje: Përse e thith ujin fara? Cila pjesë e bimës rritet në fillim? Përse kjo pjesë rritet duke shkuar më thellë në Tokë? Arrihet në përfundime së bashku me nxënësit se fara, për të filluar procesin e rritjes, ka nevojë për energji, të cilën e merr tek lënda ushqimore rezervë. Gjatë rritjes, fara ka vazhdimisht nevojë për lëndë ushqimore; ajo thellon rrënjët në tokë. Më pas filizi rritet për të dalë mbi tokë; më tej zhvillohen gjethet, që do ta ndihmojnë bimën me procesin e fotosintezës. Përse pas mbirjes fara vyshket dhe bëhet më e vogël? Pas mbirjes, lënda ushqyese rezervë mbaron dhe fara vyshket.</p> <p>Përmbledhje: Punohet në dyshe e më pas me gjithë klasën rubrika “Mësuam se”. Nxënësit bëjnë vizatimin e fazave të rritjes së farës në fletore dhe e prezantojnë atë të shoku/shoqja.</p>			
Vlerësimi: Vlerësohen për mendimet dhe gjetjet gjatë veprimtarisë dhe diskutimeve.			
Detyra: Punimi i faqes 9 në Fletoren e punës.			
Shënim: Vazhdimi i veprimtarisë me farën e fasules mund të kryhet edhe për dy orë të tjera.			

Ora 3

Fusha: Shkencë	Lënda: Dituri natyre	Klasa 5	Data
Tema mësimore: Hulumtimi i mbirjes		Situata e të nxënit: Kur mbijnë farat?	
Rezultatet e të nxënit sipas temës: <ul style="list-style-type: none">Planifikon dhe kryen një hetim se si farat kanë nevojë për ujë dhe ngrohtësi për të mbirë, por jo për dritë.Diskuton gjetjet dhe i përdor për të shkruar përfundimet.Komunikon me gojë, me shkrim ose me vizatim të dhënat që merr nga vëzhgimet dhe nga regjistrimet.		Fjalë kyçe: mbirje, ngrohtësi, ujë	
Burimet e mjete: 40 fara, katër peceta prej letre, ujë, dy pjata plastike të vogla, dy qese plastike, dy pipa, dy lidhëse qesesh, katër kavanoza të mbushur me dhe, ujë, enë e shkallëzuar		Lidhja me fushat e tjera: Gjuhë shqipe, Matematikë	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <p>Diskutim: Rikujtohen fazat e rritjes së farës. Nxënësit diskutojnë me njëri-tjetrin mbi përfundimet e dala në rubrikat e plotësuara në faqen 9 të Fletores së punës. Më pas, gjatë diskutimit me gjithë klasën, përcaktohet edhe faza e parë “fara thith ujin dhe fryhet”; një detyrë që u ishte caktuar nxënësve.</p> <p>Përvijim i të menduarit: Prezantohet dhe shkruhet në dërrasë të zezë pohimi: <i>Farat mbijnë kur kanë kushtet e përshtatshme.</i> Si mendoni ju, cilat janë këto kushte të përshtatshme? A mbijnë farat nëse është shumë nxehtë ose shumë ftohtë? A mbijnë farat pa ujë dhe pa dritë? Duke u bazuar në njohuritë e mëparshme, kërkohet mendimi i nxënësve rreth kushteve që i nevojiten një fare për të mbirë. Mendimet dhe parashikimet e tyre do të merren parasysh.</p> <p>Veprimtari 1: A kanë nevojë për ajër farat që mbijnë? Nxënësve u jepen udhëzime në lidhje me hapat që do të ndjekin për përgatitjen e kushteve, ku do të vendosen farat për të mbirë. Me ndihmën e një nxënësi, mësuesi/ja tregon aktivitetin që do të zhvillohet; nxënësit punojnë në dyshe. Nëpërmjet pyetje-përgjigjeve theksohen së bashku kushtet në të cilat janë vendosur farat për të mbirë: Çfarë bëtë me pecetat, ku u vendosën farat? Çfarë kushti i plotësohet farës për të mbirë? Pse disa fara u vendosën në qese pa ajër? Po të tjerat, në çfarë kushtesh u lanë? Çfarë kanë të njëjtë dhe çfarë ndryshon në kryerjen e këtij eksperimenti?</p> <p>Ditar dypjesësh: Nxënësit e ndajnë fletoren në dy pjesë dhe mbajnë shënime për çdo rast.</p>			
Kushtet - qesja 1		Kushtet - qesja 2	
<div><div><div><div>– janë 10 fara;</div><div>– mbulohen me peceta të lagura;</div><div>– në qese pa ajër;</div><div>– qëndron në ngrohtësi;</div><div>– do të lihen për dy ditë.</div></div><div><div>Parashikimi</div><div></div><div></div><div>Përfundimi</div><div></div><div></div></div></div></div>		<div><div><div><div>– janë 10 fara;</div><div>– mbulohen me peceta të lagura;</div><div>– në qese me ajër;</div><div>– qëndron në ngrohtësi;</div><div>– do të lihen për dy ditë.</div></div><div><div>Parashikimi</div><div></div><div></div><div>Përfundimi</div><div></div><div></div></div></div></div>	

Po tani mendoni se i plotësohen kushtet për të mbirë? Nxiten nxënësit t'u japin përgjigje pyetjeve dhe të shkruajnë parashikimet në fletore. Udhëzohen nxënësit se do të presin dy ditë për të parë se çfarë ka ndodhur me farat dhe nëse parashikimet e bëra kanë qenë të duhurat.

Veprimtari 2: Çfarë kushtesh nevojiten për mbirjen e farave? Udhëzohen nxënësit të ndjekin hapat e përcaktuar në libër si dhe të ndjekin shpjegimin e mësueses për përgatitjen e kushteve në zhvillimin e hulumtimit të radhës. Gjatë çdo faze të përgatitjes së veprimtarisë drejtohen pyetje nga mësuesja:

Çfarë mjetesh na duhen? Nga sa fara do të vendosen në secilin kavanoz? Si është dheu në secilin kavanoz? Në sa kavanoza e lagëm dheun? Si mendoni ju pse? Pse do të vendosen dy kavanoza në një vend të ngrohtë dhe dy kavanozat e tjerë në një vend të ftohtë? Çfarë kanë të përbashkët dyshtet e kavanozave? Çfarë kanë të ndryshme? Bazuar në të përbashkëtat dhe ndryshimet e secilit kavanoz, çfarë parashikoni se do të ndodhë me farat e secilit kavanoz?

Sqarohen nxënësit se farat do të vëzhgohen çdo dy ditë, për tetë ditë rresht. Të dhënat për secilin kavanoz dhe çdoherë që do të vëzhgohen, do të hidhen në tabelë. Diskutohet së bashku me nxënësit mënyra e organizimit të tabelës për hedhjen e të dhënave:

Kavanozi	Dita 1	Dita 2	Dita 3	Dita 4
Kavanozi 1				
Kavanozi 2				
Kavanozi 3				
Kavanozi 4				

Ftohen nxënësit në fletore e tyre të organizojnë të dhënat e tyre në tabelë dhe të shkruajnë parashikimet.

Punohet rubrika “Pyetje dhe detyra”. Diskutohet secili ushtrim i dhënë. Sqarohen nxënësit se për ushtrimin e dytë fillimisht ata do të tregojnë vetëm parashikimin e tyre dhe, në fund të vëzhgimit, do të japin sërish përgjigje, duke dhënë edhe përfundimin e saktë.

Në ushtrimin e tretë, nxënësit në dyshe do të planifikojnë një hulumtim mbi nevojën e farës për dritë. Ata do të përcaktojnë mjetet dhe kushtet me të cilat do të zhvillohet ai. Secila dyshe përcakton parashikimet për të. Udhëzohen nxënësit se këtë veprimtari do ta zhvillojnë në ditët në vazhdim.

Përmbledhje: Punohen së bashku pohimet e dhëna te rubrika “Mësuam se”

Vlerësimi: Vlerësohen nxënësit për mendimet e dhëna gjatë diskutimeve. Vlerësohen për aftësitë e treguara gjatë zhvillimit të veprimtarive hulumtuese në dyshe.

Detyra: Sipas dysheve, nxënësit do të plotësojnë veprimtarinë hulumtuese mbi nevojën e farave për dritë.

Shënim: Për detyrën hulumtuese në shtëpi, nxënësit udhëzohen se do të veprojnë si në klasë. Gjatë ditëve të javës në vazhdim do të mbledhin të dhënat në lidhje me secilën prej veprimtarive. Përfundimet do të diskutohen në orën në vazhdim.

Ora 4

Fusha: Shkencë	Lënda: Dituri natyre	Klasa 5	Data								
Tema mësimore: Hulumtimi i mbirjes		Situata e të nxënit: Kur mbijnë farat?									
Rezultatet e të nxënit sipas temës: <ul style="list-style-type: none">Planifikon dhe kryen një hetim se si farat kanë nevojë për ujë dhe ngrohtësi për të mbirë, por jo për dritë.Diskuton gjetjet dhe i përdor për të shkruar konkluzionet.Komunikon me gojë, me shkrim ose me vizatim të dhënat që merr nga vëzhgimet dhe nga regjistrimet.		Fjalë kyçe: mbirje, ngrohtësi, ujë									
Burimet dhe mjetet e punës: <i>provat e dy veprimtarive hulumtuese të vëzhguara gjatë gjithë javës, shënimet e mbledhura gjatë vëzhgimeve</i>		Lidhja me fushat e tjera: Gjuhë shqipe, Arte, Matematikë									
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</p> <p>Bisedë: Rikujtohen hapat e ndjekur në kryerjen e veprimtarive për hulumtimin e parë. Ftohen nxënësit të tregojnë të dhënat e mbajtura në ditarin dypjesësh. Rikujtohen kushtet në të cilat ishin vendosur farat në qesen e parë. Tregohet qesja pas disa ditësh dhe vëzhgohet se çfarë ka ndodhur me farat në të. Po në të njëjtën mënyrë veprohet edhe me provën tjetër, me farat në qesen e dytë. Ditar dypjesësh: Plotësohet tabela me përfundimet e secilës provë.</p>											
<table><tr><td>Kushtet - qesja 1</td><td>Përfundime</td></tr><tr><td><ul style="list-style-type: none">janë 10 fara;mbulohen me peceta të lagura;në qese nuk kanë ajër;qëndron në ngrohtësi;do të lihen për dy ditë.</td><td><div>Parashikimi</div><div></div><div>Përfundimi</div><div></div><div></div></td></tr></table>		Kushtet - qesja 1	Përfundime	<ul style="list-style-type: none">janë 10 fara;mbulohen me peceta të lagura;në qese nuk kanë ajër;qëndron në ngrohtësi;do të lihen për dy ditë.	<div>Parashikimi</div> <div></div> <div>Përfundimi</div> <div></div> <div></div>	<table><tr><td>Kushtet - qesja 2</td><td>Përfundime</td></tr><tr><td><ul style="list-style-type: none">janë 10 fara;mbulohen me peceta të lagura;në qese me ajër;qëndron në ngrohtësi;do të lihen për dy ditë.</td><td><div>Parashikimi</div><div></div><div>Përfundimi</div><div></div><div></div></td></tr></table>		Kushtet - qesja 2	Përfundime	<ul style="list-style-type: none">janë 10 fara;mbulohen me peceta të lagura;në qese me ajër;qëndron në ngrohtësi;do të lihen për dy ditë.	<div>Parashikimi</div> <div></div> <div>Përfundimi</div> <div></div> <div></div>
Kushtet - qesja 1	Përfundime										
<ul style="list-style-type: none">janë 10 fara;mbulohen me peceta të lagura;në qese nuk kanë ajër;qëndron në ngrohtësi;do të lihen për dy ditë.	<div>Parashikimi</div> <div></div> <div>Përfundimi</div> <div></div> <div></div>										
Kushtet - qesja 2	Përfundime										
<ul style="list-style-type: none">janë 10 fara;mbulohen me peceta të lagura;në qese me ajër;qëndron në ngrohtësi;do të lihen për dy ditë.	<div>Parashikimi</div> <div></div> <div>Përfundimi</div> <div></div> <div></div>										
<p>Në dyshe, nxënësit i tregojnë njëri-tjetrit parashikimet e bëra, duke i argumentuar ato dhe i krahasojnë me përfundime e gjetura.</p> <p>Bisedë: çfarë kushtesh nevojiten për mbirjen e farave? Rikujtohen hapat e ndjekur në zhvillimin e veprimtarisë, kushtet në të cilat u vendosën farat për t’u rritur. Vëzhgohen të dhënat e hedhura në tabela gjatë gjithë javës.</p> <p>Vëzhgim i ndryshimeve të ndodhura gjatë javës në katër ditët e vëzhgimit.</p> <p>Diskutohen së bashku me nxënësit të dhënat e hedhura në tabelë:</p>											
Kavanozi	Dita 1	Dita 2	Dita 3	Dita 4							
Kavanozi 1											
Kavanozi 2											
Kavanozi 3											
Kavanozi 4											

Diskutohen me gjithë klasën parashikimet dhe përfundimet. Nxënësit japin mendimet dhe argumente në lidhje me nevojën e farave për lagështi, ngrohtësi dhe ajër për të mbirë. Diskutim: A kanë nevojë farat për dritë? Nxënësi prezantojnë veprimtarinë e zhvilluar si detyrë në shtëpi dhe paraqesin përfundimet e tyre: farat kanë nevojë për ujë, ngrohësi dhe ajër. Shkrim i lirë: Ftohen nxënësi të shkruajnë çfarë mendojnë për pyetjen:

Për çfarë kanë nevojë farat që të rriten? Disa prej shkrimeve të lira lexohen me dëshirë nga nxënësit.

Vlerësimi: Vlerësohen nxënësit për përfshirjen në veprimtaritë hulumtuese, për mendimet e dhëna gjatë daljes në përfundime. Vlerësohen për aftësitë e treguara gjatë zhvillimit të veprimtarive hulumtuese në dyshe.

Detyra: Punimi i faqes. 10-11 të Fletores së punës

Reflektim: Përse shumica e farave mbijnë në pranverë?

Shënim: Shkrimi i lirë mund të shoqërohet edhe me vizatim.

Ora 5

Fusha: Shkencë	Lënda: Dituri natyre	Klasa 5	Data
Tema mësimore: Për çfarë kanë nevojë bimët që të rriten?		Situata e të nxënit: Rritja e bimës	
Rezultatet e të nxënit sipas temës: <ul style="list-style-type: none"> – Përshekruan kushtet që ju duhen bimëve për të jetuar. – Provon se bimët kanë nevojë për energjinë e dritës së diellit për t’u rritur. – Diskuton gjetjet dhe i përdor për të shkruar konkluzionet. – Komunikon me gojë, me shkrim ose me vizatim të dhënat që merr nga vëzhgimet dhe nga regjistrimet. – Tregon kuriozitet, kur heton faktorët që ndikojnë në mbijetesën e bimëve. 			Fjalë kyçe: faktorë, rritje bimë, energji
Burimet e mjete: vizore, lapsa, libri i nxënësit			Lidhja me fushat e tjera: Gjuhë shqipe, Matematikë
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Harta e mendimit: Pasi shkruhet në dërrasë fjala “Bimë” ftohen nxënësit të thonë se çfarë dinë për të. Tërhiqet vëmendja e nxënësve në tregimin e njohurive rreth nevojave të bimëve për t’u rritur.			
Pas plotësimit të hartës së mendimit, jepet pohimi: Bimët kanë nevojë për ujë ngrohtësi, dritë dhe ajër. Pohim mbështetje: Nxënësi do të lexojnë individualisht materialin në faqen 12 të librit të nxënësit. Qëllimi i leximit është që nxënësit gjatë leximit të gjejnë materiale të cilat e vërtetojnë pohimin e mësipërm. Nxënësit orientohen që gjatë leximit të përqendrohen për të gjetur e për të shkruar në fletore nevojat e bimës për ujë, ngrohtësi dhe dritë. Bima ka nevojë për:			

Ujë _____


Ngrohtësi _____

Dritë/Energji e dritës _____

Ajër _____

Përmbledhje: Nxënësit diskutojnë në dyshe gjetjet e tyre. Më pas këto gjetje diskutohen me gjithë klasën.

Veprimtari: Lexohet situata e paraqitur në veprimtari. Udhëzohen nxënësit të studiojnë me vëmendje të dhënat në tabelë. Ftohen nxënësit të japin mendime se si do të organizohen të dhënat e tabelës në një grafik me shtylla. Drejtohen pyetjet: Cilat të dhëna mund të vendosen në boshtin horizontal? Cilat të dhëna mund të vendosen në boshtin vertikal? Udhëzohen nxënësit që në boshtin horizontal të hidhen të dhënat orientuese për bimën dhe në atë vertikal lartësia e bimës në cm.



Pasi nxënësit vizatojnë grafikun në fletoret e tyre, ata e krahasojnë me njëri-tjetrin. Vizatohet në dërrasë dhe shpjegohen të dhënat e hedhura në të nga disa nxënës. Nxënësit e tjerë bëjnë krahasime me grafikët e tyre.

Drejtohet pyetja: Ku e keni më të lehtë t'i lexoni të dhënat, në tabelë apo në grafik? Bazuar në të dhënat që shihni, cila bimë është rritur më mirë dhe më shumë? Cila bimë është rritur më pak? Pse bima e Martinit ishte e thatë dhe me ngjyrë kafe? Përse bima e Lirës ishte më e vogël se bima e Anit? Shpjegoni, përse bima e Teas ishte e hollë dhe e dobët dhe bojë bronzi?

Punë e pavarur: Nxënësit shkruajnë në fletore parashikimin se sa mund të jetë e lartë një bimë e mbjellë në serë dhe e ujitur. Parashikimin e tyre e prezantojnë me një tjetër grafik në fletore.

Përfundime: Nxënësit japin mendimet e tyre në lidhje me parashikimet dhe argumentimin e mendimit nëpërmjet plotësimit ose jo të nevojave të një bime të mbjellë në serë.

Faktorët që ndikojnë në rritjen e bimës janë: energjia e dritës, uji, ajri dhe ngrohtësia.

Vlerësimi: Vlerësohen nxënësit për identifikimin e nevojave të bimës si dhe për paraqitjen e të dhënave të sakta në grafik me shtylla.

Detyra: Punimi i faqes 12 të Fletores së punës

Refleksion: A kanë nevojë bimë për dhe që të rriten?

Shënim:

Ora 6

Fusha: Shkencë	Lënda: Dituri natyre	Klasa 5	Data
Tema mësimore: Bimët dhe drita		Situata e të nxënit: Rritja e bimës	
Rezultatet e të nxënit sipas temës: <ul style="list-style-type: none">– Përshkruan kushtet që u duhen bimëve për të jetuar.– Provon se bimët kanë nevojë për energjinë e dritës së diellit për t’u rritur.– Diskuton gjetjet dhe i përdor për të shkruar konkluzionet.– Komunikon me gojë, me shkrim ose me vizatim të dhënat që merr nga vëzhgimet dhe regjistrimet.– Tregon kuriozitet, kur heton faktorët që ndikojnë në mbijetesën e bimëve.		Fjalë kyçe: energjia e dritës	
Burimet e mjete: <i>dy vazo me bimë të ngjashme, një dollap i errët, ujë, enë me shkallëzim, një vizore, lapsa</i>		Lidhja me fushat e tjera: Gjuhë shqipe, Fizikë, Matematikë	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <p>Diskutim: Nxënësit tregojnë përfundimet e punimit të rubrikave të faqes 12 të Fletores së punës. Kështu; bima e Almës kish nevojë për ujë, sepse bima ishte tharë. Në rubrikën e dytë nxënësit do të argumentojnë nevojën e bimës për ngrohtësi. Dhe në rubrikën e tretë do të prezantohen të gjithë elementë për të cilët ka nevojë bima që të rritet e shëndetshme: ujë, dritë, ngrohtësi, ajër.</p> <p>Veprimtari: Prezantohen nxënësit me veprimtarinë që do të kryejnë. Qëllimi i kësaj veprimtarie është identifikimi i nevojës së bimës për dritën e diellit. Paraqiten dy vazo me lule të njëjta. Ftohen nxënësit të vizatojnë në fletore tabelën si në faqen 14 të librit, ku do të hedhin të dhënat gjatë ditëve në vazhdim.</p> <p>Përcaktohen lulet A dhe B. Bëhet matja e lartësive të tyre dhe shkruhet në tabelë. Udhëzohen nxënësit në hapat që do të ndiqen gjatë veprimtarisë. Të dyja bimët do të ujiten me të njëjtën sasi uji në të njëjtën kohë. Vëzhgimi dhe matja e lartësisë së bimëve do të kryhet çdo katër ditë për tri javë.</p> <p>Të dhënat e matjeve do të shkruhen në tabelë. Ftohen nxënësit të parashikojnë se cila lule do të jetë rritur më e shëndetshme për tri javë. Drejtohen pyetjet:</p> <p>Cila bimë u rrit më mirë? Pse mendoni kështu? Çfarë faktorësh mendoni se ndikojnë? Mendoni se kjo do të jetë një provë e drejtë? Nxënësit shkruajnë parashikimet e tyre në fletore.</p> <p>Gjithashtu udhëzohen për ndërtimin e një grafiku, ku do të hidhen të dhënat e hulumtimit në lidhje me lartësinë e bimëve.</p> <p>“A e gjeni dot?”</p> <p>Në grupe, nxënësit diskutojnë dhe planifikojnë një provë të rregullt nëpërmjet së cilës do të reagojnë se bimët kanë nevojë për ajër që të rriten. Përfaqësuesit e grupeve prezantojnë veprimtarinë që do të organizojnë dhe si do të veprojnë për të kryer një provë të drejtë. Gjithashtu përcaktohen parashikimet dhe mënyra se si do të mblidhen të dhënat.</p>			

Diskutim: Nxënësit japin mendime rreth çështjes: Bimët përdorin energjinë e dritës për të prodhuar ushqimin në gjethë. Rikujtohet procesi i fotosintezës dhe rëndësia e energjisë së dritës që të kryhet ky proces.

Vlerësimi: Vlerësohen nxënësit për mendime e dhëna gjatë diskutimeve. Vlerësohen për aftësitë e treguara gjatë zhvillimit të veprimtarive hulumtuese në dyshe.

Detyra: Punimi i faqes 13 të Fletores së punës

Refleksion: Përse disa bimë që jetojnë në hije, rriten dhe bëhen shumë të mëdha?

Shënim: Gjatë ditëve të javëve në vazhdim do të mbledhin të dhënat në vazhdim mbi rritjen e bimëve në kushte të ndryshme në drejtim të dritës. Përfundimet do të diskutohen në orët në vazhdim.

Ora 7 dhe 8

Fusha: Shkencë	Lënda: Dituri natyre	Klasa 5	Data
Tema mësimore: Projekti “Bimët që rriten përreth nesh” Tema mësimore: Projekti “Bimët që rriten përreth nesh”		Situata e të nxënës: Rritja e bimëve	
Rezultatet e të nxënës sipas temës: <ul style="list-style-type: none"> – Përshkruan kushtet që u duhen bimëve për të jetuar. – Provon se bimët kanë nevojë për energjinë e dritës së diellit për t’u rritur. – Diskuton gjetjet dhe i përdor për të shkruar konkluzionet. – Komunikon me gojë, me shkrim ose me vizatim të dhënat që merr nga vëzhgimet dhe regjistrimet. – Tregon kuriozitet kur heton faktorët që ndikojnë në mbijetësinë e bimëve. 			Fjalë kyçe: bimë, nevojat e bimëve, dritë,
Burime dhe mjete: fletore, lapsa, gomë, zmadhues, vizore, aparat fotografik			Lidhja me fushat e tjera: Gjuhë shqipe, Matematikë, Fizikë
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <p>Diskutim: Ftohen nxënësit që në dyshe të prezantojnë përfundimet e punimeve të faqes 13 të Fletores së punës.</p> <p>Projekt: Zhvillohet bisedë me nxënësit për të prezantuar qëllimin dhe pritshmërinë e projektit. U bëhet e ditur se nëpërmjet këtij projekti ata do të tregojnë mbi njohuritë e marra në lidhje me nevojat që kanë bimët për t’u rritur të shëndetshme. Realizimin e këtyre nevojave nxënësit do ta vëzhgojnë në natyrën përreth tyre.</p> <p>Pyetja që ngrihet është: Si e shohim në natyrën që na rrethon? Bimët dhe kushtet në të cilat jetojnë ato.</p> <p>Sqarohen nxënësit se do të zhvillohen dy orë mësimi jashtë klasës. Gjatë kohës që do të kalohet në natyrë, nxënësit do të studiojnë e vëzhgojnë bimë të ndryshme dhe kushtet në të cilat rriten ato. Të organizuar në grupe, nxënësit udhëzohen mbi hapat që do të ndjekin në punën e tyre. Kështu, bazuar në çfarë kanë mësuar të ngrenë pyetje mbi çfarë duan të dinë, p.sh.: <i>Cilat janë llojet e bimëve që jetojnë në mjedisin përreth nesh? Çfarë pamje kanë? Pse? Për çfarë kanë nevojë? Në çfarë kushtesh jetojnë?</i></p>			

Nxënësit do të organizojnë rolet brenda grupit. Gjithashtu do të përcaktojnë se çfarë të dhënash do të mbledhin dhe si do t'i hedhin ato në fletore.

Vëzhgim në natyrë: Nxënësit do të zhvillojnë vëzhgimet e tyre në oborrin ose parkun pranë shkollës në mjedisin e përcaktuar nga mësuesja. Ata do të kërkojnë për lloje të ndryshme bimësh. Gjatë vëzhgimeve, duke përdorur mjete të ndryshme, p.sh.: vizore, zmadhues, aparat fotografik etj., do të mbledhin të dhëna dhe do t'i shkruajnë shënimet në fletore. Këshillohen të tregohen të kujdesshëm, duke mos i prekur lulet e panjohura për ta apo ato që kanë gjemba ose dëmtojnë lëkurën.

Rishikojnë pyetjet e ngritura si grup dhe sigurohen se me të dhënat që kanë mbledhur mund t'u japin përgjigje. Gjithashtu do të përshkruajnë bimët nga pamja e jashtme dhe do t'i grupojnë: bimë të shëndetshme, bimë që janë rritur në vende pa dritë, bimë që janë rritur në vende me lagështi, bimë që janë rritur në vende të thata.

Përforsim: Rikujtohen nxënësit se pjesë e prezantimit të projektit do të jenë të gjithë elementet e mbledhura gjatë vëzhgimit, interpretimet e tyre si dhe vizatimi i bimëve të ndryshme të cilat ishin pjesë e vëzhgimit. Udhëzohen se në orën në vazhdim do të punojnë për prezantimin e projektit. Gjatë punës së grupeve mësuesja mbështet dhe sugjeron punën e tyre.

Vlerësimi: Vlerësohen angazhimet dhe idetë individuale në lidhje me punën hulumtuese.

Vlerësohen mendimet që japin gjatë diskutimeve në punën në grup dhe frymën bashkëpunuese.

Detyra: Punimi i detyrave si pjesëtar i grupit në projekt.

Refleksion: Cila bimë të duket më e veçanta?

Shënim: Puna me projektin dhe prezantimin e tij do të vazhdojë dhe në orën e ardhshme

Ora 9

Fusha: Shkencë	Lënda: Dituri natyre	Klasa 5	Data
Tema mësimore: Projekti “Bimët që rriten përreth nesh”		Situata e të nxënit: Rritja e bimëve	
Rezultatet e të nxënit sipas temës: <ul style="list-style-type: none">– Përshkruan kushtet që u duhen bimëve për të jetuar.– Provon se bimët kanë nevojë për energjinë e dritës së diellit për t’u rritur.– Diskuton gjetjet dhe i përdor për të shkruar konkluzionet.– Komunikon me gojë, me shkrim ose me vizatim të dhënat që merr nga vëzhgimet dhe regjistrimet.– Tregon kuriozitet kur heton faktorët që ndikojnë në mbijetesën e bimëve.		Fjalë kyçe: bimë, nevojat e bimëve	
Burime dhe mjete: fletore, lapsa, gomë, zmadhues, vizore, fotografi		Lidhja me fushat e tjera: Gjuhë shqipe, Matematikë, Fizikë	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <p>Bisedë: Në qendër të dërrasës shkruhet tema e projektit “Bimët që rriten përreth nesh”. Ftohen përfaqësues të grupeve të paraqesin pritshmërinë dhe të tregojnë shkurtimisht se deri ku kanë arritur me mbledhjen e të dhënave dhe organizimin e tyre në funksion të projektit të grupit.</p>			

<p>Projekt: Vazhdohet puna në grupe në përpunimin e të dhënave, paraqitjet grafike të tyre, formulimin e përfundimeve. Gjatë punës me prezantimin e projektit nxënësit mbështeten nga mësuesja.</p> <p>Prezantime: Ekspozohen punimet e grupeve përreth klasës. Përcaktohet koha që ka në dispozicion secili grup për të bërë prezantimin. Sqarohet se brenda kësaj kohe, pjesëtarë të tjerë të grupit kanë të drejtë të plotësojnë. Përfaqësuesit e grupeve bëjnë me radhë prezantimet e punëve të grupit. Në mbarim të prezantimit, diskutohet dhe vlerësohet puna e grupit për projektin.</p>	
<p>Vlerësimi: Vlerësim i projektit për grup dhe kontributit të secilit në realizimin e tij.</p>	
<p>Detyra:</p>	<p>Refleksion: Në cilën pjesë të projektit mësove më shumë?</p>
<p>Shënim: Në varësi të kohës, prezantimi i projekteve mund të vazhdojë dhe një pjesë të orës në vijim.</p>	

Ora 10

Fusha: Shkencë	Lënda: Dituri natyre	Klasa 5	Data
Tema mësimore: Kontrolloni përparimin tuaj.		Situata e të nxënit: Unë di.	
Rezultatet e të nxënit sipas temës: <ul style="list-style-type: none">– Përshkruan kushtet që ju duhen bimëve për të jetuar.– Provon se bimët kanë nevojë për energjinë e dritës së diellit për t’u rritur.– Argumenton nevojën që kanë farat për ujë dhe ngrohtësi për të mbirë por jo për dritë.– Diskuton gjetjet dhe i përdor për të shkruar konkluzionet.– Komunikon me gojë, me shkrim ose me vizatim të dhënat që merr nga vëzhgimet dhe regjistrimet.		Fjalë kyçe: bimë, farë, kushte për të jetuar	
Burime dhe mjete: enciklopedi, projekti, materiale nga interneti		Lidhja me fushat e tjera: Gjuhë shqipe, Matematikë, Fizikë	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Parashikim me terma paraprakë: Duke përdorur këto fjalë: farë, embrion, ujë, ngrohtësi, ajër , nxënësit do të bëjnë një përshkrim të shkurtër mbi njohuritë e marra gjatë këtyre temave. Lexim me dëshirë i shkrimeve të nxënësve. Punë e pavarur: Plotësim i rubrikave të dhëna në faqen 16-17 në libër. Krahësim dhe diskutim në dyshe të plotësimeve të tyre. Përfaqësues të dysheve prezantojnë përfundimet për secilën rubrikë. Prezantime: Vazhdohet me prezantimet e projekteve “Bimët që rriten përreth nesh”			
Vlerësimi: Vlerësimi individual në punimin e rubrikave të librit, argumentimin e mendimeve dhe qëndrimeve që mbajnë.			
Detyra: Punimi i faqes 14 të Fletores së punës		Refleksion: Trego si u ndjeve gjatë rikujtimit dhe diskutimit të këtyre temave.	
Shënim:			

Kapitulli 2

Cikli jetësor i bimëve me lule

Ora 1 dhe 2

Fusha: Shkencë	Lënda: Dituri natyre	Klasa 5	Data
Tema mësimore: Përse bimët kanë lule? Tema mësimore: Përse bimët kanë lule?		Situata e të nxënit: Lulet e bimëve	
Rezultatet e të nxënit sipas temës: Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> – tregon se çdo organizëm i gjallë rritet dhe riprodhohet; – diskuton gjetjet dhe i përdor për të shkruar përfundimet; – vëzhgon riprodhimin te bimët dhe përshkruan shkurtimisht se bimët prodhojnë lule; – shpreh me gojë, me shkrim ose me vizatim, të dhënat që merr nga vëzhgimet dhe regjistrimet. 			Fjalë kyçe: aromë, vyshket, riprodhim
Burimet dhe mjetet: fruta të ndryshme, fotografi farash e frutash, një farë e madhe, e freskët, një lupë			Lidhja me fushat e tjera: Gjuhët (Gjuhë shqipe), Shkencat (Kimi Biologji), Art
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Harta semantike:</i> Shkruhen në dërrasë pyetjet: Përse bimët kanë lule? A janë të gjitha lulet njëlloj? Si mendoni, a janë të bukura të gjitha lulet? Çfarë funksioni kanë lulet? A kanë aromë të gjitha lulet? Nxënësit japin mendimet dhe me to plotësohet “Harta semantike”. <i>Lexim i drejtuar:</i> Ftohen nxënësit të shohin në faqen 18 të librit. Përse po diskutojnë vajzat në figurë? A mund t’u jepni përgjigje pyetjeve të vajzave? Sqarohen nxënësit se përgjigjet do t’i gjejnë së bashku gjatë leximit dhe diskutimit të materialit të dhënë në libër. Nxiten nxënësit të shohin fotografitë e luleve dhe të lexojnë pohimet për secilën prej tyre. Pas leximit diskutohet: Ç’mund të thoni për format e luleve? Ç’mund të thoni për ngjyrat e luleve? Ç’mund të thoni për aromat e luleve? Si mendoni, përse thuhet se lulet, pavarësisht ndryshimeve midis tyre, kryejnë të njëjtin funksion? Cili mund të jetë ai? Ftohen nxënësit të hamendësojnë funksionin e lules. Vazhdohet leximi i paragrafit në faqen 19 të librit. A e gjetët tani funksionin e lules? Sa kohë jetojnë lulet? Çfarë ndodh me to pas disa ditësh? A thahet e gjithë lulja? Ç’pjesë e saj mbetet në pemë? Nga u formua fryti? Çfarë rritet brenda frytit? Çfarë ndodh me farat? Nga dalin bimët e reja? Pse thuhet se lulja mundëson riprodhimin? <i>Kornizë paragrafi me skelëzim:</i> Nxënësit plotësojnë paragrafin e dhënë në ushtrimin 1 të rubrikës “Pyetje dhe detyra”. Diskutohen në dyshe dhe më pas disa prej nxënësve lexojnë me dëshirë plotësimin e paragrafit, duke e krahasuar me plotësimin e gjithë klasës. Siç janë në dyshe, diskutojnë dhe pyetjen 2, e cila më pas diskutohet me gjithë klasën. Nëse nxënësit nuk janë të sigurt, iu sugjerohet të rilexojnë paragrafin e fillimit të faqes 19 të librit, për të gjetur përgjigjen e duhur. Në vazhdim, nxënësit do të dalin në oborrin e shkollës ose në kopshtin më të afërt, për të parë lloje të ndryshme lulesh.			

Veprimtari: Udhëzohen nxënësit se gjatë kësaj veprimtarie, ata do të vëzhgojnë në natyrë lloje të ndryshme lulesh. Më pas do të mbledhin lulet. Tërhiqet vëmendja të kenë kujdes gjatë mbledhjes së luleve nga ndonjë gjemb apo e papritur. Lulet do t'i grupojnë sipas madhësisë, sipas ngjyrës ose sipas aromës. Më pas do të tregojnë dhe përshkruajnë grupet e luleve. Sa grupe u formuan? I njihni këto lule? Si quhen? Nxënësit do t'i vizatojnë ato në fletore.

Në përfundim, secili nxënës/e (ose në grupe dyshe) paraqet lulet që ka vizatuar dhe përshkruan të përbashkëtën e luleve të secilit grup. Diskutohet: A vutë re bimë që nuk kishin lule? Si mendoni, cilat bimë nuk kanë lule?

Lexim/rishikim në dyshe: Përforcohen njohuritë me punimin në dyshe, dhe më pas me gjithë klasën, të rubrikës “Mësuam se”.

Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për dhënin e mendimeve gjatë veprimtarisë dhe për interpretimin e gjetjeve. Secili nxënës vlerësohet për punën individuale në plotësimin e rubrikës “Pyetje dhe detyra”.

Detyra: Punimi i faqes 15 në *Fletoren e punës*

Nxënësit do të kërkojnë informacione për lulet.

Refleksion: Përshkruaj, cila është lulja jote e preferuar?

Shënim: Pjesa e dytë dhe ora e dytë e mësimit zhvillohet jashtë klase. Gjatë kësaj ore ndihmohen nxënësit në mbledhjen e luleve.

Në pamundësi të zhvillimit të orës jashtë klase, nxënësve mund t'u shfaqen fotografi të luleve të ndryshme dhe ata mund t'i vizatojnë ose të punojnë me fletë me ngjyra për të krijuar grupe lulesh me madhësi të njëjtë ose me ngjyra të njëjta.

Ora 3

Fusha: Shkencë	Lënda: Dituri natyre	Klasa 5	Data
Tema mësimore: Si shpërndahen farat?		Situata e të nxënit: Farat	
Rezultatet e të nxënit sipas temës: Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> vëzhgon mënyra të ndryshme të shpërndarjes së farave dhe tregon me shembuj se insektet pjallojnë disa lule; tregon se te bimët me lule, fryti mbron farat dhe i ndihmon ato të shpërndahen; shpreh me gojë, me shkrim ose me vizatim, të dhënat që merr nga vëzhgimet dhe regjistrimet. 			Fjalë kyçe: shpërndarja e farave
Burimet dhe mjetet: fotografi të bimëve të ndryshme: disa prej tyre janë shumë pranë njëra-tjetrës, ndërsa të tjerat, larg nga njëra-tjetra			Lidhja me fushat e tjera: Gjuhët (Gjuhë shqipe), Shkencat (Kimi Biologji), Art
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Brainstorming: Në dërrasë shkruhet fjala “Fara”. Ftohen nxënësit të tregojnë çfarë dinë për farat. Drejtohen pyetjet: Ku i mban bima farat? Si mendoni, ju pse? Sqarohen nxënësit se farat ndodhen dhe zhvillohen në frytin e bimëve. Fryti i mbron dhe ndihmon në shpërndarjen e tyre.			

Drejtohen pyetjet: Si mendoni ju, përse është e nevojshme të shpërndahen farat e bimëve? Çfarë do të ndodhte nëse farat do të rriteshin dhe do të mbinin pranë bimës mëmë? Ftohen nxënësit të shohin fotografinë e bimëve në faqen 20 të librit, ose një pamje të ngjashme me të. Si janë të vendosura lulet? Çfarë ka ndodhur me bimët e reja? Duke qenë aq pranë me njëra-tjetrën, a arrijnë ato të marrin dritën e mjaftueshme për t'u rritur të shëndetshme?

Shpjegim i përparuar: Sqarohen nxënësit se bimët kanë nevojë për hapësirë. Ato kanë nevojë për dritë dhe ujë, që të rriten të shëndetshme. Që bimët të kenë hapësirën e nevojshme për t'u rritur, farat duhet të shpërndahen larg. Ftohen nxënësit të shohin tri figurat e dhëna në faqen 20 të librit. Duke parë figurat, nxënësit do të japin mendime se si shpërndahen farat për secilin rast të paraqitur në figurë. Së bashku me nxënësit arrihet në përfundimin se, në figurën e parë farat shpërndahen nëpërmjet ujit, në figurën e dytë nëpërmjet ngecjes/ngjitjes në trupin e njeriut (në këtë rast) dhe në figurën e tretë, nëpërmjet erës. Ndalemi te fotografia e dytë, ku sqarohet se ashtu siç ka ndodhur me farat e ngecura në çorapet e djalit, ashtu ndodh që farat të ngecen në trupin/ gëzofin e kafshëve të ndryshme kur ato kalojnë përmes tyre. Pra, shpërndarja e farave mund të ndodhë dhe nëpërmjet kafshëve.

Diskutohet për figurat e faqes 21 të librit dhe për mënyrat e shpërndarjes së farave në secilën prej tyre: shpërndarja e farave nga shpendët gjatë fluturimit, si dhe nga kafshët e tjera, kur ato i mbledhin për ushqim për vete, duke rënë nga gëzofi i tyre.

Lexim/rishikim në dyshe: Nxënësit do të lexojnë informacionin e dhënë në faqet 20 dhe 21 të librit. Ata do të përmbledhin të dhënat me njëri-tjetrin në lidhje me shpërndarjen e farave. Më pas, këto të dhëna do të diskutohen me të gjithë klasën.

Ndohen nxënësit në grupe dhe udhëzohen se veprimtarinë e parashikuar në faqen 21 të librit do ta zhvillojnë në orën në vazhdim. Për këtë do të gjejnë informacione nga materiale të ndryshme dhe do t'i sjellin ato në klasë për t'i punuar sipas grupeve.

Pyetje-përgjigje: Nxënësit fillimisht punojnë individualisht në fletore rubrikën “ Pyetje dhe detyra”.

Më pas i diskutojnë në dyshe dhe më pas me gjithë klasën. Me dëshirë, nxënësit tregojnë vizatimet e tyre me lloje të ndryshme farash, që shpërndahen nëpërmjet gëzofit të një kafshe.

Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për mendimet dhe përgjigjet gjatë diskutimeve.

Detyra: Mbledhje materiale të ndryshme në lidhje me farat e bimëve dhe shpërndarjen e tyre.

Shënim: Udhëzohen nxënësit që për orën në vazhdim të sjellin materiale nga enciklopedi të ndryshme, ku tregohet për llojet e farave dhe shpërndarjen e tyre. Theksohet rëndësia e përcaktimit të autorit të materialit, nga i cili është marrë informacioni.

Ora 4

Fusha: Shkencë	Lënda: Dituri natyre	Klasa 5	Data
Tema mësimore: Si shpërndahen farat? (Punimi i posterit)		Situata e të nxënit: poster	
Rezultatet e të nxënit sipas temës: Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">– tregon se te bimët me lule, fryti mbron farat dhe i ndihmon ato të shpërndahen;– studion farat dhe arrin në përfundime rreth shpërndarjes së tyre;– krijon poster për farat dhe mënyrat e shpërndarjes së tyre;– shpreh me gojë, me shkrim ose me vizatim, të dhënat që merr nga vëzhgimet dhe regjistrimet.		Fjalë kyçe: shpërndarja e farave	
Burimet dhe mjetet: materiale të ndryshme në lidhje me farat dhe shpërndarjen e tyre		Lidhja me fushat e tjera: Gjuhët (Gjuhë shqipe), Shkencat (Kimi Biologji), Arte	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <p><i>Diskutim për njohuritë paraprake:</i> Ku gjenden farat e bimëve? Çfarë funksioni kanë farat? A është e nevojshme që farat të shpërndahen? Pse?</p> <p><i>Veprimtari:</i> Hulumtimi i shpërndarjes së farave. Detyra e nxënësve në këtë veprimtari është ndërtimi i një posterit me vizatime e fotografi, nëpërmjet të cilave të paraqesin informacionet që kanë gjetur në lidhje me farat dhe shpërndarjen e tyre. Tërhiqet vëmendja që në pjesë të posterit të shkruajnë titujt dhe emrat e autorëve të materialeve, në të cilat kanë përzgjedhur informacionin apo fotografitë. Posterit duhet të përmbajë edhe rubrikën “Përfundime”, në të cilën nxënësit, në mënyrë të përmbledhur, do të japin mendimin e tyre.</p> <p>Organizohen nxënësit në grupet e ndara që një orë më parë. Udhëzohen të prezantojnë me radhë (secili pjesëtar i grupit) materialet e sjella. Përcaktojnë së bashku mënyrën se si do të paraqitet materiali në poster. Ndahen punët brenda grupeve dhe secili nxënës kryen detyrën e vet. Gjatë kohës që nxënësit punojnë, mësuesi/ja i vëzhgon dhe i ndihmon në raste nevojë.</p> <p>Turi i galerisë: Secili grup ekspozon posterin e tij. Prezantimin e posterit e bën një pjesëtar i grupit, të cilit i është caktuar nga vetë grupi kjo detyrë. Në përfundim të çdo prezantimi, secili grup do të japë një vlerësim pozitiv në lidhje me temën për punën e grupit që sapo prezantoi.</p>			
Vlerësimi: Përdoren veprimtaritë e mëparshme për të kuptuar se çfarë dinë nxënësit për temën mësimore. A janë në gjendje të përzgjedhin materialin e nevojshëm për prezantim? A i argumentojnë zgjedhjet e tyre? Nxënësit vlerësojnë punën e tyre individuale dhe të grupeve ku punuan. Ata vlerësojnë gjithashtu punën e grupeve të tjera.			
Detyra: Punimi i faqes 16 në <i>Fletoren e punës</i>		Refleksion: Si u ndjetë gjatë kërkimit të materialeve dhe organizimit të tyre?	
Shënim: Në varësi të kohës prezantimi i posterave mund të vazhdojë në orët në vazhdim. Porositen nxënësit që për orën e ardhshme të sjellin me vete fara të ndryshme bimësh.			

Ora 5 dhe 6

Fusha: Shkencë	Lënda: Dituri natyre	Klasa 5	Data
Tema mësimore: Farat shpërndahen në mënyra të ndryshme Tema mësimore: Farat shpërndahen në mënyra të ndryshme		Situata e të nxënit: Si shpërndahen farat?	
Rezultatet e të nxënit sipas temës: <ul style="list-style-type: none">– vëzhgon mënyra të ndryshme të shpërndarjes së farave;– identifikon mënyrën e shpërndarjes së farave nisur nga pamja e jashtme e tyre;– diskuton gjetjet dhe i përdor për të shkruar përfundimet;– shpreh me gojë, me shkrim ose me vizatim, të dhënat që merr nga vëzhgimet dhe regjistrimet.			Fjalë kyçe: porozë, shpërthen
Burimet dhe mjetet: fotografi e luleradhiqes, material poroz dhe një enë e tejdukshme me ujë, bishtajë, fara të ndryshme bimësh			Lidhja me fushat e tjera: Gjuhët (Gjuhë shqipe), Arte, Shkencat (Kimi Biologji), Matematikë
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <p><i>Bisedë:</i> Nxënësve iu paraqitet një fotografi e luleradhiqes. Drejtohen pyetjet: A e keni parë këtë lule? Po emrin e saj e keni dëgjuar? A i keni fryrë ndonjëherë? Çfarë ka ndodhur me të? A e dini si shpërndahen farat e kësaj luleje? Pse?</p> <p>Njihën nxënësit me emërtimin e luleradhiqes dhe ftohen të shohin figurat në faqen 22 të librit. Para se të lexohet informacioni për secilën lule, ftohen nxënësit të shohin figurat dhe të parashikojnë mënyrat se si shpërndahen farat e luleve të paraqitura në to.</p> <p><i>Lexim i drejtuar:</i> Lexohet përshkrimi që jepet nën secilën figurë. Drejtohen pyetjet: A ju dolën parashikimet? Çfarë të veçante ka lulja llambadar? Si bëhet e mundur shpërndarja e farave në lulen llambadar? Çfarë të veçante ka lulëkuqja? Si bëhet e mundur shpërndarja e farave të saj? Çfarë të veçante ka lulja e pemës së panjës? Si bëhet e mundur shpërndarja e farave të saj? A keni dëgjuar të shpërndahen farat nëpërmjet ujit? Si mund të ndodhë kjo? Lexohet dhe diskutohet informacioni i dhënë për farën e arrës së kokosit. Shpjegohet fjala “porozë”. Për demonstrim, nxënësve iu paraqitet një material poroz, të cilin mundohemi ta fusim në ujë. Shpjegohet se është ajri ndërmjet poreve ai që nuk lejon të futet uji brenda dhe materiali të bjerë poshtë. Kështu ndodh dhe me mbështjelljen porozë të farës. Vazhdohet me leximin e materialit në libër dhe studimin e figurës së dhënë në të. Demonstrrohet hapja apo “shpërthimi” i një bishtaje. Sqarohen nxënësit se në mënyrë të ngjashme, bima e bishtajës e bën hapjen kur mbështjellja e jashtme thahet dhe farat flaken jashtë saj.</p> <p><i>Veprimtari:</i> Si shpërndahen farat? Nxënësit do të tregojnë për farat që kanë sjellë dhe do t'i emërtojnë ato. Duke i vëzhguar me lupë, ata do të përshkruajnë veçoritë e tyre. Bazuar në pamjen e tyre, nxënësit do të dallojnë cilës bimë i përket farat dhe do të supozojnë mënyrën se si ato shpërndahen.</p>			

Ditari trepjesësh: Udhëzohen nxënësit të punojnë në dyshe, si dhe hapat që do të ndjekin gjatë punës: Pasi t'i kenë treguar njëri-tjetrit farat e sjella, secili do t'i vëzhgojë me radhë dhe do të bëjë vizatimin e çdo fare në ditarin trepjesësh. Duke diskutuar së bashku, nxënësit përcaktojnë emërtimin e bimës së cilës i përket fara. Secili nga nxënësit e grupeve dyshe, bazuar në vëzhgimin e kryer dhe njohjen e bimës nga e cila vjen fara, përcaktojnë se si mund të jetë shpërndarë secila prej tyre.

Vizatimi dhe përshkrimi me fjalë i farës	Emërtimi i bimës	Si mund të jetë shpërndarë

Pas mbarimit të ditarit trepjesësh, grupet dyshe i prezantojnë tabelat dhe japin sugjerimet. Secila dyshe zgjedh të paraqesë nga dy fara para klasës.

Diskutim: Si mendoni ju, cila mënyrë shpërndarjeje i çon farat më larg nga bima mëmë? Ftohen nxënësit të japin mendimet dhe argumentimet e tyre.

Vlerësimi: Vlerësohen nxënësit për përfshirjen në veprimtaritë hulumtuese dhe për mendimet e dhëna gjatë arritjes në përfundime. Vlerësohen për aftësitë e treguara gjatë zhvillimit të veprimtarive në dyshe.

Detyra: Punimi i faqes 17 në <i>Fletoren e Punës</i>	Reflektim: Po me farat që nuk arrijnë të shpërndahen, çfarë ndodh?
---	--

Shënim: Nxënësit mund të shtojnë informacione të tjera në posterat e tyre në lidhje me shpërndarjen e farave.

Udhëzohen nxënësit që për orën në vazhdim, secili të sjellë nga një lule.

Ora 7

Fusha: Shkencë	Lënda: Dituri natyre	Klasa 5	Data
Tema mësimore: Pjesët e lules		Situata e të nxënës: Lulja	
Rezultatet e të nxënës sipas temës: Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> vëzhgon bimët me lule që kanë organe mashkullore dhe femërore; diskuton gjetjet dhe i përdor ato për të shkruar përfundimet; përcakton pjesët e lules dhe funksionet e saj; shpreh me gojë, me shkrim dhe me vizatim të dhënat që merr nga vëzhgimet. 			Fjalë kyçe: pistili, pjalmorja, theku, vezorja, pjesa femërore e lules, nënpetla, petla
Burimet dhe mjetet: lule, lupë, fotografi luleje, video të marra nga interneti ku tregohen pjesët e lules.			Lidhja me fushat e tjera: Gjuhët (Gjuhë shqipe), Shkencat (Kimi Biologji), Arte

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:

Tabela T: Tregohet para nxënësve një lule. Ftohen nxënësit të tregojnë çfarë ju vjen në mend për lulen. Gjatë tregimit të nxënësve në dërrasë plotësohet tabela T:

Çfarë di për lulet?	Pjesët e lules

Gjatë plotësimit të tabelës, nxënësve u tërheq vëmendjen klasifikimi me emërtimin e pjesëve të trupit të lules dhe sqarohen se kjo tabelë do të vazhdojë të plotësohet dhe në vazhdim të orës.

Diskutim: Ftohen nxënësit të studiojnë së bashku me mësuesi/en pjesët e trupit të lules. Gjatë gjithë kohës së diskutimit bëhet dhe demonstrimi. Në grupet dyshe nxënësit kanë nga një lule. Tërhiqet vëmendja e nxënësve në shikimin e lules së paraqitur dhe krahasimin me lulen që ata kanë.

Çfarë ngjyre ka lulja? Numëroni pjesët me ngjyra. Si quhen ato? Gjatë kohës që nxënësit emërtojnë pjesët me ngjyra të lules, një nxënës i tregon ato te lulja që ka në grupin e tij.

Pjesët e lules janë të ndara apo të lidhura me njëra-tjetrën? Gjeni pjesët që duken si gjethe të vogla dhe të gjelbra në bazën e lules. Sa janë? Njihen nxënësit me emërtimin e nënpetlave. Sqarohen nxënësit se, nëse shohin në brendësi të lules, do të dallojnë pjesën mashkullore dhe pjesën femërore të saj. Nxënësit udhëzohen të numërojnë fijet e holla në brendësi të lules. Sa prej tyre kanë në majë ngjyrë të verdhë ose kafe? Prekini me kujdes majat e tyre. Çfarë vini re në gishtat tuaj? Shpjegohet se pluhuri në gishtat e nxënësve quhet pjalm. Pjesa që ata prekën, quhet pjalmore. Fijet e holla të gjata janë thekët. Të gjitha këto përbëjnë pjesën mashkullore të lules.

Udhëzohen nxënësit të shohin në qendër të lules. Aty do të vënë re një fill të vetëm, që dallon nga të tjerët. Ai është pistili. Pistili është element i pjesës femërore të lules.

Ftohen nxënësit të tregojnë nëse arritën të gjithë t'i gjenin këto pjesë të lules te lulet e tyre, pavarësisht nga lloji i lules që kishin sjellë. Si janë të vendosura pjesët e ndryshme të lules? Sqarohen nxënësit se lulet kanë pjesët e tyre kryesore, të cilat janë të vendosura në formë rrethi njëra brenda tjetrës. Njëkohësisht, nxënësit i dallojnë ato në lulet që kanë me vete.

Lexim i drejtuar: Prezantohen pjesët e lules të paraqitura në figurën e faqes 24 të librit. Lexohen sqarimet që jepen për secilën pjesë të lules. Drejtohet pyetja: Cilat pjesë të lules nuk arritëm t'i shihnim me sy të lirë? Çfarë mund të thoni për to? Vezorja dhe karpeli (pjesa femërore e lules) së bashku me pistilin përbëjnë pjesën femërore të lules.

Veprimtari: Vëzhgojmë dhe vizatojmë pjesët e një luleje. Ftohen nxënësit të vizatojnë në fletore lulen që kanë sjellë dhe të emërtojnë pjesët e saj. Pasi i përfundojnë vizatimet, ia tregojnë ato njëri-tjetrit duke shpjeguar pjesët përbërëse të lules dhe funksionet e tyre.

Pyetje-përgjigje: Nxënësit dot u japin përgjigjen në fletore pyetjeve 1 dhe 2 të rubrikës "Pyetjedhedetyra". Më pas do të punohen me të gjithë klasën në formën e pyetje-përgjigjeve nga nxënësit me njëri-tjetrin. Vëzhgohet nga të gjithë figura e dhënë në faqen 25 të librit dhe lexohet përshkrimi në lidhje me lulen e paraqitur. Nxënësve u tërhiqet vëmendja për të gjetur fjalët kyçe, të cilat japin përcaktimin e veçantë për lulen me këto karakteristika: ka erë të pakëndshme, si mish i prishur. Duke pasur parasysh këto të dhëna, ata ftohen në diskutim: Si mendoni, cilat insekte tërhiqen më shumë nga lulet me ngjyrë të kuqërremtë në kafe dhe me erë mishi të prishur? Për ndihmë, nxënësit mund të orientohen: Cilat insekte shkojnë te mishi apo te mishi i prishur? Insekti i sugjeruar është miza.

Udhëzohen nxënësit që, në dyshet e krijuara më parë, të planifikojnë një hulumtim për të zbuluar cilat ngjyra të luleve ndeshen më shpesh në zonën ku jetojnë. Kjo do të jetë pjesë e detyrës së shtëpisë që do të zhvillohet nga dyshet e nxënësve gjatë javës. **Përforcim:** Duke parë figurën e lules (si ajo e faqes 24 të librit), rikujtohen së bashku katër pjesët kryesore të lules:

1. Nënpetlat, të cilat mbrojnë sythin e lules.
2. Petlat, të cilat me ngjyrat e tyre tërheqin insektet.
3. Pjesa mashkullore e lules me thekët, pjalmoret dhe pjalmmin.
4. Pjesa femërore e lules, vezorja dhe pistili.

Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për identifikimin e pjesëve të lules dhe të funksioneve të tyre.

Detyra: Punimi i faqes 18 të *Fletores së punës*
Rubrika “Pyetje dhe detyra” në faqen 25 të librit.

Refleksion: Përshkruaj pjesët e një luleje që të pëlqen më shumë.

Shënim: Në varësi të mundësive për demonstrim, mund të përdoret edhe material filmik i marrë nga interneti.

Ora 8

Fusha: Shkencë	Lënda: Dituri natyre	Klasa 5	Data
Tema mësimore: Pjalmimi		Situata e të nxënit: Përse pjalmohen lulet?	
Rezultatet e të nxënit sipas temës: Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">– vëzhgon riprodhimin te bimët;– vëzhgon mënyra të ndryshme të pjalmimit të luleve;– tregon me shembuj se insektet pjalmojnë disa lule;– përshkruan se bimët prodhojnë lule që kanë organe mashkullore dhe femërore;– përshkruan se si formohen farat kur pjalmi që prodhohet nga organi mashkullor (theku), pllenon vezën në organin femëror (pistil).		Fjalë kyçe: pjalmim, nektar, pllenim	
Burimet dhe mjetet: lupë, laps, letër, filmim i shkurtër mbi llojet e pjalmimit të luleve		Lidhja me fushat e tjera: Gjuhët (Gjuhë shqipe), Shkencat (Kimi Biologji), Arte	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Diskutim: Nxënësit tregojnë përfundimet e hulumtimeve që kanë bërë në lidhje me ngjyrën e luleve më të përhapura për zonën ku banojnë. U drejtohen këto pyetje: Si mendoni, përse këtyre luleve iu nevojiten ngjyrat? Përse shërben ngjyra e petlave të lules? Gjatë hulumtimit tuaj, a patë insekte të ndryshme në to? Tregoni cilat.			


Sqarohen nxënësit se fluturat, bletët dhe insektet të tjera që shkojnë te lulet, transportojnë pjalmim nga thekët te pistili i një luleje. Ky proces quhet pjalmim. Pjalmimi ndodh kur nga theku i një luleje, pjalmi kalon në pistilin e një luleje tjetër të të njëjtit lloj.

Ftohen nxënësit të shohin figurën në faqen 26 të librit. Çfarë shihni në të? Sqarohen nxënësit se në figurë është paraqitur njëra nga format e pjalmimit, ajo nëpërmjet insekteve, forma tjetër është nëpërmjet erës.

Lexim rishikim në dyshe: Të ndarë në grupe dyshe, nxënësit do të lexojnë dhe diskutojnë pjesët e dhëna në libër “Pjalmimi nga insektet.” dhe “Pjalmimi nga era”. Diskutohet informacioni i të dyja pjesëve me të gjithë klasën. Te cilat lule shkojnë insektet? Pse? Çfarë përfitojnë insektet duke shkuar tek lulet? Çfarë përfitojnë lulet nga “vizita” e insekteve tek ato? Si ndodh pjalmimi nga insektet? Cili është ndryshimi ndërmjet luleve që pjalmohen nga insektet dhe luleve që pjalmohen nga era? Si ndodh pjalmimi nga era?

Veprimtari: Shfaqet filmimi mbi pjalmimin e luleve. Udhëzohen nxënësit që gjatë shikimit të filmit të mbajnë shënime mbi llojet e luleve që shohin dhe llojet e insekteve që shkojnë te lulet. A shkojnë insektet tek e njëjta lloj luleje? Diskutohet së bashku për llojet e luleve dhe mënyrat se si pjalmohen ato.

Shpjegohet se farat e luleve formohen si rezultat i bashkimit të pjalmimit me vezën. Ky proces quhet pllenim. Pllenimi ndodh në vezoren e lules dhe realizohet vetëm nëse pjalmi dhe vezët i përkasin të njëjtit lloj luleje. Pas pllenimit të vezës, petlat dhe thekët e lules vdesin. Vezorja rritet dhe bëhet fryt. Brenda frytit gjenden farat. Shpjegimi shoqërohet me tregimin e figurave si ato të faqes 27 të librit, si dhe me gjithë procesin e paraqitur në skemën e ndërtuar në dërrasë.



Punë e pavarur: Nxënësit punojnë individualisht në fletore përgjigjet e pyetjeve të dhëna tek “Pyetje dhe detyra”. Udhëzohen që në rast vështirësie, të kërkojnë informacione në mësimin përkatës apo dhe në shënimet në dërrasë.

Pyetje përgjigje: Kryhet përforcimi i njohurive nëpërmjet drejtimit të pyetjeve të dhëna në libër dhe nxënësit përgjigjen, diskutojnë, plotësojnë e argumentojnë rreth përgjigjeve të dhëna.

Vlerësimi: Vlerësohen nxënësit për mendime e dhëna gjatë punës individuale dhe argumentimit të mendimeve të tyre.

Detyra: Punimi i fq. 19 të Fletore Pune

Refleksion: Përse insektet i shohin lulet e bardha si lule në ngjyrë vjollcë?

Shënim: Kjo orë mësimi mund të zhvillohet pjesërisht në natyrë. Në këtë mënyrë, nxënësit do të mund të vëzhgojnë llojet e pjalmimit të luleve në zonën ku jetojnë.

Ora 9

Fusha: Shkencë	Lënda: Dituri natyre	Klasa 5	Data
Tema mësimore: Hulumtimi i pjalmimit		Situata e të nxënit: Pjalmimi nga insektet	
Rezultatet e të nxënit sipas temës: Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> – hulumton pjalmimin e luleve nga insektet; – vëzhgon mënyra të ndryshme të pjalmimit të luleve; – diskuton gjetjet dhe i përdor për të shkruar në përfundime; – shpreh me gojë, me shkrim dhe me vizatim të dhënat që merr nga vëzhgimet. 			Fjalë kyçe: pjalmim
Burimet dhe mjetet: bimë me lule, orë, fletore, laps			Lidhja me fushat e tjera: Gjuhët (Gjuhë shqipe), Matematikë, Art, Edukim fizik

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:

Kornizë paragrafi me skelëzim: Nxënësit diskutojnë në dyshe plotësimin e paragrafit me skelëzim të kryer si detyrë shtëpie. Lexohet paragrafi i plotësuar dhe nxënësit bëjnë vetëvlerësimin e detyrës. Iu prezantohen nxënësve fotografite të paraqitura në faqen 28 të librit. Ftohen nxënësit të tregojnë rreth luleve dhe insekteve të paraqitura në figurë. Theksohet se lulet pjalmohen nga insekte të ndryshme. Njihen me veprimtarinë që do të kryejnë në oborrin ose në parkun/kopshtin pranë shkollës.

Hulumtim: Ky hulumtim ka për qëllim vëzhgimin e llojeve të luleve dhe llojeve të insekteve që shkojnë tek këto lule për një interval kohe të caktuar. Të dhënat e hulumtimit do të shkruhen në tabelën e vizatuar në fletore:

Emri i lules	Përshkrimi i lules	Parashikimi si do të pjalmohet lulja	Insektet që shkojnë te lulja	Numri i herëve që insektet shkojnë te lulja

Udhëzohen nxënësit se në vendin ku kërkohet përshkrimi i lules, ata edhe mund të bëjnë vizatimin e saj. Parashikimi do të plotësohet para se të fillojë vëzhgimi. Sqarohen se koha gjatë së cilës do të vëzhgohen lulet do të jetë 30 minuta.

Përfundime: Pas kohës së vëzhgimit, duke u bazuar në të dhënat që mblodhën, nxënësit do të dalin në përfundime në bazë të pyetjeve që do t'u drejtohen: Te cilat lule shkuan më shpesh insektet? Pse? Cilat insekte shkuan më shpesh te lulet? A ishin të sakta parashikimet tuaja në lidhje me pjalmimin? Çfarë rregullsie vutë re tek lulet ku shkuan insektet? Sugjeroni një arsye për këtë rregullsi.

Punohet rubrika “Mësuam se” dhe më pas diskutohet se përse lulet e kuqe, të paraqitura në libër, pjalmonen më shumë nga zogjtë? Iu sugjerohet nxënësve të analizojnë informacionin e dhënë dhe formën e luleve të paraqitura në figurë. Për vetë formën që kanë këto lule, nektarin e kanë të vendosur thellë dhe sasia e tij është e madhe. Zogjtë që i pjalmojnë këto lloje lulesh kanë sqep të gjatë, gjë që ju mundëson atyre të marrin nektar deri në thellësi Gjithashtu, sasia e nektarit me të cilin ushqehen është i madh, ashtu si dhe kjo lule është e pasur me nektar.

Nxënësit ftohen të japin mendime dhe argumente për llojet e luleve që pjalmonen nga lakuriqët e natës.

Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për përfshirjen në hulumtim, saktësinë dhe korrektësinë në mbledhjen e të dhënave gjatë hulumtimit, si dhe për përfundimet e formuluarat e të mbështetura me prova nga të dhënat e mbledhura.

Detyra: Punimi i faqes 20 në *Fletoren e punës*

Refleksion: Si u ndjetë gjatë hulumtimit në natyrë?

Shënim: Për arsye kohe, kjo orë mësimore mund të bashkohet dhe me një orë kurrikul me zgjedhje.

Ora 10

Fusha: Shkencë	Lënda: Dituri natyre	Klasa 5	Data
Tema mësimore: Cikli jetësor i bimës		Situata e të nxënit: Ndryshimet në jetën e një bime	
Rezultatet e të nxënit sipas temës: Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> – zbulon se çdo organizëm i gjallë ka një cikël jetësor; – tregon nëpërmjet ciklit jetësor se çdo organizëm i gjallë rritet dhe riprodhohet; – përshkruan ndryshimet në ciklin jetësor të një bime; – tregon se bimët me lule kanë një cikël jetësor që përfshin pllenimin, formimin e farës, shpërndarjen e farës dhe mbirjen; – shpreh me gojë, me shkrim ose me vizatim, të dhënat që merr nga vëzhgimet; – tregon kuriozitet kur heton ciklin jetësor të bimët. 			Fjalë kyçe: cikël jetësor
Burimet dhe mjetet: fletore, lapsa, gomë			Lidhja me fushat e tjera: Gjuhët (Gjuhë Shqipe), Shkencat (Kimi Biologji) Matematikë, Art
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Diskutim: U jepet kohë nxënësve në dyshe të diskutojnë rubrikat nga 1 deri në 4, që kanë punuar në faqen 20 të <i>Fletores së punës</i> . Diskutohet së bashku rubrika 5. Nxënësit argumentojnë pse pjalnimi është i rëndësishëm për bimët.			

Shpjegim i përparuar: Njihen nxënësit me figurën e ngjashme me atë të faqes 30 të librit. Ata nxiten të kujtojnë të gjitha ndryshimet që ndodhin në jetën e një bime, nga mbirja e farës deri te bima e rritur dhe formimi i farave të reja. Njihen me emërtimin “Cikli jetësor i bimës”. Sqarohen se disa bimë, pasi prodhojnë farat e tyre, thahen dhe vdesin. Këto quhen bimë njëvjeçare. Disa bimë çelin lule dhe prodhojnë fara çdo vit. Këto janë bimët shumëvjeçare. Së bashku analizohen ndryshimet në jetën e një bime, bazuar në ciklin jetësor të saj të paraqitur në figurë. Lihen nxënësit për pak minuta ta vëzhgojnë në heshtje dhe më pas ftohen të ndërtojnë pyetje rreth tij.

Pyetje-përgjigje: Nxiten nxënës të ndryshëm t’i drejtojnë pyetje njëri-tjetrit rreth fazave të ciklit jetësor. Gjatë pyetje-përgjigjeve ritheksohet radha e zhvillimit të proceseve të ndryshme në jetën e një bime.

Punim/rishikim në dyshe: Nxënësit punojnë të pavarur ushtrimet e rubrikës “Pyetje dhe detyra”. Rishikojnë përgjigjet e dhëna për secilin ushtrim.

Përfaqësues të secilit grup japin përgjigje për ushtrimet gjatë radhës së diskutimit me të gjithë klasën. Lexohet rubrika “Diskutojmë” dhe jepen mendime rreth pyetjes së saj.

Përfundime: Nxënësit do të vizatojnë ciklin jetësor të një bime, duke emërtuar dhe sqaruar fazat e jetës në të cilat kalon bima. Paraqiten vizatimet e nxënësve.

Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen individualisht për ndërtimin e pyetjeve dhe për mendimet e dhëna gjatë argumentimeve.

Detyra: Punimi i faqes 20 në *Fletoren e punës*

Refleksion: Çfarë ndjesie jep njohja e ciklit të jetës së bimëve?

Shënim:

Ora 11

Fusha: Shkencë	Lënda: Dituri natyre	Klasa 5	Data
Tema mësimore: Kontrolloni përparimin tuaj		Situata e të nxënit: Unë di	
Rezultatet e të nxënit sipas temës: Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">– zbulon se çdo organizëm i gjallë ka një cikël jetësor;– përshkruan ndryshimet në ciklin jetësor të një bime;– vëzhgon riprodhimin te bimët;– përshkruan se bimët prodhojnë lule që kanë organe mashkullore dhe femërore;– tregon se farat formohen kur pjalmi që prodhohet nga organi mashkullor (theku), pllenon vezën në organin femëror (pistil);– përcakton mënyra të ndryshme të shpërndarjes së farave;– tregon me shembuj se insektet pjalmojnë disa lule;– tregon se bimët me lule kanë një cikël jetësor, i cili përfshin pllenimin, formimin e farës, shpërndarjen e farës dhe mbirjen;– shpreh me gojë, me shkrim ose me vizatim, të dhënat që merr nga vëzhgimet dhe regjistrimet.		Fjalë kyçe: shpërndarja e farave, pjalmim, pllenim, pjesa femërore, pjesa mashkullore, bimë, lule, cikli jetësor	
Burimet dhe mjetet: enciklopedi, projekti		Lidhja me fushat e tjera: Gjuhët (Gjuhë shqipe), Matematikë, Arte	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Shkrim i lirë:</i> Duke përdorur radhën e vendosur nga ju në figurat e ushtrimit 2 të faqes 21 të <i>Fletores së punës</i> , për 5 minuta përshkruani ciklin jetësor të kungullit. Nëse dëshironi dhe jeni brenda kohës, mund ta vizatoni. Disa prej nxënësve mund të lexojnë shkrimet e tyre. <i>Punë e pavarur:</i> Plotësimi i rubrikave të dhëna në faqet 32 dhe 33 në libër. Krahësim dhe diskutim në dyshe të plotësimeve që kanë bërë. Përfaqësues të grupeve dyshe prezantojnë përfundimet për secilën rubrikë. <i>Reflektime:</i> Nxënësit me forma të ndryshme, shkrime, vizatime, punime në dyshe prezantojnë ndjesitë mbi këtë grup temash.			
Vlerësimi: Vlerësimi individual në punimin e rubrikave të librit, argumentimin e mendimeve dhe qëndrimeve që mbajnë.			
Detyra: Punimi i faqes 22 të Fletore Pune		Refleksion: Si u ndjeve gjatë rikujtimit dhe diskutimit të këtyre temave?	
Shënim:			

Ora 12

Fusha: Shkencë	Lënda: Dituri natyre	Klasa 5	Data
Tema mësimore: Detyrë përmbledhëse /Test		Situata e të nxënit: Unë di	
Rezultatet e të nxënit sipas temës: Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">– përshkruan kushtet që iu duhen bimëve për të jetuar;– argumenton nevojën që kanë farat për ujë dhe ngrohtësi për të mbirë, por jo për dritë;– provon se bimët kanë nevojë për energjinë e dritës së diellit për t’u rritur;– zbulon se çdo organizëm i gjallë ka një cikël jetësor;– përshkruan ndryshimet që ndodhin gjatë ciklit jetësor të një bime;– përshkruan se bimët prodhojnë lule, të cilat kanë pjesë mashkullore dhe pjesë femërore;– përcakton mënyra të ndryshme të shpërndarjes së farave; tregon me shembuj se insektet pjalmojnë disa lule;– tregon se farat formohen kur pjalmi që prodhohet nga pjesa mashkullore, pllenon vezën.		Fjalë kyçe: fara, pjalmim, pllenim, pjesa femërore, pjesa mashkullore, bimë, lule, cikli jetësor	
Burime dhe mjete: enciklopedi, fleta e detyrës përmbledhëse, lapsa, ngjyra		Lidhja me fushat e tjera: Gjuhët (Gjuhë shqipe), Shkencat (Kimi Biologji) Art	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Nxënësit prezantojnë përfundimet e tyre të punuara në detyrat e shtëpisë. <i>Punë e pavarur:</i> Plotësimi i detyrave përmbledhëse <i>Dy të vërteta, një gënjeshtër:</i> Nxënësit shkruajnë në fletore dy gjëra të vërteta/ të sakta dhe një gënjeshtër/të gabuar (nga mësimet e trajtuara). Shoku ose shoqja e bankës do të gjejë të vërtetat/ të saktat dhe gënjeshtren/ gabimin. Më pas, nxënësit këmbëjnë rolet me njëri-tjetrin.			
Vlerësimi: Vlerësohen për punimin e detyrës përmbledhëse /testit.			
Detyra:		Refleksion:	
Shënim: Kjo orë mund të shfrytëzohet si testim ose si detyrë përmbledhëse e periudhës së parë. Ora e mësimit mund të fillojë me zhvillimin e testit /detyrës përmbledhëse e më pas me prezantimet dhe lojën.			

Kapitulli 3

Cikli jetësor i kafshëve

Ora 1 dhe 2

Fusha: Shkencë	Lënda: Dituri natyre	Klasa 5	Data
Tema mësimore: Nevojat jetësore të kafshëve Tema mësimore: Nevojat jetësore të kafshëve		Situata e të nxënit: Nevojat e kafshëve	
Rezultatet e të nxënit sipas temës: Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> – përshkruan kushtet që iu duhen kafshëve për të jetuar; – vlerëson proceset jetësore të kafshëve; – shpreh me gojë dhe me shkrim të dhënat që merr nga vëzhgimet dhe regjistrimet; – shfaq kureshtje kur heton faktorët që ndikojnë në mbijetesën e kafshëve. 			Fjalë kyçe: ushqim, oksigjen, ujë
Burimet dhe mjetet: letër, laps, foto kafshësh në habitatin e tyre			Lidhja me fushat e tjera: Gjuhët (Gjuhë shqipe), Shkencat (Kimi Biologji), Arte
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Brainstorming:</i> U paraqitet nxënësve fotografia si në faqen 34 të librit. Ftohen të tregojnë çfarë u sjell në mendje kjo pamje dhe ç'mund t'thonë për të. Nxiten nxënësit të tregojnë kafshët që paraqiten në figurë, kushtet e habitatit në të cilin jetojnë. <i>Harta semantike:</i> Përse kanë nevojë kafshët që të jetojnë? Plotësohet në dërrasë “Harta semantike me përgjigjet e nxënësve”; theksohen elementet: ujë, ushqim, ajër/oksigjen. Shtohet në vazhdimësi për secilin element harta me pyetjen: Si e sigurojnë atë? Nxiten nxënësit të tregojnë gjithçka dinë rreth mënyrës se si i sigurojnë kafshët nevojat jetësore. <i>Lexim rishikim në dyshe:</i> Nxënësit do të lexojnë fragmentet në materialin e dhënë në faqet 34 dhe 35 të librit. Më pas diskutohet së bashku. Drejtohen pyetjet: Çfarë mund të thoni rreth sigurimit të ushqimit nga kafshët? Si klasifikohen ato dhe pse? Çfarë i ndihmon kafshët të sigurojnë ushqimin e tyre? A marrin frymë kafshët në det? Si ndodh? Çfarë mund të thoni për proceset jetësore të kafshëve? Përse janë të rëndësishme ato? <i>Veprimtari:</i> Gjatë veprimtarisë nxënësit do të vëzhgojnë kafshë të ndryshme dhe do të mbajnë shënime të orientuar në këto drejtime:			
Emrat e kafshëve	Me se ushqehen?	Si lëvizin?	Ngjashmëri me kafshë të tjera
Pas vëzhgimit, krahasohen të dhënat e mara. Tregohen ngjashmëritë dhe dallimet ndërmjet kafshëve të ndryshme. <i>Diskutim:</i> Mendoni për proceset jetësore të kafshëve. A ekziston dallim ndërmjet kafshëve të ndryshme dhe proceseve të tyre jetësore? Pse mendoni kështu? A iu nevojiten kafshëve të egra dhe atyre shtëpiake të njëjtat kushte për të jetuar? Plotësojnë individualisht në fletore përgjigjet e pyetjeve të rubrikës “Pyetje dhe detyra”.			

Vlerësimi: Vlerësohen për mendimet dhe gjetjet gjatë veprimtarisë së vëzhgimit dhe interpretimit të gjetjeve.

Detyra: Punimi i faqes 23 të *Fletore punës*

Refleksion: Nga kafshët që njih, cila të duket më interesantja? Pse?

Shënim: Këto orë mësimore mund të zhvillohen gjatë një vizite në një fermë ose kopsht zoologjik

Në mungesë të ekskursionit mësimor, nxënësit mund të shohin një dokumentar për kafshët dhe nevojat e tyre për të jetuar

Ora 3

Fusha: Shkencë	Lënda: Dituri natyre	Klasa 5	Data
Tema mësimore: Riprodhimi te kafshët		Situata e të nxënit: Si lind zogu?	
Rezultatet e të nxënit sipas temës: Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">tregon me shembuj se çdo organizëm i gjallë rritet dhe riprodhohet;vlerëson proceset jetësore të kafshëve;njih riprodhimin si një nga proceset jetësore të kafshëve.		Fjalë kyçe: vezë, embrion, fekondohet, riprodhohet	
Burimet dhe mjetet: një vezë, laps, letër		Lidhja me fushat e tjera: Gjuhët (Gjuhë shqipe), Arte	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <p><i>Prezantim</i> i mendimeve që nxënësit u kanë dhënë Jonës dhe Besit në lidhje me kujdesin ndaj kafshëve.</p> <p>Drejtohet pyetja: A kanë lidhje nevojat që keni përcaktuar, me proceset jetësore të kafshëve?</p> <p><i>Brainstorming:</i> Paraqitet para nxënësve një vezë pule. Ftohen nxënësit të tregojnë se çfarë u vjen në mendje në lidhje me të.</p> <p>Prezantohet situata e fëmijëve në faqen 36 të librit. Nxënësit lexojnë në role fjalët e fëmijëve.</p> <p>Drejtohet pyetja: Si mendoni ju, a kanë të drejtë fëmijët? Pse?</p> <p><i>Lexim i drejtuar:</i> Studiohet skema e dhënë në libër dhe lexohen shpjegimet në lidhje me zhvillimin e jetës së zogut në vezë. Gjatë leximit theksohet kuptimi i fjalëve: embrion, fekondim, vezë e fekonduar. Diskutohet rreth pyetjeve: Nga të gjitha vezët mund të dalin zogj? Çfarë duhet të ndodhë me vezën që të mund të fillojë zhvillimi i embrionit në të? Bazuar në figurat e dhëna, pas sa ditësh dallohet pamja e zogut brënda në vezë? Pas sa ditësh del zogu nga veza? Cilët janë prindërit e zogut të vogël?</p> <p>Sqarohen nxënësit se nëse pula bën vezë dhe i ngroh për të dalë zogu, tek macja embrioni i maces zhvillohet brenda barkut të maces. Brenda në barkun e nënës macja e vogël siguron ushqim dhe oksigjen.</p>			

Lojë: Nxënësit do të dallojnë kafshët dhe të vegjlit e tyre. Nëpërmjet figurave të dhëna në fq 37 të Librit nxënësit do ta kryejnë lojën në dyshe. Me radhë, duke u këmbyer me njëri-tjetrin, kur njëri thotë emrin e kafshës, tjetri bën lidhjen duke treguar të voglin e saj. Nxënësit mund të thonë dhe emra kafshësh të tjerë. Iu sugjerohet nxënësve të tregojnë dhe nëse këto kafshë bëjnë vezë apo lindin të vegjël. Nëse kanë vështirësi në rastin e bretkosës, sqarohen se bretkosa bën vezë.

Punohet së bashku rubrika “Pyetje përgjigje” Dilet në përfundimet e përbashkëta se disa kafshë bëjnë vezë dhe disa kafshë lindin të vegjël. Në rastin e lindjes së të vegjëlve veza ndodhet në barkun e nënës dhe aty zhvillohet embrioni për t’u rritur kafsha e vogël e cila lind. Lexohet me radhë nga një nxënës çdo fjali e rubrikës “Mësuam se”. Pas leximit nxiten nxënësit të japin shembuj/raste të kafshëve të cilat i përkasin rastit që trajtohet në fjali.

Diskutim: A merr frymë kotelja në barkun e nënës së saj? U rikujtohet nxënësve sqarimi se kotelja në bark siguron lëndën ushqimore dhe oksigjenin.

Vlerësimi: Vlerësohen për mendimet dhe gjetjet gjatë veprimtarisë dhe diskutimeve.

Detyra: Punimi i faqes 24 të *Fletores së punës*

Shënim:

Ora 4

Fusha: Shkencë	Lënda: Dituri natyre	Klasa 5	Data
Tema mësimore: Ciklet jetësore të shpendëve dhe të gjitarëve		Situata e të nxënit: Cikli jetësor	
Rezultatet e të nxënit sipas temës: Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">– zbulon se çdo organizëm i gjallë ka një cikël jetësor;– tregon se çdo organizëm i gjallë rritet dhe riprodhohet;– përshkruan ndryshimet në ciklin jetësor të një gjitari dhe të një shpendi;– tregon kuriozitet kur heton ciklin jetësor të bimëve dhe të kafshëve.		Fjalë kyçe: cikël jetësor, vezë, të vegjël, zog, i rritur	
Burimet e mjete: skema me ciklin jetësor të bimëve, të shpendëve, të gjitarëve		Lidhja me fushat e tjera: Gjuhët (Gjuhë Shqipe), Shkencat (Kimi Biologji), Arte	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Diskutim:</i> Ftohen nxënësit të japin mendime rreth pyetjes së detyrës së shtëpisë: Çfarë do të ndodhte nëse kafshët nuk do të riprodhoheshin? Pasi nxënës me dëshirë japin mendimet e tyre, rikujtohet se riprodhimi është një nga proceset jetësore të gjallesave. Ai është pjesë e ciklit jetësor. <i>Brainstorming:</i> Çfarë mund të thoni për “Ciklin jetësor”? A e keni dëgjuar më parë atë? Në çfarë rasti? Çfarë kuptoni me “Cikël jetësor”? Si mendoni ju, a kanë cikël jetësor kafshët? Pse mendoni kështu?			

Shpjegim i përparuar: Nxënësve u paraqitet me skemë cikli jetësor i një shpendi (p.sh.: pata), si në faqen 38 të librit. Ata ftohen të dallojnë në këtë skemë fazat e ciklit jetësor. Tërhiqet vëmendja në faktin se në ciklin jetësor përfshihen të gjitha fazat nëpër të cilat kalon kafsha gjatë jetës së saj, deri në çastin kur vdes.

Prezantohet cikli i jetës së lopës si në q 38 të Librit. Nxiten nxënësit të tregojnë fazat në këtë cikël jetësor. Ndryshimet dhe ngjashmëritë që vënë re krahasuar me ciklin jetësor të rosës.

Më pas ftohen nxënësit të studiojnë ciklin jetësor të njeriut. Sqarohet se ashtu si të gjitha kafshët që i ushqejnë të vegjlit e tyre me qumësht dhe njeriu bën pjesë në grupin e gjitarëve. Tërhiqet vëmendja në ndjekjen e shigjetave në skemën e dhënë në libër. Çfarë përshtypje të japin shigjetat që krijojnë rrethin? Po shigjeta që del në vazhdimësi jashtë rrethit? Gjatë ciklit jetësor, njeriu kalon nëpër të gjitha fazat e jetës, duke filluar nga lindja, fëmijëria, rritja, riprodhimi për të siguruar vazhdimësinë e jetës së species për të rilindur pasardhës dhe më pas faza e jetës së moshuar.

Ftohen nxënësit të krahasojnë ciklet jetësore të bimëve me kafshëve. Çfarë vini re? Çfarë komenti mund të bëni lidhur me to? Sqarohet se ashtu si tek bima dhe tek kafshët cikli fillon me mbirjen e farës/ lindjen dhe mbaron me tharjen e bimës/ vdekjen. Çfarë mund të thoni për fazat e jetës të përfshira në to?

Veprimtari: Ftohen nxënësit të emërtojnë fazat e ciklit të jetës së maces dhe të pëllumbit. Pasi e plotësojnë individualisht ata diskutojnë në dyshe e më pas me gjithë klasën: Cilat janë fazat e cikleve jetësore që përcaktuat në të dy kafshët? A ju tërhoqi vëmendjen diçka? Patët vështirësi në përcaktimin e fazave? Vini re me kujdes: A ngjan kotelja me macen e rritur? Ku ndryshojnë ato? Po zogu i vogël me dallëndyshen e rritur?

Diskutim: Si mendoni, a është i njëjtë cikli jetësor i një zogu shtegtar me atë të një zogu joshtegtar? Pse?

Përmbledhje: Punohen së bashku pohimet e dhëna në rubrikën “Mësuam se”.

Vlerësimi: Vlerësohen nxënësit për mendime e dhëna gjatë diskutimeve.

Detyra: Punimi i faqes 25 në *Fletoren e punës*

Shënim:

Ora 5

Fusha: Shkencë	Lënda: Dituri natyre	Klasa 5	Data
Tema mësimore: Ciklet jetësore të insekteve dhe amfibëve		Situata e të nxënit: Ciklet jetësore	
Rezultatet e të nxënit sipas temës: Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> – tregon se çdo organizëm i gjallë rritet dhe riprodhohet; – zbulon se çdo organizëm i gjallë ka një cikël jetësor; – përshkruan ndryshimet midis ciklit jetësor të një amfibi dhe atij të një insekti; – tregon kuriozitet kur heton ciklin jetësor të bimëve dhe të kafshëve. 		Fjalë kyçe: larvë, pupë, plotësisht e zhvilluar	

Burimet dhe mjetet: skema me ciklin jetësor të bimëve, të shpendëve, të gjitarëve	Lidhja me fushat e tjera: Gjuhët (Gjuhë shqipe), Arte, Shkencat (Kimi Biologji)
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</p> <p><i>Diskutim në dyshe:</i> Nxënësit i prezantojnë njëri-tjetrit ciklet jetësore që kanë ndërtuar në faqen 25 të <i>Fletores së punës</i>. Më pas, me dëshirë, ngrihet nga një përfaqësues i disa grupeve dyshe dhe vizaton në dërrasë një nga ciklet jetësore të punuara më parë në shtëpi.</p> <p><i>Shpjegim i përparuar:</i> Rikujtohet se disa kafshë dalin nga veza dhe disa lindin nga nënë e tyre. Shpjegohet se ka kafshë që kur dalin nga veza nuk ngjasojnë me prindërit e tyre. Këto kafshë gjatë ciklit të jetës së tyre pësojnë ndryshime të vazhdueshme. Të tilla janë fluturat dhe bretkosat. Nxënësve iu prezantohet skema e ciklit jetësor të fluturës. Lihen nxënësit ta studiojnë vetë për pak minuta. Shpjegohet se flutura është insekt. Ajo riprodhohet duke bërë vezë. Orientohen nxënësit që gjatë shpjegimit të shohin figurat në ciklin jetësor të paraqitur në tabelë. Më tej nga vezët dalin larvat, të cilat ushqehen me gjethe. Zakonisht fluturat zgjedhin ti lënë vezët në bimë me gjethe të trasha dhe të buta në mënyrë që kur të dalin larvat të kenë ushqim të bollshëm. Pasi rritet larva varet me kokë poshtë dhe formon rreth vetes një mbështjellëse të fortë të quajtur pupë. Pas afërsisht 2 javësh nga pupa del flutura. Pra larva është zhvilluar plotësisht dhe është shndërruar në flutur. Flutura e rritur vazhdon jetën për t'u riprodhuar përsëri nëpërmjet bërjes së vezëve.</p> <p><i>Bisedë:</i> Ftohen nxënësit të rikujtojnë nëse kanë parë flutura në fazat e ndryshme të jetës, p.sh.: larvën apo pupën ku ka qenë e futur larva.</p> <p><i>Shpjegim i përparuar:</i> Ftohen nxënësit të shohin ciklin e jetës së bretkosës. Njihen nxënësit me faktin se bretkosa bën pjesë në klasën e amfibëve. Amfibët jetojnë dhe në ujë dhe në tokë. Drejtohet pyetja: Si mendoni, ku fillon cikli i jetës së bretkosës në skemën tonë? Shpjegohet se bretkosa i lëshon vezët në ujë. Brenda në vezë rriten embrionet. Më pas, nga vezët dalin larvat të cilat notojnë në ujë. Gradualisht larvat rriten dhe pas dy muajsh formohen këmbët e pasme. Pas muajit të tretë dalin dhe këmbët e përparme dhe zhvillohen mushkëritë. Me daljen e këmbëve, zhvillimin e mushkërive, larva e rritur po përgatitet për të dalë nga uji. Më pas formohet bretkosa e re e cila nëpërmjet mushkërive mund të marrë frymë jashtë nga uji. Gjatë kësaj kohe zhduket bishti dhe bretkosa është rritur.</p> <p><i>Punë e pavarur:</i> Nxënësit do të vizatojnë skemat e cikleve jetësore të fluturës dhe të bretkosës. Udhëzohen të shkruajnë emërtimin e fazave të cikleve jetësore.</p> <p><i>Diskutim:</i> Të vegjlit e bretkosës ose të fluturës quhen larva, ndërsa ata të lepurit dhe të qenit quhen këlyshë. Identifikoni dallimet ndërmjet tyre. Si mendoni, a ka ndonjë ngjashmëri ndërmjet një larve dhe të voglit të një kafshe?</p> <p><i>Përmbledhje:</i> Punohen së bashku pohimet e dhëna në rubrikën “Mësuam se”.</p>	
Vlerësimi: Vlerësohen nxënësit për mendime e dhëna gjatë diskutimeve.	
<p>Detyra: Punimi i faqes 26 në <i>Fletoren e punës</i></p> <p>Nxënësit mund të mbledhin informacione në enciklopedi të ndryshme mbi ciklet jetësore të kafshëve të tjera.</p>	
<p>Shënim: Vizatimet e cikle jetësore nxënësit me dëshirë mund të ekspozojnë në muret e klasës. Ftohen dhe nxënësit e tjerë që gjatë ditëve të javës të plotësojnë dhe vendosin edhe ata punimet e tyre qoftë dhe me informacionet plus që kanë marrë.</p>	

Ora 6

Fusha: Shkencë	Lënda: Dituri natyre	Klasa 5	Data
Tema mësimore: Kontrolloni përparimin tuaj		Situata e të nxënit: Unë di	
Rezultatet e të nxënit sipas temës: Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">– përshkruan kushtet që iu duhen kafshëve për të jetuar;– tregon me shembuj se çdo organizëm i gjallë rritet dhe riprodhohet;– zbulon se çdo organizëm i gjallë ka një cikël jetësor;– përshkruan ndryshimet në ciklin jetësor të një gjitari, amfibi, insekti dhe shpendi.– shpreh me gojë, me shkrim ose me vizatim të dhënat që merr nga vëzhgimet.		Fjalë kyçe: nevoja për të jetuar, riprodhim, fazat e ciklit jetësor	
Burimet dhe mjetet: Vizatimet e nxënësve të punuara gjatë ditëve më parë.		Lidhja me fushat e tjera: Gjuhët (Gjuhë shqipe), Shkencat (Kimi Biologji), Matematikë, Arte	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Turi i galerisë:</i> Ftohen nxënësit me radhë të organizuar në dy grupe të zhvillojnë “Turin e galerisë“ Në pjesën e parë të orës mësimore një grup nxënësish do të vizitojë punimet e shokëve dhe grupi tjetër do të prezantojë punimet e veta. <i>Punë e pavarur:</i> Plotësim i rubrikave të dhëna në fq. 42-43 në libër. Krahasim dhe diskutim në dyshe të plotësimeve të tyre. Përfaqësues të dysheve prezantojnë përfundimet për secilën rubrikë. <i>Turi i galerisë:</i> Ftohen nxënësit të këmbehen dhe të vazhdojnë me prezantimin e punimeve.			
Vlerësimi: Vlerësimi individual në punimin e rubrikave të librit, argumentimin e mendimeve dhe qëndrimeve që mbajnë.			
Detyra: Punimi i faqes 27 të Fletores së punës		Refleksion: Trego si u ndjeve gjatë rikujtimit dhe diskutimit të këtyre temave.	
Shënim:			

Kapitulli 4

Gjendjet e lëndës

Ora 1

Fusha: Shkencë	Lënda: Dituri natyre	Klasa 5	Data
Tema mësimore: Avullimi		Situata e të nxënit: Ku shkon uji?	
Rezultatet e të nxënit sipas temës: Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> – vëzhgon procesin e avullimit; – përshkruan kthimin e lëngut në gaz; – heton faktorët që ndikojnë në procesin e avullimit; – është i/e përgjegjshëm/e për rëndësinë e përdorimit të teknikave dhe njësive të sakta në matje. 			Fjalë kyçe: avull uji, avullim, energji
Burimet dhe mjetet: një gotë, ujë, fletë punëdoreje, dy gota të njëjta, ujë, shënjues, enë e shkallëzuar			Lidhja me fushat e tjera: Gjuhët (Gjuhë shqipe), Matematikë, Arte
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Pyetje përgjigje:</i> Pse kur pushon shiu disa pellgje thahen? Pse rrobat e lagura thahen? Ku shkon uji? Nxiten nxënësit të japin mendimet e tyre dhe ti argumentojnë ato duke treguar se përse mendojnë kështu. <i>Lexim rishikim në dyshe:</i> Ftohen nxënësit të lexojnë paragrafin për avullimin në faqen 44 të librit. Diskutohet më pas me gjithë klasën: Kur ndodh kthimi i ujit në avull uji? Pse ndodh avullimi i lëngjeve? A është avulli gaz? Rikujtojmë me anë të vizatimit në dërrasë se si janë të vendosura grimcat e ujit kur ai është në gjendje të lëngët. Po në rastin e avujve të ujit si do t'i vizatojmë grimcat më të ngjeshura apo më të larguara? Sqarohet se grimcat e lëngut marrin energji nga nxehtësia dhe fillojnë të lëvizin më shpejt. Duke lëvizur më shpejt ato largohen nga njëra-tjetra deri në momentin kur ato shkëputen nga sipërfaqja e lëngut dhe dalin në ajër. <i>Veprimtari:</i> Secili nxënës ka mbi tavolinën e tij një fletë punëdoreje. Kalohet nëpër tavolina me një gotë me ujë dhe nxënësit lagin njërin gisht. Gishtin e lagur e vendosin mbi fletën e punëdore. Drejtohet pyetja: Nxënësit parashikojnë çfarë do të ndodhë me pjesën e lagur të letrës pas disa minutave. Parashikimin e tyre, ata e shkruajnë në fletore. Rikujtohen tri gjendjet e lëndës nëpërmjet pyetjeve: Në çfarë gjendjeje është uji në gotë? Çfarë gjendjesh të tjera të lëndës njohim? Shkruhen në dërrasë emërtimet e tri gjendjeve: “e ngurtë”, “e gaztë” “e lëngët”. A mund të thoni se si ndodh kalimi nga një gjendje e lëndës në tjetrën? Çfarë ndikon? Ftohen nxënësit të shohin fletët që i lagën pak më parë. Çfarë ka ndodhur? Ku shkoi uji? Pse ndodhi kështu? A ishte i saktë parashikimi juaj? Theksohet se kur uji avullon, themi se ai kalon nga gjendja e lëngët në atë të gaztë. Në dërrasë shkruhet: ujë + nxehtësi → gaz			

Nxënësit plotësojnë në fletore përfundimet e veprimtarisë.

Veprimtari: tregohen para nxënësve dy gota të mbushura njëllor me ujë (100 ml). Në secilën prej tyre shënohet në gotë niveli i ujit. U prezantohet nxënësve veprimtaria që do të kryhet: Do të vëzhgohet se kur uji avullon më shpejt? Njërën gotë do ta vendosim në një vend të ngrohtë dhe gotën tjetër në një vend të ftohtë.

Nxiten nxënësit që në fletore të shkruajnë parashikimin e tyre. Orientohen nëpërmjet pyetjeve: A do të jetë i njëjtë niveli i ujit në të dyja gotat? Në cilën gotë do të ketë më pak ujë? Pse mendon kështu?

Pas punës në fletore, drejtohen pyetjet: Çfarë kanë të njëjta gotat? Çfarë kanë të ndryshme? Përse është e rëndësishme që sasia e ujit në to të jetë e njëjtë? Përse është e rëndësishme që gotat të vendosen në dy ambiente me temperatura të ndryshme, për të parë avullimin e ujit në to?

Sqarohen nxënësit se përfundimet e këtij vëzhgimi do t'i shohin pas dy ditësh.

Përmbledhje: Punohen së bashku pohimet e dhëna në faqen 45 të librit dhe në rubrikën “Mësuam se”.

Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për mendimet dhe argumentimet e tyre gjatë veprimtarive të zhvilluara.

Detyra: Punimi i faqes 28 në Fletoren e punës

Refleksion: Në murin e porsalyer, boja mban erë, ndërsa kur thahet, nuk mban më. Pse?

Shënim: Pas dy ditësh ose orën në vazhdim, do të kryhet matja e nivelit të ujit në gota dhe do të shkruhen përfundimet për veprimtarinë e nisur në këtë orë mësimi.

Ora 2

Fusha: Shkencë	Lënda: Dituri natyre	Klasa 5	Data
Tema mësimore: Pse është i dobishëm avullimi?		Situata e të nxënit: Avullimi ftoh	
Rezultatet e të nxënit sipas temës: Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">– vëzhgon procesin e avullimit;– përshkruan kthimin e lëngut në gaz;– heton faktorët që ndikojnë në procesin e avullimit;– tregon se procesi i avullimit kryhet më mirë kur është ngrohtë dhe fryn erë;– tregon raste të procesit të avullimit të lëngut nga tretësira dhe mbetjen e të ngurtave.		Fjalë kyçe: avullim	
Burimet dhe mjetet: figura ku tregohet procesi i tharjes		Lidhja me fushat e tjera: Gjuhët (Gjuhë shqipe)	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Prezantim i përfundimeve të veprimtarisë: Ftohen nxënësit me dëshirë të tregojnë veprimtarinë mbi sasinë e avullimit të ujit në varësi të temperaturave. Bëhet përshkrimi i situatës dhe rikujtohen parashikimet. Si ishte niveli i ujit në gota? Si ishte temperatura e ambienteve ku u vendosën gotat? Merren dy gotat e ujit dhe kontrollohet niveli i sipërfaqes së ujit në gota. Në cilën gotë niveli i ujit është më i ulët? Në cilën gotë ka avulluar më shumë ujë? Si mendoni ju, pse ka ndodhur?			

Përvijim i të menduarit: Paraqiten fotografi të ngjashme me ato të faqes 46 të librit. Sqarohen nxënësit se avullimi është një proces që përdoret me qëllime të ndryshme. Duke parë figurat, tregoni çfarë po ndodh në secilin rast. Pse është i nevojshëm avullimi?

Lexim i drejtuar: ftohen nxënësit të japin mendime se si e kuptojnë ata titullin: Avullimi i ftoh gjërat.

Zhvillohet leximi i fragmentit dhe pas tij diskutohet: Po tani mund të thoni përse avullimi ftoh? Ku e gjejnë nxehtësinë për të avulluar grimcat e djersës ose të dezinfektantit? Tregoni raste të ngjashme nga jeta juaj. Po era çfarë ndikimi ka? Si mendoni ju, në cilin rast do të thahen më shpejt rrobat, kur është ngrohtë apo kur është ngrohtë dhe frynë erë? Pse?

Veprimtari: Udhëzohen nxënësit se për zhvillimin e kësaj veprimtarie “Disa mënyra për t’u freskuar” do të ndiqet drejtimi i mësueses. Gjatë drejtimit të veprimeve bëhet dhe demonstrimi i tyre nga mësuesja ose një nxënës që qëndron përballë me klasën për të treguar. Pasi nxënësit i fryjnë kurizit të dorës me hundë drejtohet pyetja: Si e ndjeni frymën të ngrohtë apo të freskët? Po në të njëjtin vend tani i fryjnë me gojë. Si është fryma në këtë rast? Sugjerohet që provën e tretë me lëpirjen e shpinës së dorës, për arsye higjiene, nxënësit mund ta bëjnë në shtëpi, pasi të kenë larë duart. Parashikoni se çfarë do të ndjeni në rast se i fryni shpinës së dorës pasi ta keni lëpirë? Punë e pavarur: Udhëzohen nxënësit të punojnë individualisht përgjigjet e pyetjeve të dhëna në fq. 47 të librit në rubrikën “Pyetje dhe detyra”

Diskutim: Me gjithë klasën diskutohen përgjigjet e pyetjeve të zhvilluara si detyrë nga nxënësit në fletore.

Ftohen nxënësit të japin mendime të mbështetura në argumente se përse njerëzit në shkretëtirë megjithëse është shumë nxehtë vishen nga koka tek këmbët. Në rast nevojë, nxënësit ndihmohen duke iu rikujtuar procesin e avullimit dhe ndikimin e temperaturës në të.

Vlerësimi: Vlerësohen për mendimet dhe gjetjet gjatë veprimtarive dhe diskutimeve.

Detyra: Punimi i faqes 29 në *Fletoren e punës*

Shënim:

Ora 3

Fusha: Shkencë	Lënda: Dituri natyre	Klasa 5	Data
Tema mësimore: Hulumtojmë procesin e avullimit		Situata e të nxënit: Sa është sasia e ujit që avullon?	
Rezultatet e të nxënit sipas temës: <ul style="list-style-type: none"> – vëzhgon procesin e avullimit; – përshkruan kthimin e lëngut në gaz; – heton faktorët që ndikojnë në procesin e avullimit; – tregon se procesi i avullimit kryhet më mirë kur është ngrohtë dhe kur fryn erë; – tregon raste të procesit të avullimit të lëngut nga tretësira dhe mbetjen e të ngurtave. 			Fjalë kyçe: vëllim
Burimet dhe mjetet: dy enë me madhësi dhe formë të njëjtë, enë të shkallëzuar, disa enë me grykë të madhësive të ndryshme			Lidhja me fushat e tjera: Gjuhët (Gjuhë shqipe), Matematikë

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:

Diskutim: Prezantohen nga nxënësit produktet ushqimore që mund të përgatiten nëpërmjet avullimit. Gjatë prezantimeve nxiten nxënësit të tregojnë dhe për llojin e enës që është më mirë të përdoret për rastin që përshkruan dhe pse pikërisht ajo enë.

Veprimtari: Njihen nxënësit me veprimtaritë hulumtuese që do të zhvillojnë në klasë. Pyetja e ngritur është:

Sa është sasia e ujit që avullon? Përshkruhet dhe demonstron veprimtaria që do të kryhet. Në dy enë të njëjta do të hidhen nga 200 ml ujë. Një enë do të vendosim në dollap, tjetrën në parrakun e dritares.

Vizatohet në dërrasë tabela T. Së bashku me nxënësit përcaktohet se çfarë kanë të përbashkëta dhe çfarë kanë ndryshe dy enët që do të vëzhgohen:

Të njëjta	Të ndryshme
Forma e enëve Sasia e ujit (200 ml) Numri i ditëve (5 ditë) Periudhën e ditës kur do të vëzhgohen	Vendin ku do të mbahen

Diskutohet me nxënësit se si do të kryhet matja e vëllimit të ujit çdo ditë. Ftohen nxënësit të japin mendime të ndryshme p.sh enët të jenë të shkallëzuara, të shënohet niveli i ujit në enë çdo herë që vëzhgohet.

Nxënësit në fletore do të ndërtojnë një tabelë si ajo e fq.48 të librit. Diskutohet mënyra e organizimit të të dhënave në tabelë dhe se si do të hidhen ato gjatë 5 ditëve në vazhdim.

Sugjerohet që në tabelë të shtohet nga një rresht për çdo ditë që do të bëhen matjet.

Bazuar në pyetjet e dhëna në faqen 48 të librit në lidhje me këtë veprimtari, nxënësit do t'u japin përgjigje duke bërë parashikimet e tyre.

Veprimtari: A ndikon forma dhe madhësia e enës në procesin e avullimit? (Iu drejtohet kjo pyetje nxënësve dhe ftohen të japin mendimet e tyre.)

Përshkruhet dhe demonstron veprimtaria që do të kryhet. Në katër enë me madhësi të ndryshme hidhet e njëjta sasi uji (100 ml). Do të lihen në të njëjtin vend për tri ditë. Pas tri ditëve do të matet vëllimi i ujit në secilën enë. Të dhënat do t'i hedhin në fletore, në një tabelë si ajo në faqen 49 të librit.

Diskutim rreth parashikimeve në lidhje me veprimtarinë: A do të zvogëlohet sasia e ujit në enë? Do të jetë i njëjtë ky zvogëlim? Çfarë do të ndodhë me ujin? Nga se ndryshojnë enët nga njëra-tjetra? A ndryshuat ndonjë kusht tjetër për zhvillimin e provës? Mendoni se kjo do të jetë një provë e rregullt? Pse mendoni kështu?

Përmbledhje: Punohen së bashku pohimet e dhëna në faqen 49 të librit, në rubrikën “Mësuam se”.

Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për parashikimet e tyre dhe për argumentet që kanë dhënë lidhur me to.

Detyra: Punimi i faqes 30 të *Fletores së punës*

Shënim: Gjatë ditëve në vijim, nxënësit do të vazhdojnë të kryejnë vëzhgime dhe të hedhin të dhënat në tabelat e tyre në fletore.

Ora 4

Fusha: Shkencë	Lënda: Dituri natyre	Klasa 5	Data
Tema mësimore: Avullimi i lëngut nga tretësira		Situata e të nxënit: tretësirat	
Rezultatet e të nxënit sipas temës: Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> – vëzhgon procesin e avullimit; – përshkruan kthimin e lëngut në gaz; – tregon raste të procesit të avullimit të lëngut nga tretësira dhe mbetjen e të ngurtave; – vëzhgon dhe përshkruan procesin e avullimit të lëngut nga tretësira dhe mbetjen e të ngurtave. 			Fjalë kyçe: tret, lëndë e tretshme, tretësirë, lëndë e tretur, tretës, kristale
Burimet dhe mjetet: ujë, pllakë gatimi, sheqer, një enë qelqi, një lugë çaj, kripë, ujë, një enë e vogël, enë e shkallëzuar			Lidhja me fushat e tjera: Gjuhët (Gjuhë shqipe), Arte, Matematikë
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Diskutim dhe përfundime:</i> Krahasonen të dhënat e hulumtimeve të kryera gjatë javës në lidhje me avullimin e ujit në varësi të temperaturave të ambientit dhe hulumtimit në lidhje me madhësinë e sipërfaqes ku ndodhet uji. Nxënësit diskutojnë në dyshe të dhënat dhe formulojnë nga një përfundim për secilin rast. Krahatojnë përfundimet me parashikimet e kryera në fletore. Më pas çdo dyshe diskuton përfundimet me dy dyshe të tjera dhe formulojnë apo përzgjedhin nga një përfundim për secilin hulumtim. Përfaqësues të grupeve prezantojnë përfundimet. Në hulumtimin e parë sa më ngrohtë të jetë më e madhe është sasia e ujit të avulluar pra procesi i avullimit është kryer më shpejt. Në hulumtimin e dytë sa më e madhe të jetë sipërfaqja ku është uji aq më i madh është avullimi. <i>Brainstorming:</i> Shkruhet në tabelë fjalë “Tretësirë” ftohen nxënësit të tregojnë se çfarë dinë për të. <i>Shpjegim i përparuar:</i> tretësira është formuar nga tretja në ujë, ose në lëngje të tjera, e lëndëve të tretshme. Një tretësirë përbëhet nga lënda e tretur dhe nga tretësi i cili është lëngu në të cilin tretet lënda e tretshme. Iu tregohet nxënësve një tretësirë uji me kripë ose me sheqer. A mund të dalloni dot lëndën e tretur? Lënda e tretur është tretur plotësisht në ujë. Grimcat e lëndës që tretet lëvizin midis grimcave të tretësit. Ftohen nxënësit të shohin figurën e kripores dhe se si nxirret kripa me anë të avullimit në faqen 50 të librit. <i>Veprimtari:</i> Përgatitja e një tretësire. Nxënësit të organizuar në dyshe ndjekin hapat e përshkruar në libër. Udhëzohen nxënësit që brenda grupeve dyshe të organizojnë detyrat e tyre kështu: njëri përgatit tretësirën dhe tjetri mban shënim çfarë vihet re. Më pas, përfundimet e vëzhgimeve diskutohen me të gjithë klasën. <i>Përfundime:</i> Sheqeri u tret në ujë. Uji nuk ndërroi ngjyrë. Lënda e tretur është sheqeri dhe tretësi është uji. Drejtohet pyetja: Çfarë dini për avullimin? Veprimtari: tretet një lugë kripë në një gotë me ujë. Ftohen nxënësit të japin mendime rreth çfarë do të ndodhë nëse uji do të avullojë. Nxiten nxënësit të sugjerojnë mënyra se si mund të veprojnë për të arritur avullimin e ujit. Kryhet eksperimenti. Nxënësit ndërtojnë një grafik me shtylla për të treguar sasinë e ujit para dhe pas avullimit.			

<p><i>Përfundime:</i> Me anë të avullimit mund të ndajmë nga tretësira një lëndë të ngurtë të tretur në ujë.</p> <p><i>Përmbledhje:</i> Punohen së bashku pohimet e dhëna në faqen 49 të librit, në rubrikën “Mësuam se”.</p> <p><i>Diskutojmë:</i> Kur në një gotë me ujë hedhim pak rërë dhe e përziejme, a përftohet tretësirë? Pse?</p>	
<p>Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për përfshirjen në veprimtaritë hulumtuese, për mendimet e dhëna. Vlerësohen për aftësitë e shfaqura gjatë zhvillimit të veprimtarive hulumtuese në dyshe.</p>	
<p>Detyra: Punimi i faqes 31 të <i>Fletores së punës</i></p>	<p>Reflektim: Trego tretësirën ushqimore që të pëlqen më shumë.</p>
<p>Shënim:</p>	

Ora 5

Fusha: Shkencë	Lënda: Dituri natyre	Klasa 5	Data
Tema mësimore: Kondensimi		Situata e të nxënit: Nga vjen uji?	
Rezultatet e të nxënit sipas temës: Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">– vëzhgon procesin e kondensimit;– përshkruan kthimin e gazit në lëng si e kundërta e avullimit;– tregon se ajri përmban avuj uji, i cili kur bie në kontakt me sipërfaqe të ftohtë, kondensohet.		Fjalë kyçe: kondensim, i kundërt	
Burimet dhe mjetet: dy gota qelqi, akull, ujë, enë e shkallëzuar, një copë pëlhurë.		Lidhja me fushat e tjera: Gjuhët (Gjuhë shqipe), Matematikë, Arte	
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</p> <p><i>Diskutim:</i> Ftohen disa nxënës të provojnë të lëshojnë frymë në xhamin e dritares. Çfarë vini re? Xhami është veshur nga një shtresë e hollë. Nga se përbëhet ajo? Si u formua? Sqarohen nxënësit se ajri që nxjerrim gjatë frymëmarrjes është i ngrohtë. Ai përmban avuj uji. Kur ajri i ngrohtë prek sipërfaqe të freskët, si në rastin e xhamit, ai ftohet. Avujt e ujit kthehen nga gaz në pikla uji/ lëngu. Kthimi nga gjendje e gaztë në gjendje të lëngët quhet kondensim. Kondensimi është procesi i kundërt i avullimit. Në dërrasë shkruhet skema:</p> <div><div>lëng nxehtësi gaz procesi quhet avullim</div><div>→</div><div>lëng ftohtësi gaz procesi quhet kondensim</div><div>←</div></div> <p><i>Veprimtari:</i> Nga vjen uji? Udhëzohen nxënësit për kryerjen e veprimtarisë: Dy gota qelqi bosh fshihen nga jashtë me një copë leckë të thatë, për të qenë të sigurt se nuk janë të lagura. Në njërin nga gotat hidhet akull. Lihen gotat për 10 minuta. Ftohen nxënësit të parashikojnë se çfarë do të ndodhë. Pas 10 minutash vëzhgohen gotat dhe diskutohet së bashku duke u dhënë përgjigje pyetjeve: A ishin të lagura nga jashtë gotat kur filluat hulumtimin? Si u siguroat për këtë? Po në fund të hulumtimit, a ishte e lagur ndonjëra prej gotave? Nëse po, cila? Si mendoni, nga erdhi uji? Shpjegoni përgjigjen.</p> <p>Së bashku arrini në këtë përfundim: Kondensimi është procesi i kundërt i avullimit.</p> <p><i>Veprimtari:</i> Njihen nxënësit me veprimtarinë, në të cilën do të vëzhgohen procesi i avullimit dhe ai i kondensimit.</p>			

Demonstrohet veprimtaria dhe në të njëjtën mënyrë do të veprojnë nxënësit në dyshe. Paraqiten dy gota me të njëjtën sasi uji. Njëren gotë e mbulojmë mirë, në mënyrë hermetike, me një qese plastike. Të dyja gotat i lëmë për një natë në ambient të ngrohtë. Çfarë parashikoni se do të shohim të nesërmen në mëngjes? Pse parashikoni këtë? Sqarohen nxënësit se ditën e nesërme do të vëzhgohen gotat dhe do t'i jepen përgjigje tre pyetjeve të para të rubrikës “Pyetje përgjigje”. *Punë e pavarur:* Nxënësit individualisht do të plotësojnë fjalitë me fjalët e dhëna në ushtrimin 4 të faqes 53 të librit. Pas plotësimit disa prej nxënësve lexojnë se si i kanë plotësuar duke i krahasuar me gjithë klasën.

Përforcim: Lexohen së bashku pohimet e dhëna në libër. Diskutohet se si realizohet pastrimi i ujit të pijshëm duke përdorur proceset e avullimit dhe të kondensimit të ujit. Nxiten nxënësit të japin mendimet e tyre duke pasur parasysh njohuritë e marra edhe nga mësimet e mëparshme në lidhje me tretësit dhe avullimin e ujit: situata e Deas dhe e Erilit në detyrën e faqes 31 të *Fletores së punës*.

Vlerësimi: Vlerësohen nxënësit për përfshirjen në veprimtaritë hulumtuese, për mendimet e dhëna gjatë diskutimit të përfundimeve.

Detyra: Punimi i faqes 32 në *Fletoren e punës*

Refleksion: A kanë nevojë bimë për dhe që të rriten?

Shënim: Ditën e nesërme bëhet vëzhgimi dhe nxjerrja e përfundimeve në lidhje me hulumtimin e kryer.

Ora 6 dhe 7

Fusha: Shkencë	Lënda: Dituri natyre	Klasa 5	Data
Tema mësimore: Qarkullimi i ujit në natyrë Tema mësimore: Qarkullimi i ujit në natyrë		Situata e të nxënit: Uji në natyrë	
Rezultatet e të nxënit sipas temës: Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">– përshkruan procesin e avullimit të ujit në natyrë;– përshkruan procesin e kondensimit të ujit në natyrë;– shpjegon qarkullimin e ujit në natyrë, duke dalluar faktorët që ndikojnë në të;– demonstroi bashkëpunim gjatë punës në grup.		Fjalë kyçe: qarkullimi i ujit	
Burimet dhe mjetet: fotografi që tregon ciklin e qarkullimit të ujit në natyrë, materialet për të krijuar një poster.		Lidhja me fushat e tjera: Gjuhët (Gjuhë shqipe), Arte	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Brainstorming: Ku e gjejmë ujin në natyrë? Jepni shembuj të ujit në gjendje të ndryshme në natyrë.			
Nxiten nxënësit të japin shembuj nga jeta, ku të diskutojnë për të tria gjendjet në të cilat mund ta kenë hasur ujin në natyrë.			

Shpjegim i përparuar: Shpjegohet se në natyrë, uji lëviz në mënyrë të pandërprerë. Ai ndjek një cikël, i cili quhet “qarkullimi i ujit në natyrë”. Shkruhet në dërrasë dhe njëkohësisht paraqitet skema që tregon ciklin e qarkullimit të ujit. Udhëzohen nxënësit të studiojnë skemën e treguar në dërrasë ose atë të faqes 54 në libër. Nëpërmjet shigjetave në figurë tregohet qarkullimi i ujit. Ndiqen proceset e avullimit dhe kondensimit që ndodhin në tokë. Kështu: uji avullon nga detet, liqenet, lumenjtë dhe Toka. Edhe bimët lëshojnë avull uji. Këto avuj uji ngjiten lartë ku ndodh kondensimi duke formuar retë. Retë përbëhen nga pikat e ujit të cilat më pas bien në formë shiu ose dëbore. Kështu uji kthehet përsëri në Tokë. Cikli i qarkullimit vazhdon kështu pa pushim. Theksohet se gjatë këtij cikli ndodh edhe shkrirja dhe ngrirja e ujit.

Pyetje-përgjigje: Nxënësit do të punojnë individualisht rubrikën e faqes 55 të librit “Pyetje-përgjigje”.

Organizohen nxënësit në grupe dhe diskutojnë midis tyre përgjigjet e pyetjeve. Më pas, pyetjet diskutohen me të gjithë klasën.

Punimi i posterit: Udhëzohen nxënësit që, siç janë në grupe, duke përdorur informacionin e diskutuar së bashku dhe atë të punuar në libër, të krijojnë një poster për qarkullimin e ujit në natyrë. Pjesë e posterit do të jenë vizatime, përshkrime dhe përmbledhje me përfundime të krijuara nga vetë nxënësit. Në ndarjen e detyrave do të përcaktohet dhe përfaqësuesi i grupit i cili do të bëjë prezantimin e posterit.

Nxënësit do të punojnë rreth 35 minuta me posterin dhe më pas do t’i ekspozojnë.

Turi i galerisë: Me radhë, përfaqësues të grupeve do të vizitojnë dhe dëgjojnë prezantimet e punimeve të grupeve të tjera.

Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për aftësitë e treguara sipas detyrave gjatë punës së grupit në krijimin e një posteri.

Detyra: Punimi i faqes 33 në *Fletoren e punës*

Refleksion: Çfarë do të bënit ndryshe në punën tuaj sot?

Shënim: Nëse koha nuk është e mjaftueshme për përfundimin e prezantimeve, sqarohen nxënësit se prezantimet mund të kryhen edhe në orët në vazhdim.

Ora 8

Fusha: Shkencë	Lënda: Dituri natyre	Klasa 5	Data
Tema mësimore: Vlimi		Situata e të nxënit: Çfarë ndodh me ujin?	
Rezultatet e të nxënit sipas temës: Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> – vëzhgon dhe përshkruan procesin e avullimit, kthimin e lëngut në gaz; – vëzhgon dhe përshkruan se uji vlon në 100°C dhe ngrin në 0°C; – heton faktorët që ndikojnë në procesin e avullimit dhe në procesin e vlimit; – është i/e përgjegjshëm/e për rëndësinë e përdorimit të teknikave dhe të njësive të sakta për matjen e temperaturës në gradë Celsius. 		Fjalë kyçe: vlon, avull, pikë e vlimit	

Burimet dhe mjetet: ujë, një enë, pllakë gatimi, termometër, orë	Lidhja me fushat e tjera: Gjuhët (Gjuhë shqipe), Matematikë, Arte				
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</p> <p><i>Diskutim:</i> Njihen nxënësit me situatën e dhënë në fq56 të Librit. Ftohen nxënësit të tregojnë se çfarë shohin në figurë. Çfarë ka në tenxhere? Çfarë është ai tymi mbi tenxhere? Si mendoni se është ai? Pse iu dogj dora Benit?</p> <p>Sqarohen nxënësit se nëse uji nxehet deri në temperaturën 100°C (gradë Celsius), ai do të vlojë. Vlrimi i lëngut mund të paraqitet me këtë skemë:</p> <p style="text-align: center;">lëng → nxehtësi → gaz</p> <p><i>Veprimtari:</i> Çfarë ndodh me ujin kur vlon? Kjo veprimtari do të zhvillohet nga mësuesja. Udhëzohen nxënësit të qëndrojnë larg dhe të shohin/ ndjekin me vëmendje. Vendoset në një pllakë gatimi një enë me ujë. Lihet uji të nxehet. Gjatë nxehtjes drejtohet pyetje nxënësve: A vini re diçka mbi enën me ujë? çfarë mendoni se është? Lihet uji derisa bën fluska të mëdha në sipërfaqe. Pyetet: Si duket uji gjatë kohës që vlon? Avulli i ujit që lëshohet është i nxehtë. Shpjegohet se kur uji vlon ai kthehet në gaz. Grimcat e lëngut marrin nxehtësi dhe lëvizin shumë shpejt. Disa prej këtyre grimcave lëvizin aq shpejt sa largohen nga njëra-tjetra dhe shpëputen nga sipërfaqja e lëngut duke u kthyer në gaz. Kur vlon, uji kthehet në avull. Kur një lëng nxehet derisa të vlojë, themi se ka arritur pikën e vlimit. Pika e vlimit të ujit është 100°C.</p> <p><i>Veprimtari:</i> Hulumtimi i pikës së vlimit. Kjo veprimtari do të zhvillohet nga mësuesja. Udhëzohen nxënësit të qëndrojnë larg dhe të shohin/ ndjekin me vëmendje. Në një enë me ujë të vendosur mbi pllakën e gatimit do të matet temperatura e ujit çdo dy minuta. Matjet nxënësit do t'i shkruajnë në fletore të organizuara në tabelë:</p> <table border="1" data-bbox="120 1029 1232 1145"> <thead> <tr> <th>Koha në minuta</th><th>Temperatura e ujit në °C</th></tr> </thead> <tbody> <tr> <td> </td><td> </td></tr> </tbody> </table> <p>Matjet e temperaturës do të zhvillohen çdo dy minuta deri 4 minuta pas fillimit të vlimit.</p> <p><i>Diskutim dhe përfundime:</i> A vëreni ndonjë lidhje midis matjeve? Çfarë grafiku do të ndërtoni për të paraqitur rezultatet? Në çfarë temperature vloi uji? A vazhdoi të rritej temperatura e ujit edhe pasi ai arriti pikën e vlimit? Çfarë janë fluskat që formohen nga uji që vlon? Pse uji vlon gjithmonë në temperaturën 100°C?</p>		Koha në minuta	Temperatura e ujit në °C		
Koha në minuta	Temperatura e ujit në °C				
<p>Vlerësimi: Vlerësohen mendimet që japin gjatë diskutimeve në lidhje me proceset që ndodhin deri në vlimin e ujit.</p>					
<p>Detyra: Punimi i faqes 34 në <i>Fletoren e punës</i></p>	<p>Refleksion: Ku qëndron ndryshimi ndërmjet avullimit dhe vlimit?</p>				
<p>Shënim: Sqarohen nxënësit për rrezikshmërinë ndaj temperaturës së lartë gjatë zhvillimit të veprimtarive të kësaj ore mësimi.</p>					

Ora 9

Fusha: Shkencë	Lënda: Dituri natyre	Klasa 5	Data
Tema mësimore: Shkrija		Situata e të nxënit: Çfarë shkrin?	
Rezultatet e të nxënit sipas temës: – Vëzhgon procesin e shkrijes së ujit. – Përkshkruan se uji ngrin dhe shkrin në temperaturën 0°C. – Është i përgjegjshëm për rëndësinë e përdorimit të teknikave dhe të njësive të sakta për matjen e temperaturës në gradë Celsius me termometër.		Fjalë kyçe: shkrin, pika e shkrijes	
Burimet dhe mjetet: copa akulli, një enë, termometër, orë		Lidhja me fushat e tjera: Gjuhët (Gjuhë shqipe), Matematikë, Arte	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Bisedë: A e keni dëgjuar fjalën shkrija? Tregoni në cilat raste Sqarohen nxënësit se kur një lëndë shkrin, ajo kthehet nga gjendja e ngurtë në gjendje të lëngët. Shkruhet në dërrasë skema: në gjendje të ngurtë → nxehtësi → lëng Lexim i drejtuar: Si mendoni ju, çfarë ndodh me grimcat e lëndës kur ajo kalon nga gjendja e ngurtë në të lëngët? Lexohet dhe diskutohet informacioni që jepet në fq.58 të librit. Drejtohen pyetjet: Ku e gjejmë energjinë grimcat e lëndëve të ngurta? Çfarë ndodh me lëvizjen e tyre? A ndikon lëvizja e grimcave të lëndës në ndryshimin e gjendjes së saj? A kanë të gjitha lëndët të njëjtën pikë shkrije? Pse? Për këtë pyetje udhëzohen nxënësit të mendojnë mbi grimcat e materialeve të ndryshme nga të cilat përbëhen lëndë të ndryshme. Studiohen të dhënat në figurat e librit. Si mendoni ju, cilat lëndë e kanë pikën e shkrijes më të lartë? Veprimtari: Në një gotë vendoset një copë akull. Vendoset termometri në të dhe në çdo minutë kryhet matja e temperaturës për 10 minuta. Të dhënat nxënësit i shkruajnë në tabelë në fletore:			
Koha në minuta		Temperatura e akullit në °C	
Diskutim dhe përfundime: udhëzohen nxënësit të shohin rezultatet në tabelë. A kanë ndonjë lidhje midis rezultateve? Në cilën temperaturë shkriu akulli? Mendoni se akulli shkrin gjithmonë në të njëjtën temperaturë? Si mund të provohet kjo? Pika e shkrijes së akullit është 0°C. Parashikoni sa do të jetë temperatura e akullit të shkrijë pas 20 minutash? Argumentoni. Bëhet matja e temperaturës pas 20 minutash. Nxënësit tregojnë nëse e kanë gjetur me parashikimin e tyre. Pse gjatë dimrit, për të shmangur formimin e akullit në rrugë hidhet kripë? Ndihmohen nxënësit të mendojnë rreth tretësirës që formohet gjatë hedhjes së kripës. Përmbledhje: Punohen së bashku pohimet e dhëna në fq 49 të Librit në rubrikën “Mësuam se”.			

Vlerësimi: Vlerësohen mendimet që japin gjatë diskutimeve në lidhje me procesin e shkrirjes së lëndëve të ndryshme.

Detyra: Punimi i faqes 34 në Fletoren e punës

Shënim:

Ora 10

Fusha: Shkencë	Lënda: Dituri natyre	Klasa 5	Data
Tema mësimore: Kontrolloni përparimin tuaj		Situata e të nxënit: Unë di	
Rezultatet e të nxënit sipas temës: Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">– përshkruan procesin e avullimit, kthimin e lëngut në gaz;– përshkruan procesin e kondensimit, kthimin e gazit në lëng, si proces i kundërt i avullimit;– tregon se ajri përmban avuj uji, i cili kur bie në kontakt me sipërfaqe të ftohtë, kondensohet;– përcakton se uji vlon në 100°C dhe ngrin në 0°C;– përshkruan dhe shpjegon qarkullimin e ujit në natyrë, duke dalluar faktorët që ndikojnë në të.		Fjalë kyçe: ngrirje, shkrirje, avullim, kondensim, vlim, avull, ujë	
Burimet dhe mjetet: enciklopedi, projekti		Lidhja me fushat e tjera: Gjuhët (Gjuhë shqipe), Matematikë, Arte	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <p><i>Lojë:</i> Thuhet pohimi dhe hidhet topi. Ai/ajo që e pret topin, emërton procesin për të cilin bëhet fjalë. Demonstron nga mësuesja dhe më pas vazhdojnë nxënësit me njëri-tjetrin.</p> <p>Për shembull: Njëri nxënës thotë: “Një lëng kthehet në gaz”.</p> <p>Tjetri që pret topin, thotë: “Avullim”.</p> <p><i>Punë e pavarur:</i> Plotësim i rubrikave të dhëna në fq. 60 - 61 në libër. Krahësim dhe diskutim në dyshe të plotësimeve të tyre. Përfaqësues të dysheve prezantojnë përfundimet për secilën rubrikë.</p> <p><i>Refleksion:</i> Ftohen nxënësit të tregojnë nëpërmjet vizatimit dhe ngjyrave ndjesitë e tyre.</p>			
Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen individualisht për punimin e rubrikave të librit, argumentimin e mendimeve dhe qëndrimeve që shfaqin.			
Detyra: Punimi i faqes 36 në <i>Fletoren e punës</i>		Refleksion: Përshkruaj si u ndjeve gjatë rikujtimit dhe diskutimit të këtyre temave.	
Shënim:			

Kapitulli 5

Si arrijmë t'i shohim objektet

Ora 1

Fusha: Shkencë	Lënda: Dituri natyre	Klasa 5	Data
Tema mësimore: Drita përhapet nga burimi i saj		Situata e të nxënit: Drita del nga elektriku apo futet në të?	
Rezultatet e të nxënit sipas temës: Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> identifikon burimet e ndryshme të dritës; shpjegon se dielli është burimi kryesor i dritës; shpjegon se ne i shohim trupat, pasi drita nga burimi shkon tek objekti, i cili e pasqyron në syrin tonë; tregon se errësira është mungesa e dritës; tregon rrugën që përshkon rrezja rënëse nga burimi deri te syri ynë. 			Fjalë kyçe: burim drite, tufë drite, objekt, pasqyron (reflekton)
Burimet dhe mjetet: elektrik dore me bateri, kuti kartoni, monedhë			Lidhja me fushat e tjera: Gjuhë Shqipe, Matematikë, Teknologji
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</p> <p><i>Diskutim:</i> Si përhapet drita? Në klasë bëhet errësirë. Tërhiqet vëmendja për të gjetur një zgjidhje të situatës. Më pas ndizet elektriku i dorës. Drejtohet pyetja: Drita del nga elektriku apo futet në të? Nxiten nxënësit të japin mendimet e tyre. Sqarohen nxënësit se elektriku i dorës është burim i dritës, pra drita del prej tij. A mund ta shohim qartë objektin në fund të klasës, ku nuk është i ndriçuar? Pasi drejtohet elektriku i dorës, pyeten nxënësit: Po tani, a e shohim më qartë? Si mendoni ju, pse?</p> <p><i>Lexim rishikim në dyshe:</i> Ftohen nxënësit të shohin në faqen 62 të librit dh të lexojnë e diskutojnë rreth materialit të dhënë në të. Më pas diskutohet me të gjithë klasën: Çfarë është tufa e dritës? Nga se është e përbërë tufa e dritës? Për të pasur tufë drite, çfarë është e nevojshme të kemi? Pse dielli është burim drite? Theksohet se dielli është burimi kryesor i dritës. Po në figurat e tjera, çfarë pjese e objektit të paraqitur është burimi i dritës? Mund të përmendni burime të tjera drite nga jeta e përditshme?</p> <p>Shpjegohet se drita, nga burimi i saj shpërndahet dhe ndriçon objektet përreth. Rikujtohet veprimtaria e fillimit të orës mësimore me objektin e pandriçuar dhe ndryshimi kur ai u ndriçua nëpërmjet burimit të dritës. Sqarohen nxënësit se drita del nga burimi dhe përhapet mbi objekte. Ato e kthejnë dritën drejt syve tanë. Ky kthim është pasqyrim ose reflektim i dritës nga objektet tek ne. Kjo bën të mundur që ne t'i shohim objektet.</p> <p>Drejtohet pyetja: Reflektimi i dritës nga objekti në sytë tanë a i bën objektet burime drite? Ku qëndron ndryshimi ndërmjet tyre? Në dërrasë vizatohet skema:</p>			

Rrezet e dritës dalin nga burimi i dritës.

Drita pasqyrohet në sytë tanë.

Objekti ndriçohet nga tufa e dritës.

Theksohet rëndësia e dallimit të burimit të dritës nga ato që e pasqyrojnë rrezet e dritës.

Veprimtari: Përgatitja e mjeteve për zhvillimin e veprimtarisë (hapja e dy vrimave në kapakun e kartonit) bëhet nga mësuesi/ja. Përshkruhet dhe demonstrohet veprimtaria. Ftohen nxënësit të bëjnë parashikime:

1. Në rastin kur burimi i dritës është i ndezur në njërën prej vrimave të kapakut, a do të shihet monedha brenda në kuti?

2. Në rastin kur njëra vrimë e kapakut është e mbuluar dhe nuk ka ndriçues, a do të shihet monedha brenda në kuti?

Pas shkrimit të parashikimit në fletore, të gjithë nxënësit shohin nga afër rastet që parashikuan për kutinë prej kartoni. Diskutohet së bashku me klasën: Çfarë vutë re? Në cilin rast arritët ta shihni monedhën? Pse? A ishin të njëjta përfundimet me parashikimet tuaja?

Punë e pavarur: Nxënësit punojnë individualisht ushtrimet e rubrikës “Pyetje dhe detyra”.

Reflektim: Më pas, përfundimet diskutohen së bashku. Disa nxënës vizatojnë në tabelë skemën e shigjetave të vizatuara në figurën e librit. Gjatë vizatimit bëhet sqarimi i ushtrimit.

Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për mendimet e shprehura gjatë veprimtarisë dhe për interpretimin e gjetjeve. Ata vlerësohen edhe për punën individuale në plotësimin e rubrikës “Pyetje dhe detyra”.

Detyra: Punimi i faqes 37 në Fletoren e punës

Refleksion: Në çfarë pozicioni duhet ta mbajmë llambën kur lexojmë?

Shënim: Për orën në vazhdim porositen nxënësit të sjellin nga një pasqyrë të vogël


Ora 2

Fusha: Shkencë	Lënda: Dituri natyre	Klasa 5	Data
Tema mësimore: Pasqyrat		Situata e të nxënit: Shihemi në pasqyrë.	
Rezultatet e të nxënit sipas temës: Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> identifikon burimet e ndryshme të dritës; argumenton se sipërfaqet e ndriçuara nuk janë burime drite; shpjegon se ne i shohim trupat, pasi drita që del nga burimi i saj, vjen në syrin tonë; shpjegon se drita përhapet në vijë të drejtë, por mund ta ndryshojë drejtimin e saj; vizaton rrezen e rënies së dritës dhe rrezen e pasqyruar. 			Fjalë kyçe: sipërfaqe, pasqyrë, shëmbëllim, periskop, paraqes
Burimet dhe mjetet: dy pasqyra të vogla, një objekt i vogël, periskop			Lidhja me fushat e tjera: Gjuhë Shqipe, Arte

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:

Brainstorming: Të ndarë në grupe dyshe, nxënësit i tregojnë njëri-tjetrit zgjidhjet e ushtrimeve të faqes 37 të *Fletores së punës*. Disa prej nxënësve vizatojnë skemat e ushtrimeve në dërrasë dhe shpjegojnë: Cilat janë burimet e dritës? Çfarë rruge bëjnë rrezet e dritës për të arritur në syrin e personazheve? Duke u bazuar në situatat e ushtrimeve, a mund të krijoni disa këshilla për njëri-tjetrin?

Shpjegim i përparuar: Ftohen nxënësit të vendosin pasqyrën para fytyrës. Çfarë shihni? Si mendoni se ndodh kjo? Shpjegohet se pasqyrat kanë sipërfaqe të lëmuar. Sipërfaqet e lëmuara e reflektojnë shumë mirë dritën. Për këtë arsye, kur shihemi në pasqyrë, shohim pasqyrimin e fytyrës sonë. Pamja e fytyrës në pasqyrë quhet shëmbëllim. Shpjegohet nëpërmjet vizatimit në dërrasë çfarë ndodh me rrezet e dritës në pasqyrë.



Sqarohet se rrezja e dritës paraqitet me vija të drejta, ndërsa shigjeta tregon drejtimin e rrezes së dritës.

Veprimtari: Organizohen nxënësit në dyshe. Sqarohen hapat e zhvillimit të veprimtarisë, njëkohësisht demonstron mënyra e veprimit. Pasi bëjnë provat, nxënësit shkruajnë në fletore përgjigjet e pyetjeve. Më pas, situatat dhe përgjigjet rreth tyre diskutohen me të gjithë klasën: Kur u patë në pasqyrë, a ishte i njëjtë shëmbëllimi me ju? Lëvizët dorën e majtë, a ndodhi kjo lëvizje edhe në shëmbëllimin tuaj në pasqyrë?

Në provën e herës së shkuar, si ishte shëmbëllimi në të dyja rastet? A ndryshoi ai? Në rast se nxënësit kanë pasur vështirësi, ndihmohen ta kryejnë në atë moment provën. Veprohet në të njëjtën mënyrë me dy pasqyrat dhe objektin e vogël mes tyre. Sa shëmbëllime të objektit patë? Si mendoni ju, pse? Udhëzohen nxënësit të përshkruajnë rrugën që bëjnë rrezet e dritës nga burimi, tek objekti, pasqyrohen tek pasqyra dhe pastaj në syrin tonë.

Shpjegim i përparuar: Para nxënësve shfaqet një periskop. Tregohen pjesët përbërëse të tij dhe si është i ndërtuar. Drejtohet pyetja: A ju ka rënë rasti të shihni një periskop? Si mendoni, përse mund ta përdorin njerëzit këtë mjet? Sqarohen nxënësit se periskopët përdoren për të parë përtej një pengese. Xhamat zmadhues, të cilët ndodhen brenda periskopit, pasqyrojnë rrezet e dritës në brendësi, derisa vijnë në syrin tonë. Ftohen nxënësit të shohin figurat e faqes 65 të librit. Diskutohet për rastet e prezantuara në figura, ku është përdorur periskopi. Ftohen nxënësit të shpjegojnë me një laps në dorë figurën e librit, drejtimin e rrezes së dritës nëpërmjet shigjetës në periskop. Fillohet nga rrezja e dritës që hyn në periskop, ku pasqyrohet, për të vazhduar rrugën që bën ndërmjet dy pasqyrave deri te pika e vërtetimit.

Pyetje-përgjigje: Punohen së bashku pyetjet e paraqitura në faqen 65 të rubrikës “Pyetje dhe detyra”. Për realizimin e ushtrimit të dytë nxënësit e punojnë në fletore dhe më pas, me dëshirë, vizatojnë e shpjegojnë në dërrasë drejtimin në të cilin përhapet drita. Ndërsa për ushtrimin e tretë, renditja e pohimeve duhet të jetë: b, c, d, a. Vërtetësia e kësaj renditjeje mbështetet te demonstrimi në figurën e dhënë në libër.

Diskutim: A kanë gjithmonë të njëjtën madhësi shëmbëllimet me objektet? Për t'i dhënë përgjigje kësaj pyetjeje, nxënësit duhet të ndihmohen për të rikujtuar llojet e ndryshme të pasqyrave.

Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për mendimet dhe gjetjet gjatë diskutimeve.

Detyra: Punimi i faqes 38 në Fletoren e punës	Refleksion: A të pëlqen të shihesh në pasqyrë?
Shënim:	

Ora 3

Fusha: Shkencë	Lënda: Dituri natyre	Klasa 5	Data
Tema mësimore: Si të shikojmë pas vetes?		Situata e të nxënit: Shihemi në pasqyrë.	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas temës:</p> <p>Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none">– shpjegon se drita përhapet në vijë të drejtë, por mund të ndryshojë drejtimin e saj;– tregon se drita pasi pasqyrohet, bie në syrin tonë dhe ne arrijmë të shohim objektet;– shpjegon përdorimet e ndryshme të pasqyrave;– vizaton rrezen e rënies së dritës dhe rrezen e pasqyruar;– shpjegon se pasqyrat përdoren për të parë objektet: para/ prapa/ përreth/ sipër nesh;– demonstroi nëpërmjet eksperimentit pasqyrimin e dritës.		<p>Fjalë kyçe: pasqyrë, shëmbëllim</p>	
<p>Burimet dhe mjetet: Letra ngjytëse, pasqyra të vogla, pasqyra e dentistit</p>		<p>Lidhja me fushat e tjera: Gjuhë Shqipe, Arte</p>	
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</p> <p><i>Diskutim për njohuritë paraprake:</i> Të organizuar në grupe dyshe, nxënësit i tregojnë njëri-tjetrit zgjidhjet e ushtrimeve të faqes 38 të <i>Fletores së punës</i>. Disa prej nxënësve, me dëshirë, vizatojnë skemat e ushtrimeve në dërrasë dhe shpjegojnë rrugën e shigjetave të vizatuara: drita që del nga burimi; drita e pasqyruar.</p> <p><i>Lojë në role:</i> Caktohen tre nxënës të interpretojnë situatën: Dy vajza, nga të cilat njëra mundësisht t’i ketë flokët gërshetë (Sara) dhe tjetra është Ana. Një nxënës lexon situatën e dhënë në faqen 66 të librit. Sara dhe Ana do të mbajnë nga një pasqyrë në dorë. Nxënësit dëgjojnë pjesën e lexuar, duke ndjekur ndërkohë interpretimin e nxënësve. Pas pozicionimit të pasqyrave në mënyrë që të shihet pjesa e prapme e kokës, drejtohet pyetja: Si arrin t’i shikojë gërshetat Sara? Tregoni rrugën që ndjek rrezja e dritës nga burimi deri te syri i Sarës.</p> <p>Sqarohen nxënësit dhe demonstroi në vijë ajrore rruga e rrezes së dritës: Burimi i dritës ndriçon në dhomë pjesën e pasme të kokës së saj. Prej aty, drita reflektohet mbi pasqyrën që mban Ana. Më pas ajo reflektohet nga kjo pasqyrë në pasqyrën përballë Sarës dhe prej andej, drejt syve të saj.</p>			

Lojë: Orientohen nxënësit për lojën. Secili prej tyre do të mbajë në dorë nga një copë letër me ngjitës dhe një stilolaps. Nxënësit ftohen të ngrihen në këmbë dhe vijnë rrotull nëpër klasë. Secili nxënës do të ngjisë letrën në kurrizin e shokut dhe në të do të shkruajë një fjalë pozitive për të. Në kurrizin e të gjithëve duhet të ketë vetëm nga një letër. Nëse shoku ose shoqja që mendove e ka letrën të vënë më parë, kërko dikë tjetër për t'ia vendosur letrën tënde. Kështu, kur mësuesja të njoftojë që koha mbaroi, të gjithë të kenë përfunduar me shkrimin e letrave dhe secili e ka një letër të shkruar dhe të ngjitur në kurrizin e tij. Më pas, grupet dyshe në tavolina do të ndihmojnë njëri-tjetrin me radhë për të lexuar fjalën që i kanë shkruar shokët në fletë. Me dëshirë disa nga dyshet demonstrojnë se si vepruan me pasqyrat për të lexuar letrat. Gjatë demonstrimit ata do të përshkruajnë rrugën që bëri drita për të arritur në syrin e tyre. Ftohen nxënësit të provojnë për të parë nëpërmjet pasqyrave objekte që ndodhen anash apo lart.

Diskutim: Pas lojës ftohen nxënësit të shohin figurat në faqen 67 të librit. Diskutohet rreth rasteve të paraqitura në figura dhe për përdorimin e pasqyrave në jetën e përditshme. Nxënësve ju paraqitet në realitet një pasqyrë makine, pasqyra që përdor dentisti, pasqyrë e mysët. Nxiten nxënësit të flasin mbi mënyrat e përdorimit të tyre. Gjithashtu të japin mendime rreth rubrikës “Pyetje dhe detyra”.

Përfundimi: Pasqyrat na ndihmojnë të shohim çdo gjë që ndodhet pas nesh.

Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për demonstrimin dhe shpjegimin e situatave gjatë veprimtarive në klasë.

Detyra: Punimi i faqes 39 në *Fletoren e punës*

Refleksion: Si mund ta shohim një objekt që ndodhet në korridor, pa e nxjerrë kokën jashtë derës së dhomës?

Shënim: Në raste vështirësie nxënësit ndihmohen herë pas here në pozicionimin e pasqyrave dhe interpretimin e rrugës që bën rezja e dritës.

Ora 4

Fusha: Shkencë	Lënda: Dituri natyre	Klasa 5	Data
Tema mësimore: Cilat sipërfaqe e pasqyrojnë dritën më mirë?		Situata e të nxënit: Pasqyrimi i dritës	
Rezultatet e të nxënit sipas temës: Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> demonstron nëpërmjet eksperimentit pasqyrimin e dritës; krahason sipërfaqet që pasqyrojnë dritën; shpjegon se sipërfaqet e ndritshme dhe të sheshta e pasqyrojnë dritën; shpjegon se sipërfaqet e ashpra e përthithin dritën. 		Fjalë kyçe: rendit	
Burimet dhe mjetet: gjashtë ose më shumë objekte		Lidhja me fushat e tjera: Gjuhë Shqipe, Matematikë	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:

Dëgjim i drejtuar: Nëpërmjet të treguarit, nxënësit njihen me situatën e Onit dhe Deas. Oni kishte në dorë një pasqyrë. Pasi e vendosi para vetes tha se e shihte shumë mirë veten e saj. Dea mori dhe vendosi para vetes një pllakë druri. Ajo u mundua të shihte veten por nuk arriti dot. Si mendoni, përse nuk arriti Dea të shihej në pllakën e drurit? Po Oni, mundi të shihej? Çfarë mund të thoni për këto dy raste? Si është sipërfaqja e pasqyrës? Po sipërfaqja e drurit?

Shpjegim i përparuar: Shpjegohet se sipërfaqet e lëmuara e pasqyrojnë rrezen e dritës, kurse ato më pak të lëmuara e përthithin atë. Kështu, në rastin tonë, pasqyra ka sipërfaqe të lëmuar dhe e bën pasqyrimin, ndërsa pllaka e drurit e ka sipërfaqen të ashpër, ndaj e thith dritën. Sa më i lëmuar të jetë një material aq më mirë e pasqyron dritën, sa më i ashpër të jetë një material aq më mirë e thith dritën.

Prezantohet figura e fq.68 të librit. Nxënësit vëzhgojnë se si duket sipërfaqja e letrës e parë në mikroskop. Si mendoni ju, a e pasqyron dritën sipërfaqja e kësaj letrë?

Veprimtari: Të ndarë në grupe dyshe, nxënësit do të vendosin mbi tavolinë objekte të ndryshme. Secili prej tyre do të parashikojë në fletore se si e pasqyrojnë dritën sipërfaqet e këtyre objekteve. Më pas do të vëzhgojnë objektet dhe sipërfaqet e tyre dhe do t'i renditin duke filluar nga ato që e pasqyrojnë më mirë dritën. Renditjen e tyre ata do ta bëjnë në fletore. Më pas përfundimet do t'i krahasojnë me parashikimet.

Nxënësit do të udhëzohen të mendojnë se si mund t'i paraqesin të dhënat e këtij hulumtimi në një formë tjetër në grafikë. Mendimet e dysheve diskutohen me gjithë klasën. Në boshtin horizontal do të shkruhen emërtimet e objekteve dhe në boshtin vertikal nivelet e pasqyrimin p.sh. nuk pasqyron, pasqyron pak, pasqyron mirë, pasqyron shumë mirë. Secili nxënës ndërton grafikun në fletore dhe krahason të dhënat e tij me ato të shokut ose shoqes së bankës.

Pyetje-përgjigje: Drejtohen pyetjet: Si vepruat për të kryer një provë të rregullt? Në cilin rast prova do të kryhej e parregullt? Ftohen nxënësit të tregojnë mbi kushtet e njëjta të zhvillimit të provës, p.sh.: vendi dhe burimi i njëjtë i kryerjes së provës. Në rastin e një prove të parregullt, mjafton ndryshimi i njërit prej këtyre kushteve, p.sh.: ndryshimi i burimit të dritës.

Përfundime: Objektet me sipërfaqe të ndryshme e pasqyrojnë ndryshe dritën. Sipërfaqet e lëmuara dhe të shndritshme e pasqyrojnë shumë mirë dritën. Sipërfaqet e ashpra e thithin dritën.

Vlerësimi: Vlerësohen nxënësit për përfshirjen në veprimtaritë hulumtuese, për mendimet e dhëna. Ata vlerësohen gjithashtu për aftësitë e treguara gjatë zhvillimit të veprimtarive në dyshe.

Detyra: Punimi i faqes 40 në Fletoren e punës

Reflektim: Si mendoni, ku i shikonin njerëzit shëmbëllimet e tyre kur nuk ishin zbuluar ende pasqyrat?

Shënim:

Ora 5

Fusha: Shkencë	Lënda: Dituri natyre	Klasa 5	Data
Tema mësimore: Drita mund të ndryshojë drejtimin e përhapjes		Situata e të nxënit: Si pasqyrohet drita?	
Rezultatet e të nxënit sipas temës: Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">– tregon se drita pasi pasqyrohet, bie në syrin tonë dhe ne shohim objektet;– vizaton rrezen e rënies së dritës dhe rrezen e pasqyruar;– demonstroi nëpërmjet eksperimentit pasqyrimin e dritës;– tregon se këndi i rënies së rrezeve të dritës është i barabartë me këndin e pasqyrimin;– tregon rrugën që përshkon rrezja rënëse e dritës nga burimi deri te syri ynë.		Fjalë kyçe: kënd, rreze	
Burimet dhe mjetet: vend i errët, elektrik dore, pasqyrë, fletë letre e bardhë, fletë letre e errët, gjilpërë, ngjitës shirit		Lidhja me fushat e tjera: Gjuhë Shqipe, Teknologji, Matematikë	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <p>Lojë. Demonstronhet para klasës hedhja e topit me kënd, ashtu si situata në figurën e faqes 70 të librit. Orientohen nxënësit të shohin lëvizjen e topit, rrugën që bën ai nga duart e mësueses, në tokë dhe pastaj në duart e nxënësit. Demonstrimi fillon nga mësuesi/ja dhe një nxënës, dhe më pas, me radhë, nxënësit ia hedhin topin me kënd njëri-tjetrit. Në fund drejtohet pyetja: Çfarë vutë re në lidhje me drejtimin që merr topi kur ia pasuat njëri-tjetrit, duke e përplasur në tokë? A e patët të vështirë orientimin për t’u pozicionuar në marrjen e topit? E njëjta gjë ndodh dhe me drejtimin e dritës kur ajo pasqyrohet.</p> <p>Shpjegim i përparuar: Në dërrasë vizatohet skema:</p> <div><p>Këndet a dhe b janë të barabarta</p></div> <p>Shpjegohet se pasqyra e reflekton dritën me të njëjtin kënd me të cilin drita bie mbi të. Shigjetat tregojnë rrugën që përshkon drita kur bie mbi pasqyrë. Vijat e drejta përfaqësojnë rrezet e dritës. Ftohen nxënësit të lexojnë dhe studiojnë situatën e përshkruar në faqen 70 të librit. Ata i tregojnë njëri-tjetrit rrugën që bën drita në skemën e dhënë në libër.</p> <p>Veprimtari: Ftohen nxënësit në dyshe të ndjekin hapat e veprimtarisë në libër. Përgatitja e mjetit mund të ndiqet në demonstrimin që bën mësuesja para klasës. Më pas zhvillohen provat dhe përcaktohet rrezja e dritës së pasqyruar në fletën e bardhë. Në figurën e librit nxënësit me laps vizatojnë rrugën e rrezes së dritë. Krahasojnë këndin e formuar nga rënia e rrezes në pasqyrës me këndin e formuar nga pasqyrimi i rrezes nga pasqyra. Theksohet se në të dy rastet njëra brinjë e këndit është pasqyra.</p>			

Diskutim: Çfarë vutë re në lidhje me këndin që formon rrezja e dritës kur bie në pasqyrë dhe me këndin me të cilin ajo reflektohet prej saj? Pse ndodh kjo? Si mendoni, a do të ishte më mirë që kjo veprimtari të përsëritej disa herë? Pse? Theksohet se këndi i rënies së rrezes së dritës në pasqyrë është i barabartë me këndin e pasqyrimin të rrezes së dritës nga pasqyra. Përsëritja e provave disa herë do të bëjë që përfundimet e provës të jenë të vërteta.

Nxënësit studiojnë individualisht në libër vizatimin e rënies së rrezes së dritës dhe të pasqyrimin të saj. Më pas, nxënësit krahasojnë përfundimet e tyre dhe i argumentojnë ato së bashku. Me dëshirë, nxënësit mund të vizatojnë figurën në dërrasë dhe ta shpjegojnë atë para klasës.

Vlerësimi: Vlerësohen nxënësit për përfshirjen në veprimtaritë hulumtuese, për mendimet e dhëna gjatë daljes në përfundime.

Detyra: Punimi i faqes 41 në *Fletoren e punës*

Refleksion: Në rastin kur duam të shohim prapa vetes, si ndikon këndi i pasqyrimin të dritës në mënyrë që ne të arrijmë të shohim?

Shënim:

Ora 6

Fusha: Shkencë	Lënda: Dituri natyre	Klasa 5	Data
Tema mësimore: Kontrolloni përparimin tuaj		Situata e të nxënit: Unë di	
<ul style="list-style-type: none"> – rezultatet e të nxënit sipas temës; – identifikon burimet e ndryshme të dritës; – argumenton se sipërfaqet e ndriçuara nuk janë burime drite; – shpjegon se ne shohim trupat, pasi drita nga burimi vjen në syrin tonë; – tregon se errësira është mungesa e dritës; – tregon se drita pasi pasqyrohet, bie në syrin tonë dhe ne shohim objektet; – tregon se pasqyrat kanë sipërfaqe të ndritshme; – shpjegon përdorimet e ndryshme të pasqyrave; – vizaton rrezen e rënies dhe rrezen e pasqyruar; – shpjegon se pasqyrat përdoren për të parë objektet para/prapa/përreth/sipër nesh; – krahason sipërfaqet që pasqyrojnë dritën; – shpjegon se sipërfaqet e ndritshme dhe të sheshta e pasqyrojnë dritën; – shpjegon se sipërfaqet e ashpra e përthithin dritën; – tregon se këndi i rënies së rrezeve të dritës është i barabartë me këndin e pasqyrimin; – tregon rrugën që përshkon rrezja rënëse e dritës nga burimi deri te syri ynë. 		Fjalë kyçe: burim drite, rreze drite, pasqyrim	
Burimet dhe mjetet		Lidhja me fushat e tjera: Gjuhët (Gjuhë Shqipe), Matematikë, Arte	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:

Parashikim me terma paraprakë: Duke përdorur fjalët: burim drite, rreze drite, pasqyrim, pasqyrë, sy, ndërtoni një paragraf, ku të tregoni se çfarë mbani mend nga këto grup temash. Disa prej nxënësve me dëshirë lexojnë shkrimet e tyre.

Punë e pavarur: Plotësim i rubrikave të dhëna në faqet 72 dhe 73 në libër. Krahasim dhe diskutim në dyshe të plotësimeve të tyre. Përfaqësues të dysheve prezantojnë përfundimet për secilën rubrikë.

Reflektim: Nxënësit me forma të ndryshme, shkrime, vizatime, punime në dyshe prezantojnë ndjesitë gjatë plotësimit të rubrikave në klasë.

Vlerësimi: Vlerësimi individual në punimin e rubrikave të librit, argumentimin e mendimeve dhe qëndrimeve që mbajnë.

Detyra: Punimi i fq.22 të Fletore Pune

Refleksion: Trego si u ndjeve gjatë rikujtimit dhe diskutimit të këtyre temave.

Shënim: Porositen nxënësit të gjejnë materiale nga enciklopedi të ndryshme, që tregojnë mbi përdorimet në praktikë të pasqyrimin të dritës.

Ora 7

Fusha: Shkencë	Lënda: Dituri natyre	Klasa 5	Data
Tema mësimore: Projekt “Drita dhe pasqyrimi i saj, përdorimet në jetën e njeriut”		Situata e të nxënit: Pasqyrimi i dritës	
Rezultatet e të nxënit sipas temës: <ul style="list-style-type: none"> – punimi i një projekti mbi “Drita dhe pasqyrimi i saj, përdorimet në jetën e njeriut”; – identifikon burimet e ndryshme të dritës; – shpjegon përdorimet e ndryshme të pasqyrave; – shpjegon se pasqyrat përdoren për të parë objektet para/prapa/përreth/sipër nesh; – tregon rrugën që përshkon rrezja rënëse e dritës nga burimi deri te syri ynë; – tregon ndikimin dhe rëndësinë e përdorimit të pasqyrave në jetën e njeriut. 		Fjalë kyçe: burim drite, rreze drite, pasqyrim, ndikim	
Burimet dhe mjetet: enciklopedi, projekti		Lidhja me fushat e tjera: Gjuhë Shqipe, Matematikë, Arte	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:

Bisedë: Në qendër të dërrasës shkruhet tema e projektit “Drita dhe pasqyrimi i saj në jetën e njeriut“. Bëhet i ditur qëllimi i projektit: prezantimi i përdorimeve të burimeve të dritës dhe pasqyrimin e saj në fusha dhe situata të ndryshme të jetës së njeriut. Ndikimet që ka apo ka pasur përgjatë kohëve. Organizohen nxënësit në grupe për punimin e projektit. Secili pjesëtar i grupit paraqet materialet e sjella në funksion të projektit dhe japin idetë e tyre.

Projekt: Vazhdohet puna në grupe në përpunimin e të dhënave, paraqitjet grafike të tyre, formulimin e përfundimeve. Gjatë punës me prezantimin e projektit nxënësit mbështeten nga mësuesja.

Prezantime: Ekspozohen punimet e grupeve përreth klasës. Përcaktohet koha që ka në dispozicion secili grup për të bërë prezantimin. Sqarohen se brenda kësaj kohe pjesëtarë të tjerë të grupit kanë të drejtë të plotësojnë. Përfaqësuesit e grupeve bëjnë me radhë prezantimet e punëve të grupit. Me mbarimin e prezantimit diskutohet dhe vlerësohet puna e grupit për projektin.

Vlerësimi: Vlerësim i grupeve për realizimin e projektit dhe për kontributin që ka dhënë secili.

Detyra: Nxënësit mund të tregojnë në forma të ndryshme idenë e tyre në lidhje me dritën dhe pasqyrimin e saj.

Refleksion: Nëse do të mund të përdorje dritën dhe pasqyrimin e saj çfarë do të krijoje?

Shënim: Në varësi të kohës, prezantimi i projekteve mund të vazhdojë edhe një pjesë të orës në vijim.

Në një kohë të përshtatshme, nxënësve iu jepet mundësia të prezantojnë idetë e tyre për përdorimin e dritës dhe për pasqyrimin e saj.

Ora 8

Fusha: Shkencë	Lënda: Dituri natyre	Klasa 5	Data
Tema mësimore: Detyrë përmbledhëse / Test		Situata e të nxënit: Unë di.	
Rezultatet e të nxënit sipas temës: Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> – përshkruan kushtet që iu duhen kafshëve për të jetuar; – tregon me shembuj se çdo organizëm i gjallë rritet dhe riprodhohet; – zbulon se çdo organizëm i gjallë ka një cikël jetësor; – përshkruan ndryshimet në ciklin jetësor të një gjatari, amfibi, insekti dhe shpendi; – përshkruan procesin e avullimit, kthimin e lëngut në gaz; – përshkruan procesin e kondensimit, kthimin e gazit në lëng, si proces i kundërt i avullimit; – tregon se ajri përmban avuj uji, i cili kur bien në kontakt me sipërfaqe të ftohtë, kondensohet; – përcakton se uji vlon në 100°C dhe ngrin në 0°C; 		Fjalë kyçe: nevoja për të jetuar, riprodhim, fazat e ciklit jetësor, ngrirje, shkrirje, avullim, kondensim, vlim, avull, ujë, burim drite, rreze drite, pasqyrim	

<ul style="list-style-type: none"> – përshkruan dhe shpjegon qarkullimin e ujit në natyrë, duke dalluar faktorët që ndikojnë në të; – identifikon burimet e ndryshme të dritës; – shpjegon se ne i shohim objektet, pasi drita nga burimi vjen në syrin tonë; – tregon se drita pasi pasqyrohet, bie në syrin tonë dhe ne i shohim objektet; – tregon se pasqyrat kanë sipërfaqe të ndritshme; – shpjegon përdorimet e ndryshme të pasqyrave; – vizaton rrezen e rënies dhe rrezen e pasqyruar; – shpjegon se sipërfaqet e ashpra e përthithin dritën; – tregon se këndi i rënies së rrezeve të dritës është i barabartë me këndin e pasqyrimin; – tregon rrugën që përshkon rrezja rënëse nga burimi deri te syri ynë. 	
Burimet dhe mjetet: enciklopedi, fleta e detyrës përmbledhëse, lapsa, ngjyra	Lidhja me fushat e tjera: Gjuhë Shqipe, Matematikë, Arte
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Disa nxënës prezantojnë idetë e tyre të punuara në detyrat e shtëpisë. <i>Punë e pavarur:</i> Plotësimi i detyrave përmbledhëse. <i>Prezantim:</i> Vazhdohet me prezantimin e projekteve dhe ideve të reja të nxënësve.	
Vlerësimi: Vlerësohen për punimin e Detyrës përmbledhëse / Testit.	
Detyra:	Refleksion:
Shënim: Kjo orë mund të shfrytëzohet si testim ose si detyrë përmbledhëse e periudhës së parë. <ul style="list-style-type: none"> – Ora e mësimit mund të fillojë me zhvillimin e testit/detyrës përmbledhëse dhe më pas me prezantimet. 	

Kapitulli 6

Hijet

Ora 1

Fusha: Shkencë	Lënda: Dituri natyre	Klasa 5	Data
Tema mësimore: Drita përhapet në vijë të drejtë		Situata e të nxënit: Përhapja e dritës	
Rezultatet e të nxënit sipas temës: <ul style="list-style-type: none">identifikon se drita përhapet në vijë të drejtë;lidh provën me rezultatin e eksperimenteve;shpjegon arsyet e përhapjes së dritës në vijë të drejtë dhe të formimit të hijeve;dallon drejtimin e dritës dhe formimin e hijes.		Fjalë kyçe: të dhëna, përfundime, bllokoj, hije	
Burime dhe mjete: elektrik dore, tub kartoni, bateri, videoprojektor, lapsa me ngjyra etj.		Lidhja me fushat e tjera: Gjuhë shqipe, Arte, Fizikë, Edukim fizik	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Vëzhgim: <p>Në fillim vëzhgojmë videoprojektorin, të cilin e ndezim dhe shohim se si drita që del prej tij, përhapet në vijë të drejtë.</p> <p>Diskutojmë rreth asaj që vëzhguam në klasë. Nxënësit komentojnë atë që panë me dritën e projektorit, pra se si përhapet ajo në vijë të drejtë.</p> Veprimtari 1: <p>Ftohen nxënësit për të kryer eksperimentin me tubin e kartonit dhe elektrikun e dorës. Dy nxënës dalin para klasës. Nxënësi i parë mban elektrikun e dorës në njërën anë të tubit dhe tjetri, duke vendosur syrin në skajin tjetër të tubit, shikon se si drita kalon përmes tubit në anën tjetër. Eksperimentin e vëzhgojnë disa nxënës duke parë se si kalon drita përmes tubit.</p> Veprimtaria 2: <p>Përthyejmë tubin dhe nxënësit afrohen për të dalluar drejtimin e dritës. A ndodh e njëjta situatë si në rastin kur tubi i kartonit ishte në pozicion të drejtë? Po kur përthyerhet tubi, çfarë ndodh me dritën? Vëzhgojmë dhe diskutojmë. Arrihet në përfundimin se përthyerja nuk e lejon dritën të përhapet në vijë të drejtë.</p> Veprimtaria 3: <p>Me nxënësit dalim në oborrin e shkollës dhe shohim në natyrë se si pemët e oborrit të shkollës kanë formuar hijet. Vëzhgojmë dhe analizojmë me nxënësit pse ndodh kjo? Pas mendimeve e diskutimeve të ndryshme dalim në përfundimin se objektet e ngurta pengojnë dhe bllokojnë kalimin e dritës. Pra në këtë rast, nxënësit shikojnë hijet e pemëve, të cilat formohen nga bllokimi i rrezeve të dritës prej tyre. Kështu formohen hijet.</p> Lojë në grupe dyshe: Secila dyshe krijon dhe vizaton me lapsa me ngjyra hijen e shokut ose të shoqes.			

Ndërrohen rolet me shokun/shoqen. Ftohen nxënësit të flasin për hijet në vizatimet e tyre. Kthehen më pas në klasë dhe secili jep mendimin për veprimtarinë e kryer në oborrin e shkollës. Punimi i rubrikës “Mësuam se”	
Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për mendimin dhe argumentet gjatë veprimtarive dhe diskutimeve të bëra në klasë.	
Detyra: Punimi i faqes 43 në Fletoren e punës.	Refleksion: Si u ndjeve gjatë kryerjes së veprimtarisë?
Shënim:	

Ora 2

Fusha: Shkencë	Lënda: Dituri natyr	Klasa 5	Data
Tema mësimore: Cilat materiale lejojnë kalimin e dritës?		Situata e të nxënit: Hija	
Rezultatet e të nxënit sipas temës: Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> – shpjegon kalimin e dritës në materiale të ndryshme; – identifikon objektet që lejojnë dhe ato që nuk lejojnë kalimin e dritës sipas materialit – rendit nuancat e hijeve sipas shkallës së dhënë dhe i argumenton ato. 			Fjalë kyçe: i patejdukshëm, i tejdukshëm, gjysmë i tejdukshëm
Burimet dhe mjetet e punës: dritë e fortë, ekran, gjashtë ose më shumë objekte prej materialesh të ndryshme			Lidhja me fushat e tjera: Gjuhë shqipe, Fizikë
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Stuhi mendimesh: Renditen nga vetë nxënësit objekte të ndryshme për materialet e tejdukshme, të patejdukshme dhe gjysmë të tejdukshme. Nxënësit japin mendime për këto, duke i shoqëruar me sqarime të thjeshta. Veprimtari: Klasa ndahet në tri grupe të mëdha. Secili grup do të ketë mundësi të kryejë eksperimentin e caktuar. Grupi 1: Ka për detyrë të listojë objekte të patejdukshme dhe të japë shpjegimet përkatëse për këtë, p.sh.: (objekte, si: muri, dërrasa, pema, tulla etj.) Grupi 2: Ka për detyrë të listojë objekte të tejdukshme dhe të japë shpjegimet përkatëse për këtë, p.sh.: (objekte, si: xhami, gota, vizorja, uji etj.) Grupi 3: Ka për detyrë të listojë objekte gjysmë të tejdukshme dhe të japë shpjegimet përkatëse për këtë p.sh.: (objekte, si: xhami i syzeve, xhamat me ngjyrë, xhamat e akullit etj.) Duke kryer prova e duke demonstruar secili grup përdorimin e objekteve të përcaktuara për secilin, dalim në përfundim për të tre llojet e materialeve që nuk lejojnë, lejojnë dhe lejojnë pjesërisht kalimin e dritës. Pyetje-përgjigje mes grupeve për të treguar aftësitë perceptuese të secilit nxënës dhe grupi, për njohuritë e marra.			

Pas kësaj njihen me shkallën e nuancës së hijeve (material i përgatitur nga mësuesi për secilin grup).

Nxënësit sipas grupeve përkatëse hulumtojnë në shkallën e nuancave të hijeve vendin që zënë secili nga materialet e grupit.

Kjo situatë organizohet në formë konkursi, ku secili grup zgjedh një përfaqësues dhe argumenton saktë përgjigjet e tij.

Grupi 1 - trajton materialet e patejdukshme (nuancë e hijeve 5)

Grupi 2 - trajton materialet e tejdukshme (nuancë e hijeve 1)

Grupi 3 - trajton materialet gjysmë të tejdukshme (nuance 2,3,4)

Vlerësimi: Vlerësohen nxënësit/et se sa arrijnë të ndjekin udhëzimet e dhëna. U jepet ndihmë nxënësve që kanë vështirës gjatë punës. Vlerësohen përgjigjet e sakta, respektimi i mendimit të shokëve dhe angazhimi në punën në grup.

Detyra: Plotësimi i fletores së punës, faqja 44.

Refleksion: Pyeten nxënësit/nxënësit: “Çfarë gjëje të re mësuat nga puna në grupe?”

Shënim: Ju shpjegohet nxënësve së çfarë janë marionetat dhe si krijohen në kushte shtëpie. Sqarohen se këto marioneta do t’u duhen për orën e ardhshme në mësim.

Duke ruajtur grupet, nxënësit ftohen të zgjedhin një ngjarje të cilën do ta tregojnë sikur të japin një teatër me kukulla. Brenda grupeve, nxënësit caktojnë punën për të krijuar marionetat e grupit.

Ora 3 dhe 4

Fusha: Shkencë	Lënda: Dituri natyre	Klasa 5	Data
Tema mësimore: Siluetat dhe teatri i hijeve		Situata e të nxënit: Marioneta	
Tema mësimore: Siluetat dhe teatri i hijeve			
Rezultatet e të nxënit sipas temës: Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> – përshkruan mënyrën e formimit të siluetave; – rendit elementet që duhen për formimin e siluetës së një marionete; – shpjegon historikun e hijeve dhe diskuton rreth tyre; – krijon një histori me marioneta. 			Fjalë kyçe: siluetë, projekte, marionetë
Burime dhe mjete: karton, disa shkopinj, shirit ngjitës, burim drite i fuqishëm, ekran, gërrshërë			Lidhja me fushat e tjera: Gjuhë shqipe, Arte, Histori
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Bisedë: Diskutohet për hijet dhe si mund të shfaqen ato në murin e klasës. Nxënësit japin mendimet e veta për këtë dukuri. Ata nxiten që të krijojnë me duar figura të ndryshme, p.sh.: figura insektesh, shpendësh apo kafshësh të tjera. Shpjegohet mënyra se si formohen këto silueta, së pari, duke krijuar kushtet për vendosjen e burimit të dritës dhe të një sipërfaqeje të sheshtë (ekrani). Kjo situatë krijon në klasë një atmosferë argëtuese. Nxënësit nxiten të imitojnë zërat apo gjestet e kafshëve që kanë krijuar me duart e tyre. Ata emërtojnë me radhë siluetën e kafshës që krijon shoku ose shoqja dhe diskutojnë rreth saj.			

Veprimtari: Pas krijimit të siluetave të kafshëve, në klasë nis diskutimi rreth historikut të siluetave në Kinë apo në Indonezi, ku marionetat shërbenin për rrëfimin e ngjarjeve të jetës. Për këtë paraqesim me videoprojektor një material, i cili i referohet teatrit të hijeve në Indonezi. Pas paraqitjes së materialit bëhet një bisedë për kohën kur janë përdorur këto lloj teatrosh dhe se si i transmetonin njerëzit mesazhet për jetën, edhe pse shkrimi nuk ishte shpikur ende.

Loja (me role) me marioneta: Në orën e mëparshme, nxënësit janë porositur të krijojnë marioneta (duke iu shpjeguar se si mund t'i bëjnë ato në kushtet e shtëpisë). Secili nxënës ka përgatitur marionetën e vet, të cilën e ka mbështetur në një shkop. Përveç kësaj, ai ka përgatitur dhe rolin e tij në historinë e përzgjedhur nga nxënësit. Ndizet projektori dhe drita e tij i drejtohet këndit ku nxënësit do të luajnë me role historinë e zgjedhur. (Në klasë janë tri grupe që do të interpretojnë secili nga një histori.)

Në fund të lojës me role diskutohet për hijet (siluetat) që lëshuan marionetat dhe për rëndësinë e secilit element përbërës në këtë lojë.

Nxënësit japin mesazhin që përcjell pjesa e interpretuar nga vetë ata dhe bëjnë dallimin mes siluetës dhe marionetës. Në fund, nxënësit falënderohen për përkushtimin që treguan gjatë realizimit të kësaj detyre.

Punë me grupe: Vizatimi i siluetave të kafshëve të ndryshme.

Në fund paraqiten në klasë punimet e bëra dhe diskutohet rreth tyre.

Vlerësimi: Nxënësve u kërkohet të japin vlerësime për shokët që ishin më aktivë gjatë orës së mësimit dhe të japin vërejtjet e tyre, nëse ka diçka për t'u përmirësuar.

Detyra: Punimi i faqes 45 në *Fletoren e punës*.

Refleksion: Si u ndjeve gjatë veprimtarisë?

Shënim:

Ora 5

Fusha: Shkencë	Lënda: Dituri natyre	Klasa 5	Data
Tema mësimore: Ndryshimi i madhësisë së hijes		Situata e të nxënit: Formojmë hije	
Rezultatet e të nxënit sipas temës: Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> – rendit disa faktorë që ndikojnë në ndryshimin e madhësisë së hijes; – planifikon veprimtaritë, nëpërmjet së cilave mund të krijojë hije në largësi të ndryshme; – identifikon që madhësia e hijes ndryshon në varësi të vendndodhjes së objektit. 			Fjalë kyçe: vëndndodhje, faktor i kontrolluar
Burime dhe mjete: enciklopedi, ilustrim, burim drite, ekran, një marionetë kartoni, vizore me gjatësi 1 m ose metër shirit, shirit ngjitës, laps i zi			Lidhja me fushat e tjera: Gjuhë shqipe, Arte, Matematikë

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:

Bisedë: Ftoj nxënësit të diskutojnë rreth pyetjeve të mëposhtme:

Çfarë dini për hijet? Kur i shohim ato?

Nxënësit tregojnë disa burime drite. Diskutohet me ta pse nuk e shohim dot diellin me sy të lirë. Pasi jemi njohur me situatën e dhënë në libër, e realizojmë atë në klasë në mënyrë praktike. Tre nxënëse të klasës bëjnë shfaqje me marionetën e një krokodili prej kartoni. Secila nga vajzat ruan largësi të ndryshme të krokodilit prej kartoni nga ekrani. Nxënësit kuptojnë se, në rastin kur njëra nga vajzat ishte më afër ekranit, madhësia e hijes së krokodilit ishte më e vogël krahasuar atë të hijeve që formonin krokodilët e dy vajzave të tjera. Krokodili i vajzës së dytë që ishte pak më larg ekranit, e kishte madhësinë e hijes në ekran pak më të madhe se ajo e krokodilit që mbante vajza e parë dhe më të vogël se madhësia e hijes së krokodilit që mbante vajza e tretë. Pra madhësia e hijes së krokodilit që mbante vajza e tretë, ishte më e madhe se dy të parat. Nxënësit komentojnë dhe tregojnë se përse ndodh ky ndryshim i madhësisë së hijes, duke paraqitur si faktor vendndodhjen e objektit me ekranin.

Veprimtari:

Duhet të hetojmë madhësinë e hijes së një objekti dhe si ndryshon ajo në varësi të vendndodhjes së tij.

Për këtë kryejmë në klasë një veprimtari: Marrim një burim drite, një marionetë dhe largësinë e përcaktuar 3 m nga burimi i dritës. Ndërmjet kësaj largësie, herë e largojmë marionetën nga burimi i dritës dhe herë e afrojmë. Largësia mes burimit dhe ekranit quhet faktor i kontrolluar, meqenëse kemi vendosur largësinë 3 m.

Në dysheme kemi ngjitur shirit ngjites nga burimi i dritës tek ekrani dhe çdo 20 cm kemi shënuar nga një vijë.

Kur nxënësi lëviz marionetën, në çdo shirit që përkon me 20 cm vërejmë se silueta e saj zvogëlohet. Ndërkohë, ne matim çdo gjatësi të hijes në ekran për çdo 20 cm, duke e paraqitur atë në një grafik me shtylla. Diskutojmë rreth rezultateve të këtij grafiku, duke dhënë shpjegime argumentuese sipas matjeve të paraqitura në grafik. Nxënësit arrijnë në përfundimin se madhësia e hijes ndryshon në varësi të vendndodhjes së objektit.

Vlerësimi: Kërkohet nga nxënësit të punojnë në grupe dyshe dhe të përshkruajnë me radhë etapat e punës së kryer.

Detyra: Punimi i faqes 46 në *Fletoren e punës*.

Shënim:

Ora 6

Fusha: Shkencë	Lënda: Dituri natyre	Klasa 5	Data		
Tema mësimore: Hulumtimi i gjatësisë së hijes Ora e parë		Situata e të nxënit: Gjatësia e hijes			
Rezultatet e të nxënit sipas temës: Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">– vëzhgon hijen në orë të ndryshme të ditës;– kryen eksperimente dhe i analizon ato;– shpjegon se hijet ndryshojnë gjatësinë dhe pozicionin e tyre.		Fjalë kyçe: orë diellore, mesditë.			
Burime dhe mjete: enciklopedi, ditë me diell, shufër 20 cm e gjatë, një fletë letre e bardhë, pak plastelinë, katër gurë, vizore stilolaps		Lidhja me fushat e tjera: Gjuhë shqipe, Arte, Matematikë			
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Bashkëbisedim: U kërkohet nxënësve të thonë ç’dinë për hijet dhe kur janë më të plota ato. Cilat quhen burime drite? Njihen nxënësit me temën mësimore dhe se si do të hulumtojnë gjatësinë e hijes në orë të ndryshme. Për këtë, klasa duhet të ndahet në grupe, ku secili të kryejë një detyrë. Një grup do të merret me vendosjen e mjeteve në vendin e përzgjedhur, ku ka shumë ndriçim. Nxënësit do të shtrojnë fletën e letrës, e cila fiksohet me gurë ose me plastelinë, që të mos lëvizë. Grupi tjetër shënon çfarë vëzhgon dhe orën e matjes së hijes. Gjithashtu, shënon me kujdes në letër pikën që tregon fundin e hijes dhe orën e matjes. Hetim: Një grup tjetër i nxënësve do të dalë jashtë të matë hijen dhe orën e matjes së saj. Çdo orë, grupi del jashtë dhe mat hijen e shënon orën. Për këtë vrojtohet pozicioni i diellit dhe bëhet kontrolli, duke krahasuar rezultatet e çdo ore. Diskutohet rreth hulumtimeve dhe rezultateve të matjeve në çdo orë. Grupi i mbajtjes së të dhënave jep rezultatet e mbledhura. Nxënësit bashkojnë me stilolaps pikat në fundin e secilës hije në vendin ku është fiksuar shufra. Formohet kështu hija e vijës; matet gjatësia e çdo vije. Të dhënat hidhen në një tabelë, ku nxënësit e kanë të qartë se si ndryshojnë ato në orë të ndryshme të ditës. Rezultatet e hulumtimit të gjatësisë së hijes në orë të ndryshme të ditës janë paraqitur në tabelë.					
Koha në orë	10:00	11:00	12:00	13:00	14:00
Gjatësia e hijes (në cm)	90	45	25	50	85
Jepet detyrë që të vazhdojnë matjet gjatë javës sipas grafikut të paraqitur. Këto të dhëna do ti diskutojmë në orën tjetër.					
Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për punën, përkushtimin, bashkëpunimin në grup e seriozitetin në matje dhe në nxjerrjen e rezultateve.					
Detyra: Punimi i faqes 47 në <i>Fletoren e punës</i> .					
Shënim: Për një model grafiku referoju atij të paraqitur në faqen 108 të tekstit mësimor.					

Ora 7

Fusha: Shkencë	Lënda: Dituri natyre	Klasa 5	Data
Tema mësimore: Hulumtimi i gjatësisë së hijes ora e dytë		Situata e të nxënit: Gjatësia e hijes	
Rezultatet e të nxënit sipas temës: Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> vëzhgon hijen në orë të ndryshme të ditës; kryen eksperimente dhe i analizon ato; shpjegon se hijet ndryshojnë gjatësinë dhe pozicionin e tyre. 			Fjalë kyçe: orë diellore, mesditë.
Burime dhe mjete: enciklopedi, ditë me diell, shufër 20 cm e gjatë, një fletë letre e bardhë, pak plasteline, katër gurë, vizore stilolaps.			Lidhja me fushat e tjera: Gjuhë shqipe, Arte, Matematikë
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Bashkëbisedim: Kërkojmë nga nxënësit të thonë ç'dinë për hijet dhe kur ato janë më të plota? Cilat janë burime drite? Njohja me temën dhe se si ne do të hulumtojmë gjatësinë e hijes në orë të ndryshme. Për këtë na duhet të ndajmë klasën në grupe ku secili të kryej një detyrë. Një grup do të merret me vendosjen e mjeteve në vendin e përzgjedhur ku ka shumë ndriçim. Ata do të shtrojnë fletën e letrës e cila fiksohet nga gurët që të mos lëvizte apo me plastelinë. Grupi tjetër merret me shënimet dhe orën e matjes së hijes. Shënojnë me kujdes në të pikën që tregon fundin e hijes dhe orën e matjes. Hetim: Një grup tjetër i nxënësve do të dalë jashtë të matë hijen dhe orën e matjes së saj. Çdo orë, grupi del jashtë dhe matë hijen e orës. Për këtë vrojtohet pozicioni i diellit pasi heqim shufrën dhe letrën, bëjmë kontrollin dhe krahasojmë rezultatet e çdo ore. Diskutim rreth hulumtimeve e rezultateve të matjeve në çdo orë. Grupi i mbajtjes së të dhënave jep rezultatet e mbledhura. Bashkojmë me stilolaps pikat në fundin e secilës hije, në vendin ku është fiksuar shufra. U formua hija e vijës dhe matim gjatësinë e çdo vije. Të dhënat i hedhim në një tabelë, ku nxënësit e kanë të qartë se si ndryshon ajo në orë të ndryshme të ditës. Hulumtim: Duke analizuar të dhënat nxjerrim konkluzionet përkatëse për gjatësinë, kohën dhe matjen. Gjatësia e hijes është më e madhe në mëngjes dhe në darkë. Kur dielli ishte afër horizontit, hija ishte më e gjatë apo më e shkurtër? Po kur dielli është lart në qiell, si është hija? Nxënësit japin mendime duke iu referuar të dhënave të tabelës.			
Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për punën, përkushtimin, bashkëpunimin në grup e seriozitetin në matjen dhe në nxjerrjen e rezultateve.			
Detyra: Punimi i faqes 47 në <i>Fletoren e punës</i>			
Shënim: Për modelin e grafikut referoju atij të paraqitur në faqen 108 të librit të nxënësit.			

Ora 8

Fusha: Shkencë	Lënda: Dituri natyre	Klasa 5	Data
Tema mësimore: Intensiteti i dritës		Situata e të nxënit: Cili jep intensitetin më të madh?	
Rezultatet e të nxënit sipas temës: Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> – shpjegon çfarë është intensiteti i dritës; – tregon se ku dhe me se matet intensiteti i dritës; – identifikon matjet në vende të ndryshme dhe i krahason ato; – argumenton e flet për intensitetin e dritës së burimeve të ndryshme. 			Fjalë kyçe: intensiteti i dritës, matje
Burime dhe mjete: matës drite, qiri, një llambë e zakonshme, një llambë LED, libër dhe shirit matës			Lidhja me fushat e tjera: Gjuhë shqipe, Fizikë, Matematikë
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Pyetje-përgjigje:</i> A keni informacion me çfarë e matim intensitetin e dritës? Pak histori: Qiriri ishte dikur njësia që përdorej për matjen e intensitetit të dritës. Sot gjërat kanë ndryshuar dhe pajisja që shërben për të matur intensitetin e dritës është një aparat digjital. <i>Veprimtaria 1:</i> Si mund ta matim intensitetin e dritës në ambiente të ndryshme? Për këtë duhet të kemi një matës (aparat digjital), të cilin mund ta përdorim për të kryer matje në diell, në hije, në klasë apo në dollap. Për këtë veprimtari aktivizohen nxënës në grupe dyshe, të cilët do të matin intensitetin e dritës në secilin nga ambientet e sipërpërmendura. Secili nxënës mban shënim matjet që i paraqiten në matës (aparatin digjital). Nxënësit e tjerë vëzhgojnë punën e secilit grup, bëjnë analizën e matjeve dhe nxjerrin përfundimet e tyre. <i>Veprimtaria 2:</i> <i>Hapi 1:</i> Paraqes grafikun për qiriun, llambën e zakonshme dhe llambën LED. Diskutoj me nxënësit paraprakisht, pra pa bërë provën, për të marrë parashikimet e tyre për matjet që do të bëjnë në secilin rast. <i>Hapi 2:</i> Bëjmë matjen për secilin nga burimet: për qiriun, llambën e zakonshme dhe llambën LED. Për këtë matim sa larg secilit burim drite arrijmë të shikojmë aq sa të lexojmë një libër. <i>Hapi 3:</i> Matjet e sakta i krahasojmë me ato të parashikuara nga nxënësit. Secili nga nxënësit jep mendimin dhe shpjegimin e vet në lidhje me matjet e bëra. <i>Veprimtaria 3:</i> <i>Nevoja për të matur intensitetin e dritës</i> Nxënësit shikojnë disa fotografi, të cilat tregojnë përdorimin e dritës në ambiente të ndryshme, ku janë të pranishëm njerëz apo produktet ushqimore. Në secilën prej këtyre fotografive, intensiteti i dritës është shumë i nevojshëm të jetë në parametrat e duhur, meqenëse ka të bëjë me shëndetin e njeriut. Dëgjoj mendime dhe diskutime nga vetë nxënësit.			
Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për punën, bashkëpunimin dhe diskutimin e tyre në lidhje me krahasimin e të dhënave që morën nga matjet.			
Detyra: Punimi i faqes 48 në <i>Fletoren e punës</i> .			
Shënim:			

Ora 9

Fusha: Shkencë	Lënda: Dituri natyre	Klasa 5	Data
Tema mësimore: Idetë e shkencëtarëve mbi dritën		Situata e të nxënit: Ylberi	
Rezultatet e të nxënit sipas temës: Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">– shpjegon përthyerjen e dritës;– përshkruan idetë e shkencëtarëve për formimin e ylberit;– rendit fakte e të dhëna si formohet ylberi.		Fjalë kyçe: prizëm qelqi, përthyerje e dritës	
Burime dhe mjete: enciklopedi, zorrë vaditëse e pajisur me spërkatës, disa gota me ujë.		Lidhja me fushat e tjera: Gjuhë shqipe, Fizikë, Matematikë, Arte, Histori	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Brainstorming: U drejtoj pyetje nxënësve: Ç’dini për ylberin? Kur formohet ai? Çfarë e bën të veçantë këtë dukuri për syrin tonë ? Ku shfaqet ylberi? Keni vënë re se kur lagni me spërkatës oborrrin në ditë me diell, formohen disa ylbere të vogla. Edhe kur bie shi dhe dielli ndriçon, mund ta shohim përsëri ylberin. Stina e pranverës është ajo që na ofron këtë dukuri natyrore. Këto mendime duhet të dalin nga vetë nxënësit. Veprimtari: Si mund t’i shohim ylberet e vogla? Mbi tavolinë, pranë dritares ku hyn drita e diellit, vendosim në rresht gotat me ujë. Rrezet duke kaluar përmes ujit, krijojnë ylbere të vogla në anën tjetër të gotave. Ato mund të shfaqen edhe në mur ose mbi dysheme, në varësi të pozicionit të drejtimit të rrezeve. Lexim i drejtuar: Lexohet informacioni i dhënë në libër nga shkencëtarët për ylberin. Nxënësve iu lihet koha e mjaftueshme për të perceptuar informacionin. Diskutim me pyetje-përgjigje nga vetë nxënësit. Orientoj me disa pyetje: Si mendoi Aristoteli për ylberin ? Po shkencëtari arab Ibn-al-Haytham, çfarë idesh dha për ylberin dhe shëmbëllimin? Po shkencëtari kinez, cilën ide mbrojti për ylberin? Kush dha rreth 300 vjet më parë, shpjegimin më të saktë për krijimin e ylberit? Së bashku me nxënësit arrijmë në përfundimin se, sytë tanë nuk i dallojnë të ndara ngjyrat. Rrezja e dritës kur kalon nga një lëndë në një lëndë tjetër, ndryshon drejtimin e përhapjes. Kjo quhet përthyerje e dritës. Pyetje-përgjigje: Si ndryshon këndi i përthyerjes? Çfarë përdori Njutoni për të treguar që drita e bardhë është përzierje ngjyrash? Një nxënës/e tregon se çfarë përdori dhe si veproi ai. Në fund arrihet në përfundimin se, drita shpërbëhej në ngjyra të ndryshme kur dilte nga prizmi i qelqit. Ngjyrat janë: e kuqe, portokalli, e verdhë, e gjelbër, e kaltër, blu dhe vjollcë. Kur këto rreze drite kalojnë përmes pikave të shiut, formojnë ylberin. Nga zbërthehet drita e bardhë, po drita e kuqe? Nxënësit diskutojnë me njëri-tjetrin. Secili jep alternativën e tij/saj dhe shpjegon arsyet.			
Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për bashkëpunimin, shpjegimin, vëmendjen dhe angazhimin në orën e mësimi.			
Detyra: Punimi i faqes 49 në Fletoren e punës.		Refleksion: Kur ylberi shfaqet në qiell, të jep një ndjesi të veçantë.	
Shënim:			

Ora 10

Fusha: Shkencë	Lënda: Dituri natyre	Klasa 5	Data
Tema mësimore: Projekt “Idetë e shkencëtarëve mbi dritën” (ora e parë)		Situata e të nxënit: Rëndësia e dritës	
Rezultatet e të nxënit sipas temës: Nxënësi/ja: – kupton rëndësinë e dritës; – identifikon rrezet e dritës dhe formimin e ylberit; – e vlerëson ylberin si një dukuri të veçantë natyrore.			Fjalë kyçe: projekt
Burime dhe mjete: enciklopedi, internet, poster, lapsa me ngjyra			Lidhja me fushat e tjera: Gjuhë shqipe, Fizikë, Matematikë, Arte, Histori
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Bisedë: Çfarë është drita e diellit ? Kur këto drita përzihen së bashku, çfarë formojnë? Si është konsideruar shumë kohë më parë ylberi nga njerëzit ? Nga se formohet drita e diellit? Sa është këndi i harkut të ylberit dhe si reflektohet ai? A mund ta prekim një ylber kur ndodhemi shumë lart? Paraqiten fotografi të ndryshme të ylberit. Udhëzohen nxënësit për grumbullimin e informacionit : A vlejnë këto njohuri në jetë? Pse janë të rëndësishme? Këto pyetje e të tjera si këto shkruhen në dërrasën e zezë, ndërkohë që diskutimi në klasë vazhdon. Theksohet se në këtë projekt, një pjesë shumë e rëndësishme është prezantimi i tij. Analizohen përfundimet dhe qëndrimet e nxënësve që kanë realizuar projektin. Ndahen në grupe dhe bëjnë ndarjen e detyrave, duke u orientuar nga pyetjet e shkruara më sipër. <i>Lapsat në mes:</i> Nxënësit me radhë tregojnë mendimet dhe idetë për organizimin e punës në grupe. Ndahen në role dhe përcaktojnë detyrat. Prezantimi i projektit do të bëhet në orën e vazhdim.			
Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për mendimin, komunikimin në ndarjen e detyrave, bashkëpunimin, mendimet dhe idetë e dhëna.			
Detyra: Organizimi i informacioneve të projektit.			
Shënim:			

Ora 11

Fusha: Shkencë	Lënda: Dituri natyre	Klasa 5	Data
Tema mësimore: Projekt “Idetë e shkencëtarëve mbi dritën” (ora e dytë)		Situata e të nxënit: Rëndësia e dritës në jetën tonë	
Rezultatet e të nxënit sipas temës: Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> – shpjegon rëndësinë e dritës në jetën e gjallesave; – punon në grup për projektin me temë: “Idetë e shkencëtarëve mbi dritën” 			Fjalë kyçe: projekt
Burime dhe mjete: enciklopedi, internet, poster, lapsa me ngjyra, videoprojektor			Lidhja me fushat e tjera: Gjuhë shqipe, Fizikë, Matematikë, Arte, Histori
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Përgatitja për prezantim: Në 15 minutat e para, nxënësit mbledhin materialet e grumbulluara dhe i organizojnë për prezantim. Theksohet se një pjesë e rëndësishme e projektit është prezantimi i të dhënave, analizimi i tyre, paraqitja e qëndrimeve nga vetë realizuesit e projektit. Prezantimi i projektit: Përfaqësuesit e secilit grup prezantojnë projektet e tyre. Pas prezantimeve, nxënësve ndjekin një film të shkurtër në videoprojektor, ku tregohet rëndësia e dritës për jetën.			
Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për projektin që kanë realizuar, si dhe për punën që ka bërë secili. Nxënësit vlerësojnë njëri-tjetrin për kontributin dhe bashkëpunimin për realizimin e projektit.			
Detyra: Të gjejnë sa më shumë informacione për rëndësinë e dritës në jetën në Tokë.			
Shënim:			

Ora 12

Fusha: Shkencë	Lënda: Dituri natyre	Klasa 5	Data
Tema mësimore: Kontrolloni përparimin tuaj		Situata e të nxënësve: Unë di...	
Rezultatet e të nxënësve sipas temës: Nxënësi/ja: – analizon dhe plotëson njohuritë që ka marrë gjatë kryerjes së veprimtarive; – argumenton dhe i plotëson njohuritë sipas aftësive të fituara.			Fjalë kyçe: hije e gjatë, hije e shkurtër, burim drite, hije, marionetë
Burime dhe mjete: enciklopedi, fleta e detyrës përmbledhëse, informacione të mbledhura			Lidhja me fushat e tjera: Gjuhë shqipe, Fizikë, Matematikë, Arte, Histori
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Në fillim iu drejtoj nxënësve disa pyetje rreth njohurive që kanë marrë. Pse portretet e realizuara në fletë kartoni të zi u quajtën “siluetë”? Ata japin mendime, diskutojnë me njëri-tjetrin. Veprimtari: Krijimi i disa figurave në mur nëpërmjet duarve. Disa nxënës krijojnë figurat, disa të tjerë i emërtojnë ato. Ata iu përgjigjen pyetjeve të tilla si: Kur është hija më e gjatë? Po më e shkurtër? Si quhet matësi i intensitetit të dritës? Diskutohet në klasë rreth këtyre pyetjeve, ku nxënësit përfshihen në temat mësimore. Punë e pavarur: Nxënësit plotësojnë në dyshe rubrikat e dhëna në faqen e planifikuar për t’u punuar. Prezantojnë punën që kanë realizuar pas përfundimit të çdo rubrike. Diskutojnë rreth situatave më interesante për këtë grup temash. Secili argumenton përgjigjet e veta.			
Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për punimin e rubrikave të librit, argumentimin e mendimeve dhe të qëndrimeve që mbajnë.			
Detyra: Punimi i faqes 50 në <i>Fletoren e punës</i> .			
Shënim:			

Kapitulli 7

Toka dhe hapësira

Ora 1

Fusha: Shkencë	Lënda: Dituri natyre	Klasa 5	Data
Tema mësimore: Dielli, Toka dhe Hëna		Situata e të nxënit: Çfarë di?	
Rezultatet e të nxënit sipas temës: <ul style="list-style-type: none"> identifikon dhe përshkruan studimet mes Hënës dhe Diellit; shpjegon lëvizjet Tokë, Hënë dhe Diell; argumenton lëvizjen e Tokës rreth Diellit. 			Fjalë kyçe: anije kozmike, planet, yll, satelit natyror, orbitë
Burimet dhe mjetet: enciklopedi, dy topa me madhësi të ndryshme (futbolli, tenisi), një gogël ose rruezë			Lidhja me fushat e tjera: Gjuhë shqipe, Arte, Fizikë
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: DDM (Di, Dua të di, Mësova): Lexohet informacioni dhe nxënësit shkruajnë në fletore pyetjet që dalin gjatë leximit të tekstit për Tokën, Diellin dhe Hënë. <i>Lexim dhe diskutim</i> mbi informacionin dhe lidhjen ndërmjet tyre. Çfarë është Toka? Po Hëna? Si funksionon lidhja mes tyre? Çfarë është Dielli? Përreth kujt lëviz Toka? Po Hëna? Bëhen pyetje dhe diskutohet duke shpjeguar të gjitha paqartësitë. Përfshihen të gjithë nxënësit në diskutime e në argumente, duke sqaruar konceptet dhe lidhjet mes tyre. Për të kuptuar më mirë temën, përdorim një veprimtari. Veprimtari: Për këtë veprimtari mbështetemi në figurën e dhënë në libër. Sipas figurës së paraqitur caktohen nxënësit që do të merren me këtë veprimtari. Një nxënës do të mbajë në dorë topin e futbollit, që përfaqëson Diellin, një nxënës tjetër mban topin e tenisit, që përfaqëson Tokën, dhe nxënësi i tretë mban rruezën ose goglën, e cila përfaqëson Hënë. Hapi 1: Nxënësi që ka topin e futbollit, qëndron në mes të një sipërfaqeje të rrafshët dhe nuk lëviz. Nxënësi me topin e tenisit “lëviz” ngadalë, sipas një trajektoreje ovale rreth “Diellit”. Kjo trajektore përfaqëson orbitën e Tokës rreth Diellit. Hapi 2: Nxënësi që ka “Hënë”, lëviz me shpejtësi sipas një trajektoreje ovale përreth “Tokës”. Në këtë rast, trajektorja përfaqëson orbitën e Hënës rreth Tokës. Diskutim: Vëzhgojmë lëvizjet e secilit nxënës dhe rrjedhimisht edhe lëvizjen e objekteve që ata kanë, të cilat përfaqësojnë Tokën, Diellin dhe Hënë. Bëj pyetjet: Ç’është orbita? Çfarë forme ka ajo? Si lëviz Toka rreth Diellit? Nga ndryshon një yll nga një planet? A ju ndihmoi veprimtaria për t’iu dhënë përgjigje pyetjeve të mësipërme? Mësova se: Hëna është një satelit natyror i Tokës, Dielli është një yll. Toka është planet. Toka rrotullohet rreth Diellit sipas një orbite. Hëna rrotullohet rreth Tokës sipas një orbite.			
Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për mendimet, shpjegimet dhe gjetjet gjatë veprimtarive e diskutimeve.			
Detyra: Punimi i faqes 51 në <i>Fletoren e punës</i> .			
Shënim:			

Ora 2

Fusha: Shkencë	Lënda: Dituri natyre	Klasa 5	Data
Tema mësimore: A lëviz Dielli?		Situata e të nxënit: Sa është ora?	
Rezultatet e të nxënit sipas temës: Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">– vrojton rrezet e diellit gjatë orëve të ndryshme të ditës;– shpjegon se është Toka ajo që rrotullohet dhe jo Dielli;– kryen veprimtari dhe nxjerr përfundime.		Fjalë kyçe: duket sikur	
Burimet dhe mjetet: enciklopedi, njohuritë e mësuara, letër ngjitëse, ditë me diell		Lidhja me fushat e tjera: Gjuhë shqipe, Arte, Fizikë	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <p>Përvijim i të menduarit: Ftohen nxënësit të vëzhgojnë fotografitë. Japin mendime dhe komentojnë figurat. Pasi të shikojnë me vëmendje figurat, ata duhet t’u përgjigjen këtyre pyetjeve: Si mendoni, sa është ora në figurën e parë? Çfarë tregon kjo? Po figura e dytë, çfarë tregon? Është natë apo ditë? Pse? Nxënësit fillojnë të japin shpjegimet e tyre për situatat e ilustruara në libër. Jepen argumentet duke i detajuar ato. Më pas, njëri prej tyre shkruan në dërrasën e zezë orën kur zgjohet dhe veprimet që bën.</p> <p>Lexim i drejtuar: Lexohet veprimtaria në heshtje dhe sigurojmë materialet që duhen për realizimin e saj. Pas leximit të materialit të dhënë nis diskutimi rreth tij.</p> <p>Hulumtim: Për të parë si dhe ku shkojnë rrezet e diellit, vendosim çdo orë një letër ngjitëse, për të përcaktuar kështu vendin ku bien rrezet e diellit. Mbi secilën letër shënohet ora. Për këtë ngarkohen katër grupe me nga 2 nxënës që ta kryejnë këtë detyrë. Në fund të ditës shohim se ato janë zhvendosur nga ora në orë. Hedh pyetjen për diskutim: A zhvendosen rrezet e diellit? Për këtë flasim e diskutojmë së bashku. Dëgjoj mendimet e nxënësve dhe argumentimet e tyre në lidhje me atë që zbuluan nga hulumtimi që realizuan.</p> <p>Përfundim: Nga ora në orë, vëmë re që rrezet e diellit zhvendosen.</p> <p>U drejtoj këto pyetje nxënësve: Kush lëviz? Dielli duket sikur lëviz. Për këtë kryejmë një veprimtari.</p> <p>Veprimtari: Vendosim llambën mbi tavolinë dhe e ndezim. Në këtë rast ajo përfaqëson Diellin që shndrit. Një grup fëmijësh vendosen në rreth duke i kthyer kurvizin njëri-tjetrit. Rrethi që kemi formuar përfaqëson Tokën. Ashtu siç janë, fëmijët lëvizin ngadalë, në mënyrë që secili të gjendet përballë Diellit gjatë kohës së rrotullimit të tyre. Rrotullohen deri sa të mbërrijnë në pikën ku u nisën. Gjatë lojës së improvizuar ata thonë: 1- Dielli është në të majtën time. 2- Unë s’e shoh fare Diellin. 3- Dielli është në të djathtën time. 4- Unë jam përballë Diellit.</p> <p>Duke dëgjuar këto, nxënësit diskutojnë dhe dalin në përfundimin që nuk është Dielli ai që lëviz. Ne u rrotulloam rreth llambës dhe i kaluam të gjitha momentet që nxënësit treguan gjatë rrotullimit të tyre. Diskutim, ide, sugjerime, të cilat mbështesin idenë se Toka rrotullohet rreth Diellit. Kur në gjysmën e planetit është ditë, në gjysmën tjetër është natë.</p> <p>Përfundime: Nxënësit shkruajnë në fletore përgjigjet e pyetjeve që ndodhen në rubrikën përkatëse të librit. Më pas diskutohen së bashku përgjigjet e dhëna.</p>			
Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për gjetjet, mendimet dhe përfshirjen në diskutime.			
Detyra: Punimi i faqes 52 në Fletoren e punës.			
Shënim: Nxënësit nxiten që, në varësi të mundësive, të kërkojnë materiale mbi Tokën, Diellin dhe Hënën, në enciklopedi të ndryshme, libra dhe internet.			

Ora 3

Fusha: Shkencë	Lënda: Dituri natyre	Klasa 5	Data
Tema mësimore: Toka rrotullohet rreth boshtit të saj		Situata e të nxënësve: Luajmë “dita dhe nata”	
Rezultatet e të nxënësve sipas temës: Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> – tregon çfarë është globi, Toka; – srgumenton rrotullimin e Tokës rreth boshtit të saj, me drejtim perëndim-lindje; – shpjegon formimin e ditës dhe të natës. 			Fjalë kyçe: glob, rrotullohet, bosht, rrotullim
Burimet dhe mjetet: njohuritë e nxënësve, glob, shirit ngjitës dhe elektrik dore			Lidhja me fushat e tjera: Gjuhë shqipe, Gjeografi, Arte
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Përvijimi i të menduarit: Kërkohet nga nxënësit të tregojnë si e ndryshojnë vendndodhjen rrezet e diellit nga ora në orë, te xhami i dritares së klasës. Nxënësit japin mendime dhe flasin rreth tyre. Ata kujtojnë dhe diskutojnë edhe për veprimtarinë që kryen në mësimet e mëparshme, atë me topin e futbollit, që përfaqësonte Diellin dhe lëvizjen e topit të tenisit rreth tij, i cili përfaqësonte Tokën. Nxënësve u drejtohet pyetja: Cili është modeli i Tokës? Ftohen nxënësit të lexojnë materialin dhe të shohin figurat për Tokën. Pas leximit, bëhen pyetje për atë çka lexuan: Cili është modeli i Tokës ? Nga cili pol kalon boshti ? Në cilin drejtim rrotullohet Toka? Sa orë zgjat rrotullimi i Tokës rreth boshtit të saj? Të gjitha këto pyetje iu drejtohen nxënësve për të perceptuar sa më mirë këtë informacion. Hulumtim: Gjejmë Shqipërinë në glob, vendosim një shenjë mbi të. Tani rrotullojmë globin rreth boshtit dhe shohim që bashkë me të rrotullohet edhe Shqipëria. Kjo lëvizje ndodh gjatë gjithë kohës, por ne nuk e vëmë re. Përfytyroni sikur jeni në një makinë që lëviz me 100 km në orë. Përfundime: Toka rrotullohet rreth boshtit të saj me një shpejtësi të paktën 10 herë më të madhe se ajo e makinës. Veprimtari: Shembull që tregon formimin e ditës dhe të natës. Hapi 1: Një nxënës mban në dorë një elektrik që përfaqëson Diellin. Kurse nxënësi tjetër mban në dorë globin, i cili përfaqëson Tokën. Këtu nxënësit nxiten të diskutojnë rreth këtyre pyetjeve: Çfarë shikoni? Si është globi në pjesën që ndriçon elektriku i dorës? Nxënësit tregojnë se pjesa që ndriçon elektriku përfaqëson ditën. Hapi 2: Nxënësi/ja rrotullon globin nga perëndimi në lindje, në drejtim të kundërt me akrepat e orës. Cila pjesë e “Tokës” është e ndriçuar? Diskutime, sugjerime, mendime, argumente rreth pyetjes: A ndriçohet e gjithë “Toka” njëkohësisht? Hapi 3: Vendosim mbi “Tokë” një shirit ngjitës. Ndriçohet “Toka” me elektrikun e dorës nga një nxënës. Nxënësi rrotullon “Tokën” dhe vrojton shiritin ngjitës. Hidhet pyetja për diskutim: A ndriçohet gjatë gjithë kohës shiriti nga elektriku i dorës? Japin mendimet e tyre për këtë veprimtari. Lojë me nxënësit: Ndërkohë që “Toka” rrotullohet, thoni “ditë” kur elektriku i dorës ndriçon shiritin, dhe “natë”, kur nuk e ndriçon atë. Përmes lojës mësojmë se Toka nuk mund të ndriçohet e gjitha në të njëjtën kohë. Në njëren pjesë të saj është ditë, në pjesën tjetër është natë. Nxënësit argumentojnë mendimet e tyre rreth kësaj.			
Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për gjetjet, mendimet dhe bashkëpunimin në veprimtari e lojëra.			
Detyra: Punimi i faqes 53 në <i>Fletoren e punës</i> .			
Shënim:			

Ora 4

Fusha: Shkencë	Lënda: Dituri natyre	Klasa 5	Data
Tema mësimore: Lindja dhe perëndimi i diellit		Situata e të nxënit: Toka dhe Dielli	
Rezultatet e të nxënit sipas temës: Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> – tregon çfarë është horizonti; – shpjegon lindjen dhe perëndimin e diellit; – krahason gjatësinë e ditës brenda muajit dhe mes muajve e stinëve. 			Fjalë kyçe: horizont, lindja e diellit, perëndimi i diellit
Burime dhe mjete: enciklopedi, laps, stilolaps, grafikë të gatshëm			Lidhja me fushat e tjera: Gjuhë shqipe, Gjeografi, Arte
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Pyetje-përgjigje: Ftohen nxënësit të tregojnë çfarë kanë mësuar për Tokën. Në dërrasën e zezë shkruhet gjithçka që përmendet nga nxënësit. Toka, çfarë është? Ku jetojmë ne? Kush e ngroh Tokën? Çfarë jeton tjetër në Tokë? Hedh në diskutim pyetjet: Kur lind dielli? Kur zbardh dita? Çfarë shohim në horizont në mëngjes? A na duket sikur formohet një vijë? Nxënësit nxiten me pyetjen: Më trego rrugën që bën Dielli nga lindja në perëndim? Për këtë aktivizoj disa nxënës që përshkruajnë rrugën nga lindja në perëndim. Si quhet ndryshe kur lind Dielli? Po kur perëndon? Lexim i drejtuar: Nxënësit lexojnë në heshtje materialin mësimor dhe më pas fillojnë diskutimin rreth tij. Nxënësit i drejtojnë pyetje shokut ose shoqes së bankës për të shpjeguar materialin e lexuar. Disa nga pyetjet mund të jenë: Cili lëviz, Dielli apo Toka? Sa orë zgjat rrotullimi i plotë i Tokës? Për aq sa ne kemi mësuar: A lind dhe perëndon Dielli çdo ditë? Hulumtim: Ndahet klasa në grupe me nga 5 nxënës. I përcaktohet periudha e kohës secilit grup. I jepen pyetjet që do të kontrollojnë këto të dhëna përmes një grafiku. Lindja dhe perëndimi i diellit Gjatësia e ditës Gjatësia e ditës nga njëra ditë në tjetrën Gjejmë ndryshesën mes tyre Grupi 1: Krahason periudhën 1 prill deri në 5 prill. Grupi 2: Krahason periudhën 4 prill deri në 7 prill. Grupi 3: Krahason periudhën 14 maj deri në 17 maj. Grupi 4: Krahason periudhën 16 maj deri në 20 maj. Secili grup punon në heshtje për 10 minuta. Përfundime: Paraqiten të dhënat e ndryshimit të orës për secilin grup përmes grafikut. Nxënësit argumentojnë zgjatjen e ditës edhe me ardhjen e stinës së pranverës. Tregohet se stina e pranverës është stinë, në të cilën gjatësia e ditës rritet nga dita në ditë. Punim dhe diskutim plotësim i rubrikës “Pyetje dhe detyra”. Shpjegim e diskutim rreth këtij plotësimi. Nxënësve u jepet detyrë që të mbledhin të dhëna për kohën e lindjes dhe të perëndimit të diellit për një javë.			
Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për mendimet, bashkëpunimin dhe punën në grupe.			
Detyra: Punimi i faqes 54 të fletores së punës.			
Shënim:			

Ora 5

Fusha: Shkencë	Lënda: Dituri natyre	Klasa 5	Data
Tema mësimore: Toka rrotullohet rreth Diellit Ora e parë		Situata e të nxënit: Çfarë ndodh gjatë një viti?	
Rezultatet e të nxënit sipas temës: Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">– parashtron pyetje që nxitin debat për temën.– kryen hetime e nxjerr rezultate;– përdor e zbaton në mënyrë efektive informacionin.		Fjalë kyçe: vit, rrotullim, hemisferë	
Burime dhe mjete: njohuritë e nxënësve, enciklopedi, fotografi, material nga interneti, sistemi diellor, globi, videoprojektor		Lidhja me fushat e tjera: Gjuhë shqipe, Gjeografi, Arte, Fizikë	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Harta semantike: Shkruhet në dërrasën e zezë “Toka dhe Dielli” e më pas nxiten nxënësit të tregojnë çfarë dinë ata në lidhje me: Çfarë ndodh gjatë vitit në familjen tuaj? Çfarë bën planeti ynë gjatë një viti? Në këtë mënyrë përforcohen njohuritë për lidhjen mes Tokës dhe Diellit dhe për dallimin mes tyre. Toka rrotullohet sipas një orbite në formë ovale. Rrotullimi i plotë i Tokës rreth Diellit zgjat 365 e ¼ e ditës ose 1 vit. Këtë mund ta paraqesim përmes një filmi me videoprojektor, ku nxënësit të dallojnë këtë fenomen. Veprimtari: Punë me grupe për të ndërtuar një model të rrotullimit të Tokës. Nxënësit vendosen njëri pas tjetrit, duke formuar një orbitë të madhe në trajtë ovale. Ky rreth përfaqëson orbitën e Tokës rreth Diellit. Secili nga nxënësit përcakton vendndodhjen e Tokës në orbitë në një moment të caktuar. Nxënësja që qëndron në qendër është “Dielli”. Nxënësit e tjerë në “orbitë” lëvizin rreth “Diellit”. Pas kësaj veprimtarie kalohet në shpjegimin e situatës. Nxënësit shpjegojnë se duke u rrotulluar rreth Diellit, ata rrotullohen edhe rreth vetes. Nxënësve u drejtohen këto pyetje: Ç’lëvizje të Tokës treguat kur: u rrotulluat rreth vetes dhe rreth Diellit? Secili jep mendimin e tij dhe shpjegon duke argumentuar përgjigjen. Përmes lojës, nxënësit kuptojnë se rrotullimi i tyre i ngjan atij të Tokës rreth Diellit.			
Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për argumentet, bashkëpunimin në lojë dhe për aktivizimin gjatë orës së mësimi.			
Detyra: Punimi i faqes 55 në <i>Fletoren e punës</i> .		Refleksion: Si mendoni ju, përse shkencetarët bëjnë kërkime të vazhdueshme për hapësirën?	
Shënim:			

Ora 6

Fusha: Shkencë	Lënda: Dituri natyre	Klasa 5	Data
Tema mësimore: Toka rrotullohet rreth Diellit Ora e dytë		Situata e të nxënit: Çfarë ndodh gjatë një viti?	
Rezultatet e të nxënit sipas temës: Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">– lidh provat me njohuritë shkencore;– diskuton për faktet dhe ndryshimin e stinëve;– shpjegon e paraqet rezultatet përmes veprimtarisë.			Fjalë kyçe: vit, rrotullim, hemisferë
Burime dhe mjete: njohuritë e nxënësve, enciklopedi, fotografi, materiale nga interneti, sistemi diellor, globi, videoprojektor			Lidhja me fushat e tjera: Gjuhë shqipe, Gjeografi, Arte, Fizikë
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Bisedë: <p>Flasin për lëvizjen e Tokës rreth vetes dhe rreth Diellit. Si ndodh kjo?</p> <p>Pas përshkrimeve nga nxënësit, dalim në shpjegimin se gjatësia e ditës ndryshon nga dita në ditë, pra, vjen duke u rritur ose duke u zvogëluar. Ky ndryshim i gjatësisë së ditës është një shenjë që tregon se stinët ndryshojnë. Stinët formohen si pasojë e rrotullimit të Tokës rreth Diellit dhe pjerrësisë së boshtit të saj.</p> <p>Shpjegim i përparuar: Skema e paraqitur në faqen 98 të librit tregon pozicionin e Tokës në orbitën e saj rreth Diellit në muaj të ndryshëm të vitit. Një model të tillë e ka edhe mësuesi/ja të paraqitur në poster. Shpjegohet se stinët ndryshojnë në varësi të hemisferës veriore. Nxiten nxënësit të tregojnë se ku bëjnë pjesë vendet mes ekuatorit dhe Polit të Veriut, pra në cilën hemisferë? Po vendet midis ekuatorit dhe Polit të Jugut ku bëjnë pjesë? Në cilën hemisferë?</p> <p>Dalim në përfundimin se: Kur në hemisferën veriore është verë, në hemisferën jugore është dimër. Si mendoni, pse ndodh kjo? Kjo ndodh se hemisfera veriore është më afër Diellit, për shkak të pjerrësisë së boshtit të Tokës. Një tjetër arsye kjo, kur në hemisferën veriore është dimër, në hemisferën jugore është verë. Kështu në këtë rast është hemisfera jugore, ajo që gjendet më afër Diellit. Po për ekuatorin, çfarë mund të themi?</p> <p>Në të, stinët nuk dallojnë nga njëra-tjetra dhe gjatësia e ditës është e barabartë me atë të natës gjatë gjithë vitit.</p> <p>Pyetje-përgjigje me nxënësit:</p> <p>Duke mësuar të gjitha këto e duke u bazuar në faktet e figurës, tregoni:</p> <p>Si janë ditët në verë?</p> <p>Po në dimër si janë ditët? Argumentohet dhe shpjegohet gjithçka që u tha më lart. Arsyet ?</p> <p>Diskutime, shpjegime dhe përballje argumentesh.</p> <p>Shkrim i shpejtë: Pse figura tregon që është verë në hemisferën jugore dhe jo në hemisferën veriore?</p>			
Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për mendimet, bashkëpunimin dhe logjikën e argumentit.			
Detyra: Punimi i faqes 54 në Fletoren e Punës.		Refleksion: Cila stinë ju pëlqen më shumë?	
Shënim:			

Ora 7

Fusha: Shkencë	Lënda: Dituri natyre	Klasa 5	Data
Tema mësimore: Eksplorimi i sistemit diellor		Situata e të nxënit: Dielli dhe planetët	
Rezultatet e të nxënit sipas temës: Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">– hulumton informacione dhe i përshkruan ato;– mbledh prova dhe diskuton rreth tyre;– bën kërkime rreth një teme të caktuar mësimore dhe paraqet të dhënat.			Fjalë kyçe: sistem diellor, asteroid, astronom, kometë, meteor, astronaut
Burimet dhe mjetet: njohuritë e nxënësve, enciklopedi, informacion nga interneti, poster i sistemit diellor, libra shkencor, fotografi të një anijeje kozmike dhe të stacionit ndërkombëtar hapësinor			Lidhja me fushat e tjera: Gjuhë shqipe, Gjeografi, Arte, Fizikë
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Harta semantike: Shkruajmë në qendër të hartës “Sistemi diellor” dhe më pas nxiten nxënësit përmes pyetjeve: Çfarë është sistemi diellor? Çfarë dini për të? Si është i ndërtuar ai? Mësuesi/ja ka përgatitur një mjet të njëjtë si ai i paraqitur në faqen 100 të librit. Aty paraqitet sistemi diellor. Toka është një nga planetët e sistemit diellor. Nxiten nxënësit të tregojnë çfarë dinë për të. Rreth cilit rrotullohen planetët? Përmendni emrat e disa planetëve të tjerë përveç Tokës? Ftohen nxënësit të diskutojnë dhe të japin mendimet e tyre. Lexim i drejtuar: Lexohet informacioni i dhënë dhe nxiten nxënësit të flasin për kometën, asteroidet dhe për vendndodhjen e tyre. Mes cilëve planetë ndodhen? Shpjegimet shoqërohen përmes mjetit të paraqitur. Nxiten nxënësit me disa pyetje: Si quhen disa trupa të vegjël shkëmborë që vijnë nga hapësira? Pas diskutimeve me klasën, dalim në përfundimin se këta trupa quhen meteorë. Shpjegim i përparuar: Astronomë të ndryshëm në kohë të ndryshme kanë shpjeguar idetë e tyre për rrotullimin e Tokës, Diellit, Hënës, planetëve të tjerë dhe yjeve. Astronomi polak Kopernik vrojtoi lëvizjet e planetëve dhe pohoi se Toka dhe gjithë planetët e tjerë rrotulloheshin rreth Diellit. Për shumë kohë, askush nuk i besoi idetë e Kopernikut. Astronomi Italian Galilei shfrytëzoi teleskopin dhe vuri re në periudha të ndryshme se planeti Afërdita ndriçohej nga Dielli. Kjo tregonte se ky planet lëvizte rreth Diellit. Për këtë arsye, ai e mbështeti idenë e Kopernikut. Lexim, diskutim dhe komentim nga nxënësit për njohuritë e marra rreth të dhënave dhe ideve të astronomëve. Pak histori: Në vitet 1960 filloi një “garë hapësinore” ndërmjet Amerikës dhe Rusisë për të dërguar një astronaut në Hënë. Përdorimi i pajisjeve të jashtëzakonshme bëri të mundur zgjerimin e mëtejshëm të njohurive për hapësirën. Leximi i informacionit për stacionin ndërkombëtar hapësinor dhe për anijet kozmike.			
Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për mendimet, bashkëpunimin dhe aktivizimin në klasë.			
Detyra: Punimi i faqes 56 në Fletoren e punës. Hulumtim në materiale të ndryshme për jetën dhe zbulimet që ka bërë një astronom.		Refleksion: A ju duken interesante zbulimet e bëra për hapësirën?	
Shënim:			

Ora 8

Fusha: Shkencë	Lënda: Dituri natyre	Klasa 5	Data
Tema mësimore : Eksplorimi i yjeve		Situata e të nxënësve: Çfarë është gjithësia?	
Rezultatet e të nxënësve sipas temës: Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> – shpjegon ç'është gjithësia; – zbulon se gjithësia ka shumë galaktika; – kryen veprimtari e nxjerr përfundime. 			Fjalë kyçe: gjithësi, galaktikë, teleskop optik, zgjerim
Burimet dhe mjetet: njohuritë e nxënësve, enciklopedi, informacion nga interneti, libra shkencor, teleskop, videoprojektor.			Lidhja me fushat e tjera: Gjuhë shqipe, Gjeografi, Arte, Fizikë
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Shpjegim i përparuar: Sqarohen nxënësit për gjithësinë dhe se ajo përmban miliarda yje me grupe. Këto grupe quhen galaktika. Nxënësit lexojnë materialin e librit. Më pas nxënësve u drejtohen pyetjet si: – Kush di të më thotë diçka për “Rrugën e Qumështit”? Keni informacion për këtë? Komentohet materiali dhe kontributi i astronomit amerikan Edwin Hubble me zbulimin e tij. Çfarë ishte reja? Çfarë tregon ai në zbulimet e tij? Sa e madhe ishte gjithësia? Pyetje-diskutime dhe argumente për të përforcuar njohuritë e marra. Veprimtari: Për të treguar atë që thamë më lart se gjithësia zgjerohet, kryejmë këtë veprimtari: Një nxënës fryn një tullumbace dhe e lidh me llastik që mos dalë ajri. Një nxënës tjetër vendos disa letra ngjitëse mbi tullumbace. Heqim llastikun dhe e fryjmë përsëri tullumbacen dhe e lidhim tullumbacen me llastik. Çfarë ndodh me letrat ngjitëse? Diskutim dhe shpjegim nga nxënësit duke e parë këtë provë në mënyrë praktike. Diskutim: U drejtoj nxënësve pyetjen: Kush më thotë ç'është teleskopi dhe pse përdoret ai? Ata nxiten të tregojnë dhe të diskutojnë për këtë instrument të rëndësishëm, me të cilin veprojmë yjet. Komentim i figurave të dhëna në libër dhe diskutim për çfarë shohin në to. Shkrim i shkurtër: Përshkruaj një udhëtim në hapësirë sipas imagjinatës sate. Pas punës, lexim, diskutim dhe mendime për shkrimin më të bukur.			
Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për mendimet, përgjigjet e dhëna dhe për shkrimin.			
Detyra: Punimi i faqes 57 të fletores së punës. Nxënësit mund të nxiten të hulumtojnë në libra ose në internet për informacione rreth teleskopit.			
Shënim: Nxënësit, me dëshirë dhe brenda mundësive, me ndihmën e të rriturve, mund të ndërtojnë një teleskop të thjeshtë në shtëpi dhe ta sjellin atë në orën e mësimit.			

Ora 9

Fusha: Shkencë	Lënda: Dituri natyre	Klasa 5	Data
Tema mësimore: Kontrolloni përparimin tuaj		Situata e të nxënit: Unë di ...	
Rezultatet e të nxënit sipas temës: Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> – rishikon përsëritjen e të gjitha mësimëve dhe veprimtarive; – prezanton në forma të ndryshme njohuritë e marra, aftësitë dhe qëndrimet. 			Fjalë kyçe: Dielli, Toka, Hëna
Burime dhe mjete: enciklopedi, informacion nga interneti, lapsa, tabak letre			Lidhja me fushat e tjera: Gjuhë shqipe, Gjeografi, Arte, Fizikë
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Diskutim: Diskutohen së bashku përcaktimet e bëra në fletoren e punës dhe fjalët që janë dhënë. Cili nga rrotullimet e Tokës sjell ditën? Po natën? Plotësim i tabelës me të dhënat për kohën e lindjes dhe të perëndimit të diellit në vjeshtë. Pyetje: Si do të vijë gjatësia e ditës, duke u rritur apo duke u zvogëluar? Flasim për mjetin eksplorues që u përdor për të mbledhur kampione shkëmbinjtë në Hënë. Punë e pavarur: Nxënësit punojnë individualisht për plotësimin e fletës së punës. Krahësim dhe diskutim në dyshë të plotësimit të tyre. Lexime, diskutime, vlerësime nga vetë nxënësit për rubrikat e plotësuara.			
Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për plotësimet, për përgjigjet e dhëna me shkrim dhe për argumentimet e tyre.			
Detyra: Gjej informacione në internet për mjetin eksplorues që lëviz me anë të robotëve në sipërfaqen e Marsit.			
Shënim:			

Ora 10

Fusha: Shkencë	Lënda: Dituri natyre	Klasa: 5	Data
Tema mësimore: Projekt. Eksplorimi i sistemit diellor (ora e parë)		Situata e të nxënit: Rëndësia e sistemit diellor për njerëzit	
Rezultatet e të nxënit sipas temës Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> – shpjegon rëndësinë e sistemit diellor; – ndan me të tjerët përvojat e njohuritë nga vëzhgimet individuale; – sjell informacione e shpjegon rëndësinë e sistemit diellor. 			Fjalë kyçe: Diell, planetë, Hëna, Toka
Burime dhe mjete: enciklopedi , informacion nga interneti , postera, video projektor .			Lidhja me fushat e tjera: Gjuhë shqipe, Gjeografi, Arte, Fizikë
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Diskutim: Flasin rreth planetit të Jupiterit. Si është planeti i Jupiterit nga madhësia? Rreth cilit yll rrotullohet Jupiteri? Sa zgjat një rrotullim i plotë i tij rreth Diellit? Sa hëna të mëdha e të vogla ka ai? Nga cilat gaze përbëhet ai? A do të jetë e lehtë ulja e anijes kozmike në Jupiter? Përgjigje të pyetjeve, mendime të ndryshme të mbledhura nga nxënësit. Projekt: Prezantim i temës së projektit: Eksplorimi i sistemit diellor. Nxënësve u shpjegohet se qëllimi i projektit është të flasin për sistemin diellor dhe zbulimet e shkencëtarëve për këta planetë. Sa të rëndësishme janë zbulimet e astronomëve për njerëzimin? Udhëzohen nxënësit se shumë informacione për udhëtimet e anijeve kozmike dhe zbulimet që kanë bërë së fundmi mund t'i gjejnë në internet. Pak informacion: Sistemi diellor është sistem i organizuar planetësh, të cilët sillen rreth Diellit. Ai është një sistem planetar i përbërë nga trupa qiellorë të ndryshëm, që mbahen në orbitë nga forca e gravitetit të yllit tonë, Diellit. Nxënësit ndahen në grupe dhe secili pre tyre paraqet mendimin e vet në lidhje me temën. Nxënësve u bëhet e qartë se gjatë prezantimit të projektit do të vlerësohen për pjesëmarrjen dhe kryerjen me korrektësi të çdo detyre. Çdo pjesëtar i grupit ka rolin dhe detyrën e tij.			
Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për mendimet, diskutimet dhe idetë e dhëna.			
Detyra: Kryejnë detyrën e ngarkuar nga grupi për projektin.			
Shënim:			

Ora 11

Fusha: Shkencë	Lënda: Dituri natyre	Klasa: 5	Data
Tema mësimore: Projekt. Eksplorimi i sistemit diellor (ora e dytë)		Situata e të nxënit: Sistemi diellor	
Rezultatet e të nxënit sipas temës: Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">– shpjegon rolin dhe rëndësinë e sistemit diellor;– bën kërkime dhe paraqet informacionet;– shpjegon dhe del në përfundime nga vëzhgimet e bëra.		Fjalë kyçe: Diell, planetë, Hëna, Toka	
Burimet dhe mjetet: enciklopedi, informacion nga interneti, postera, videoprojektor.		Lidhja me fushat e tjera: Gjuhë shqipe, Gjeografi, Arte, Fizikë	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Bisedë: Rikujtohen qëllimi dhe pritshmëria e projektit. Përmes këtij projekti, nxënësit zbatojnë njohuritë dhe informacionet që kanë mbledhur, analizuar e përpunuar. Për të gjitha këto informacione, ata duhet të mbajnë qëndrime dhe t’i paraqesin në klasë. Puna me grupe: Secili grup merret me sistemin e njohurive, renditjen e të gjitha materialeve të mbledhura. Prezantimi dhe sistemimi i tyre kanë një rëndësi të veçantë. Secili grup paraqet punën e tij. Gjatë kësaj paraqitjeje, grupet e tjera mund t’i drejtojnë pyetje grupit prezantues. Në fund të prezantimeve të secilit grup të projektit vlerësohen punimet, jepen mendime nga secili për punën e paraqitur. Jepen dhe idetë se çfarë mund të bëhej ndryshe.			
Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për bashkëpunimin që kanë treguar gjatë punës, për informacionin e sjellë dhe për prezantimin e tyre.			
Detyra: Çfarë ju pëlqeu më shumë në këtë projekt?			
Shënim:			

TEST - PERIUDHA E PARË

Emri/Mbiemri _____

Data _____

Klasa _____

1. Rendit fazat e mbirjes së farës, duke vendosur numrat në kutizat para fjalive. 6 (pikë)

Fillon të rritet rrënja e parë.

Gjethet bëhen më të mëdha dhe farat vyshken.

Dalin gjethet e para.

Çahet cipa mbrojtëse e farës.

Fillon të rritet filizi.

Fara thith ujë dhe fryhet.

2. Qarko për çfarë ka nevojë fara që të mbijë e të rritet. 3 (pikë)

ujë

dritë

ajër

ngrohtësi

erë

3. Pse bimët kanë lule? 2 (pikë)

4. Emërto pjesët e lules duke përdorur fjalët e dhëna. 7 (pikë)

petla

nënpetla


pistili

vezorja

pjalmorja

theku

pjesa femërore



5. Shkruaj emrat e pjesëve mashkullore të lules. 2 (pikë)

6. Shkruaj emrat e elementeve të pjesës femërore të lules. 3 (pikë)

7. Paraqit të dhënat në një grafik me shtylla.

6 (pikë)

Disa nxënës të klasës së pestë hulumtuan pjalmimin e luleve nga insekte të ndryshme. Ata vëzhguan dhe numëruan sa herë shkuan insektet te lulet. Kështu, bletët shkuan 12 herë, fluturat shkuan 10 herë, brumbujt shkuan 4 herë dhe grerëzat 7 herë.

8. Trego dy mënyra, nëpërmjet së cilave lulet tërheqin insektet.

2 (pikë)

9. Trego se ku dallon pjalmimi nga pllenimi.

2 (pikë)

10. Duke përdorur fjalët e mëposhtme, ndërto ciklin jetësor të bimës.

9 (pikë)

formimi i frytit dhe i farës

pllenimi

rritja

pjalmimi

mbirja

çel lulja

shpërndarja e farës

Suksese!

Pikët	9	10-15	16-21	22-27	28-32	33-37	38-42
Vlerësimi	4	5	6	7	8	9	10

TEST - PERIUDHA E DYTË

Emri/Mbiemri _____

Data _____

Klasa _____

1. Plotëso fjalitë duke përdorur fjalët e mëposhtme.

5 (pikë)

ushqim ujë ndryshime oksigjen faze

Që të jetojnë, kafshët kanë nevojë për _____ dhe _____ . Cikli jetësor i kafshëve përbëhet nga _____ të ndryshme të jetës. Disa kafshë pësojnë vazhdimisht _____ gjatë ciklit të tyre jetësor.

2. Paraqit ciklin jetësor të një kafe nëpërmjet ndërtimit të skemës.

5 (pikë)

3. Si duhet të jetë moti, në mënyrë që rrobat e ndera të thahen sa më shpejt? Pse mendon kështu?

4 (pikë)

4. Trego një rast kur avullimi është i dobishëm dhe një rast kur avullimi nuk është i dobishëm. Shpjego përgjigjen.

4 (pikë)

5. Paraqit me një skemë ciklin e qarkullimit të ujit në natyrë. Emërto e përcakto në skemë gjendjet e ujit dhe proceset e shndërrimeve që i ndodhin atij. 6 (pikë)

6. Plotëso fjalitë. 6 (pikë)


Nëse e _____ ujin në temperaturën 1000C, ai arrin _____.

Nëse e _____ ujin në temperaturën 00C, ai arrin _____.


Kur vlon, uji kthehet në _____.

Kur shkrin, akulli kthehet në _____.

7. Genti po shikon pemët. Ngjyros burimin e dritës. Vizato disa shigjeta që tregojnë si e shikon ai pemën. 3 (pikë)



8. Vizato rrezen e dritës që pasqyrohet nga pasqyra. 2 (pikë)



Suksese!

Pikët	9	10-15	16-21	22-27	28-32	33-37	38-42
Vlerësimi	4	5	6	7	8	9	10

TEST - PERIUDHA E TRETË

Emri/Mbiemri _____

Data _____

Klasa _____

1. Trego**6 (pikë)**

Kur është hija më e shkurtër?

Si formohet ylberi?

Pse matet intesiteti i dritës?

2. Qarko përgjigjen e saktë:**3 (pikë)**

a) Toka rrotullohet rreth boshtit të vet.

Po Jo

b) Toka dhe Hëna rrotullohen rreth Diellit.

Po Jo

c) Nata dhe dita ndodhin për shkak të rrotullimit të Tokës rreth Diellit.

Po Jo**3. Plotëso duke përdorur fjalët e dhëna.****6 (pikë)**

Jupiteri është planeti më i madh i _____. Ai kryen një rrotullim rreth boshtit

të tij për 10 _____. Një rrotullim i plotë i Jupiterit rreth Diellit zgjat _____.

Jupiteri ka _____ dhe të paktën 24 hëna të vogla, të cilat rrotullohen rreth tij. Ai është një


planet _____, i përbërë kryesisht nga _____: hidrogjen e helium, si dhe nga sasi

të vogla gazesh të tjera të vendosura në shtresa.

4. Emërto planetët e sistemit diellor të paraqitur në figurë.

9 (pikë)

Mërkuri, Marsi, Plutoni, Afërdita, Toka, Neptuni, Saturni, Jupiteri, Urani



5. Shpjego cili prej rrotullimeve të Tokës sjell krijimin e ditës dhe të natës.

2 (pikë)

6. Rendit dy faktorë që çojnë në krijimin e stinëve.

7. Përshkruaj një udhëtim në hapësirë sipas imagjinatës sate

4 (pikë)

Vlerësimi	4	5	6	7	8	9	10
Nota	0-7	8-11	12-15	16-19	20-23	24-27	28-30